


Nëntor 2015
Numri: 92
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



FALËNDERIMI
OSMAN NURI TOPBASHI



VIDEOKRACIA
EDISON CERAJ



HISTORIA
E ELEFANTIT
MUSTAFA ERISH



PRODIMI I MIRËSISË
IDRIS ARPAT



LEGJITIMIME
AHMET TASHGETIREN




MOS E SILLNI RRUGËN
NË SHKOLLË
NUREDIN NAZARKO

Drita përtej derës



Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com

KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

E sheh atë dritën atje? E sheh vijën e drejtë të rrezes? E sheh?..

Ajo është drita e besimit, ajo është drita e rrugës sime, është drita që ndriçon shpirtin tim në këtë botë të errët mbushur plot egoizëm e egërsi. Drita e besimit m'i largon të gjitha trishtimet dhe është shndërruar në qëllim jete, duke më ndihmuar që sa herë rruga errësohet nga gjërat e kësaj bote, unë të shoh, t'i shoh mirësitë e Krijuesit dhe atëherë çdo e keqe brenda meje largohet, merr arratinë duke u zbehur tërësisht nga drita. Është kjo dritë frymë për hapat e rinj, plot shpresë drejt dyerve të reja.

...Ndonjëherë dera mbyllet, por drita duket prapë diku, dera mbyllet për rrugëtimin e gabuar, mbyllet për të ndjekur të shkruarit e penës pesëdhjetë mijë vjet para se të lindja.

Sa i Mëshirshëm është Allahu!!

Sa dyer të gabuara do hapte njeriu! Çdo derë e mbyllur, çdo derë e hapur ka një arsye e një qëllim hyjnor, mjafton që ta kuptoj, ta pranoj dhe të jem e kënaqur me përcaktimin tim, sepse vetëm kështu do mundem të jetoj, vetëm kështu do mundem të jem e lumtur. Asnjë derë, asnjë mur, asnjë errësirë nuk më pengon të shoh dritën e besimit brenda shpirtit, sepse besimi lind dhe jeton aty dhe asnjë mjedis i jashtëm, asnjë arsye jashtë shpirtit nuk mund ta zbehë atë...

Është kjo rreze jete, që më ndihmon të shoh përtej dyerve, përtej mureve, përtej errësirave. Nëse kjo dritë do mungonte?... Më trishton vetëm si mendim dhe as që mundem të mendoj pa dritën e besimit, nuk mundem, sepse mendja të fut në labirintet e saj duke të bërë një mendimtar të humbur, duke të lënë të jetosh mes dyersh të mbyllura, pa ajër, pa dritë, sepse pa udhëzimin hyjnor as mendja nuk ka asnjë kuptim.

Shtigjet e jetës, rrugëtimet e saj nuk janë aspak të lehta, janë gjithmonë të shoqëruara me mjegull, është vetëm besimi që davarit këtë mjegull, është besimi që mbush shpirtin, është besimi që ndihmon për të kuptuar mbylljen e derës dhe shpresën për hapjen e një dere tjetër, asaj dere ku ndodhet drita, mirësia, bekimi dhe mëshira e Krijuesit.

Por unë mundem sepse besoj!! Brenda shpirtit, mes hapësirave nën dritën e Krijuesit kërkoj të mirën, ruaj besimin dhe besimi më ruan mua, marr frymë dhe... shoh dritën përtej dyerve... jetoj!

Nëntor 2015

VITI: IX

NUMRI: 92

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi

pavarësisht nëse botohen apo jo

nuk i kthehen autorit. Koha e botimit

të një materiali përcaktohet

nga redaksia. Honoraret e shkrimeve

autoriale ose përkthimeve duhet të

vini t'i tërhiqni pranë

Shtëpisë Botuese "Progresi"

ose pranë zyrove të përfaqësimit

në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



10

Dinjteti i besimtarit
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan




Falënderimi
Osman Nuri Topbash

34



14

46



Ajo nuk mund të më shikojë mua!
Adem Saraç

- 5 Legjitimime
Ahmet Tashgetiren
- 8 T'i veshësh gënjeshtërs
petkun e së vërtetës
Dr. Adem Ergyl
- 13 Distancimi nga fitneja
Ali Riza Temel
- 16 Devotshmëria,
kriteri i vlerësimit tek Allahu
Doç. dr. Kerim Bulladë
- 18 Afrimi nga e djathta
Dr. Murat Kaja
- 22 Historia e Elefantit
Jasin Demirxhi
- 24 Mos luaj me natyrën njerëzore
Prof. dr. Sulejman Derin
- 26 Pyetjet
Neslihan Nur Turk

52

Prodhimi i mirësisë 28

Idris Arpat

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32

Të arrish të falësh 40

Xhelaleddin Ozbek

Zejd ibn Erkam (r.a.) 42

Mustafa Erish

Mos e sillni rrugën në shkollë 44

Nuredin Nazarko

Devotshmëria dhe frikë-respekti 49

ndaj Allahut të Lartësuar

Ajdën Tallaj

Videokracia 54

Edison Çeraj

Drita... përtej derës

Ela Muça



Do t'i mbështetemi Allahut
dhe do të punojmë me entuziazëm
Ajdën Tallaj

52

Frikërat e njeriut modern
Ajnur Tutkun

56



E legjitimuar

Ahmet Tashgetiren

Para së gjithash le të mendojmë njëherë mbi konceptin e “legjitimitit”.

Këtë e bëjmë për faktin se kualiteti i myslimanizmit ka lidhje të drejtpërdrejtë me të. Në qoftë se nuk arrijmë të shohim dallimin mes “legjitimes” dhe “të legjitimuarës”, jeta që jetojmë me kalimin e kohës mund të marrë formë sipas asaj që të tjerët kanë “legjitimuar” dhe të shkojë në këtë mënyrë shumë larg asaj që është “legjitime”.

Çfarë është legjitimimi?

Përgjigjja më e qartë që mund t’i jepet kësaj pyetjeje është:

Një operacion psikologjik që kryejmë vetë ndaj vetes sonë.

Operacioni i shtresimit nga ana jonë e fakteve të ofruara.

Në fakt është operacioni që krijon tek besimtari përshtypjen se ai ende është brenda mësimëve të fesë islame edhe kur nuk është, që shmanget prej tij ndjenjën e kryerjes së diçkaje që është joislame edhe kur ai e bën këtë gjë, i jep refleksin se është brenda kriterëve të fesë edhe kur ka dalë prej tyre.

Më shkurt është operacioni i vetëmashtimit.

“Legjitime” është gjithçka që shprehet me qëndrimin brenda “kornizave të sheriatit”, që janë kriteret kryesore të Islamit, ndërsa “e legjitimuar” është dalja nga kjo kornizë dhe perceptimi nga ana jonë se ende jemi brenda kornizës së fesë islame...pra e shprehur me një gjuhë më teknike, legjitimimi i të palegjitimuarës duke pretenduar se jemi brenda kornizës së sheriatit.

Legjitimimi është kërkimi nga ana e njeriut e kriterëve të reja që përputhen me dëshirat dhe pasionin

e tij, ndërkohë që ato kritere janë përcaktuar nga ana e Allahut dhe transmetimi i këtyre kritereve që përputhen me dëshirat dhe pasionet e tij në jetën e përditshme, pa parë se nga e kanë burimin ato.

Akti i "caktimit të kritereve" është një atribut "hyjnor", që njeriu kërkon t'ia prokurojë vetes së tij në përputhje me "pasionin dhe dëshirat që ka" dhe gjithë këtë e bën me dashje ose pa dashje.

Në qoftë se e analizojmë më nga afër jetën tonë dhe botën tonë intelektuale do të dëshmojmë se ne vetë nuk mund ta krijojmë një atmosferë të shëndoshë në të cilën jetohej me përpikmëri kriteret e fesë islame, madje veprimet dhe sjelljet që nuk janë legjitime nisin e legjitimohen brenda kësaj atmosfere.

Si do të shkojmë drejt kësaj situatë? Ja kështu:

Një sistem apo "statu quo", që formohet larg kritereve islame apo kulturës së përgjithshme njerëzore, do të na rrethojë duke bërë që brenda kësaj atmosfere të përthithim në koshiençën tonë modele sjelljeje që i kryejmë përditë, duke bërë që me kalimin e kohës të përjashtojmë atë që është islame, duke ia lënë vendin asaj që është joislame.

Në një aspekt, kjo përngjan me sindromin e bretkosës së përvëlur me ujë të nxehtë. Brumosje, pjekje mendore e emocionale dhe humbje e gjallërisë brenda një sistemi të caktuar pa e vënë re këtë gjë.

Ose vetëdija e mësuar e kolonializmit. Pranimi si natyrale që të jesh rob i kolonializmit, të humbësh aspektin e vërtetë të pavarësisë dhe të idealizosh kornizën e jetës që të mëson kolonialisti.

Kur Abraham Linkoln zhduku skllavërinë në Amerikë, të gjithë skllavërit u shpallën njerëz të lirë, por pati nga ata që u kthyen sërish tek zotërinjtë e tyre të mëparshëm për të jetuar pranë tyre prapë me ato kushte që jetonin në skllavëri. Të ngjashme me këtë janë edhe situatat e deformimit intelektual të një myslimani që jeton brenda një statu quo-je joislame apo e myslimanit që është i kënaqur me një shoqëri ku parimet islame janë lënë në dorë të dytë.

Kjo strukturë e tillë personaliteti është në të njëjtën kohë një strukturë që e ka humbur rezistencën ndaj asaj që është "joislame".

Përfshirja e asaj që është joislame brenda fesë islame.

Kështu, në këtë mënyrë, pa qenë aspak të vetëdijshëm për atë që bën, në botën e besimtarit nis të pakësohet doza e mësimave islame dhe të rriten dozat e prodhimeve të sistemeve joislame dhe kulturave të huaja.

Me kalimin e kohës del në pah një botëkuptim islam i zbrazur në një masë të madhe së brendshmi nga mësimet islame.

Në këto situata të gjithë nisin të formësojnë sipas dëshirës myslimanizmin e tyre në atë masë që i detyron pozicioni që kanë në shoqëri.

Jetët ngurtësohen dhe inteligjenca ruan një nivel të pandryshueshëm.

Thënia: "Në qoftë se nuk jetoni ashtu siç besoni, keni për të besuar ashtu siç jetoni", është tipike për këto situata.

Ky është legjitimimi i jetës së përditshme dhe rikomentimi i kritereve të besimit në varësi të kushteve të jetës.

Çdo gjë që jetojmë...

E zëmë se është një statu quo globale ajo që na kushtëzon një jetë të mbushur me fajde. Çfarë vjen më pas? Inteligjen-

cat që nga njerëzit e thjeshtë dhe deri tek njerëzit e ditur, vende-vende edhe "strukturat pa fajde", nisin ta legjitimojnë këtë fakt dhe nivel pas niveli veprimet ekonomike me fajde hyjnë në hapësirën e myslimanit.

E zëmë se hapësira e intimitetit të myslimanit po ngushtohet. Menjëherë pas kësaj fillon procesi i "vaksinimit" të kritereve të reja të intimitetit në botën tonë ideore.

Ngjarja që në debatet shkencore islame është shprehur me konceptin e "historicismës", në të vërtetë mbart një cilësi të këtillë të ndryshimit ideor.

Zgjerimi sa më shumë të mundemi i parimit të Mexheles se "me kalimin e kohës ndryshojnë edhe rregullat", bën në fakt që të therORIZOJMë vetë "strukturën e rregullit".

Kornizat e jetës dhe intelektit fetar të myslimanit, i cili pretendohet se do ta shpinte njeriun drejt fesë islame janë duke përjetuar një transformim.

Kjo logjikë ka marrë natyrën e përhapjes së mentalitetit se “fenë islame shumë-shumë në kohët tona kaq mund ta jetosh”, që sisteme të ndryshme duan ta vëjnë në jetë me qëllim kufizimin e hapësirave të fesë islame, duke pasur në krah në raste të shumta edhe dhunën shtetërore në këtë drejtim. Sqarimet e shtetit laik gati në të gjithë shekullin që kaluam janë përpjekur t’i bëjnë myslimanët ta pranojnë si të natyrshme këtë logjikë, ndërkohë që myslimanët janë përpjekur ta ruajnë besimin e tyre nga sistemet laike.

Sot në botë, përkrah këtyre sistemeve laike, vihet re një bazë e formuar nga kultura shtypëse e kulturës globale mbi të cilën botëkuptimi islam është duke përjetuar një proces vetëngushëllimi të formës. “Këto janë kushtet e botës, nuk kemi çfarë të bëjmë”. Duket se shoqëritë myslimane janë duke e humbur ndjeshmërinë e rezistencës ndaj strukturave që ushtrojnë një shtypje të madhe ndaj tyre.

Po jetohet një situatë e tillë, ku nuk vihen re qartë format e shtypjes, por përjetohet një atmosferë ku frymëmarrja nuk është e lehtë.

Duket qartë se nuk janë myslimanët dhe parimet e fesë islame ato që përcaktojnë klimën kulturore në të cilën merr frymë njerëzimi.

Myslimanët janë pasivë në këtë botë...

Ata janë të rrethuarit...

Shtëpia e myslimanit nuk është e aftë të pengojë dallgët manjetike të kulturës globale, për më tepër kur barrierat tona intelektuale janë bërë copë e grimë.

Ne jemi përpara një problemi shumë të madh.

Islami është zgjidhja e vetme për njeriun, i cili nuk do të ketë kurrë kuptim pa mësimet e fesë islame.

Distanca mes njeriut dhe fesë islame është duke u zmadhuar, sepse marrëdhëniet mes parimeve islame dhe myslimanit, i cili duhet ta transmetojë fenë islame tek të tjerët, janë duke përjetuar probleme.

Kornizat e jetës dhe intelektit fetar të myslimanit, i cili pretendohet se do ta shpinte njeriun drejt fesë islame janë duke përjetuar një transformim.

Çfarë do të ndodhë?

Para së gjithash, ne myslimanët duhet t’ia drejtojmë vetes sonë këtë pyetje.

Pasi ne duhet të jemi të parët që duhet të kuptojmë se sa jetike dhe e rëndësishme është feja islame për njerëzimin.

Ne duhet të përjetojmë një ringjallje intelektuale dhe shpirtërore.

Pasi të kemi filluar me intelektin dhe me zemrën tone, ne duhet të ringjallim të gjithë indet tona që kanë rënë në gjumë.

“Legjitimimi” është një sëmundje e intelektit dhe e zemrës, mikrobi i së cilës futet në organizmin tonë me anë të “zbukurimeve” të shejtanit.

Ne duhet të kemi antitrukat tonë kundër këtij mikrobi.

Ne duhet ta mbledhim veten nga gënjeshtra e legjitimitit, duke u mbërthyer nga vetëdija se “Jetojmë nën kontrollin e Allahut, i Cili na sheh kudo që të gjendemi dhe i njeh më mirë qëllimet tona.” Ne duhet të këmbëngulim në atë që është “legjitime”, duke marrë parasysh çdo lloj çmimi për këtë që po bëjmë. Të këmbëngulim tek ajo gjë që është legjitime, pra që Allahu është i kënaqur me të dhe ne jemi të qetë shpirtërisht për këtë gjë...

Në një atmosferë kaosi, kur nuk e njeh i pari të dytin, në një realitet transformimesh, ku njeriu zgjohet si besimtar dhe ngryset si qafir, apo zgjohet si qafir dhe ngryset si besimtar, ne duhet të tregojmë shumë kujdes që mos ta shkëpusim lidhjen mes zemrës dhe Allahut.

Kjo është një gjë e vështirë.

Koha është ajo që i Dërguari i Allahut (a.s.), e pati përshkruar me fjalët: “Do të vijë koha në të cilën të jetosh sipas mësimet të fesë islame është e njëjtë si të mbash një thëngjill në dorë...” Koha kur praktimi i një veprimi nga “tradita profetike” është e barabartë me sevapet që fitojnë njëqind sahabë bashkë...

A nuk mendoni edhe ju se kemi të nevojshme të bëjmë një skanim të personalitetit tone, në mënyrë që të dallojmë legjitimen nga e legjitimuara në jetën tonë dhe të dalim para Zotit faqebardhë dhe kokë-lartë për jetën tonë?





T'I VESHËSH GËNJESHTRËS PETKUN E SË VËRTETËS

Dr. Adem Ergyl

Njeriu është një krijesë e ndërgjegjshme dhe e vetëdijshme. Ndërgjegjja e pastër është një peshore e saktë, që është vendosur në esencën e njeriut. Edhe sikur të marrë fetva nga njerëzit e tjerë, besimtari nuk duhet ta heqë kurrë nga mendja këshillën e Profetit që t'i shmanget çdo gjëje që ia trazon shpirtin. Ndodh që ndonjëherë njeriu përpiqet ta mashtrojë veten e tij dhe të mbysë zërin e së vërtetës që e thërret nga brenda qënies së tij, duke e justifikuar këtë veprim me nevojën e zhdukjes së brerjes së ndërgjegjes që nuk e lë rehat për shkak të veprimit të gabuar që ka kryer. Në këtë rast ai përpiqet t'i veshë gënjeshtres rrobën e së vërtetës. Me fjalë të tjera, ai përpiqet të legjitimojë veprimin e gabuar. Psikologjia e vetëmbrojtjes gjendet në natyrën e mirëfilltë të njeriut. Të gjithë janë të një mendimi se pranimi i fajit dhe heqja dorë një herë e mirë prej tij është një virtyt, por jo të gjithë njerëzit mund ta kryejnë me sukses këtë gjë. Kjo sjellje në të vërtetë është shenjë e personalitetit fisnik. Ndoshta vlera e këtij veprimi është shumë më e madhe, në rast se ky veprim kryhet duke bërë pendim dhe duke kërkuar falje prej Zotit, duke përputhur në këtë mënyrë botën e brendshme me sinqeritetin. E kundërta e këtyre veprimeve, pra mbrojtja e së gabuarës si të ishte e saktë dhe komentimi i të vërtetës dhe i vlerave themelore, do të thotë të vihesh në lojë të nefsit dhe të vetëmashtrohesh. Këto lloj qëndrimesh janë përshkruar në Kuran si sjellje dhe qëndrime që meritojnë dënimin dhe zemërimin hyjnor. Ata që përpiqen t'u japin ajeteve kuptimin që dëshirojnë dhe jo atë real, duke mos pranuar në këtë mënyrë të përmirësohen dhe të ndryshojnë sipas mësimave të ajeteve hyjnore, janë cilësuar në Kuran si arrogantë që përpiqen të shtrembërojnë kuptimin e ajeteve të Kuranit. Në thelb, sëmundja e vetëvlerësimit dhe e prezantimit të së gabuarës si diçka e drejtë, vetëm e vetëm që ta nxjerrësh veten të saktë, është një veprim i shejtanit. Kështu edhe shejtani që përpiqet t'a argumentonte veprimin e tij të mosbindjes për t'i rënë në sexhde Allahut, duke mbrojtur tezën se *"Ai ishte më superior sesa Ademi, sepse ishte prej zjarrit, ndërsa Ademi ishte prej dheu."* Në fakt shejtani po i vinte mendja vërdallë nga zjarri i zilisë që e digjte përbrenda dhe nuk arrinte të kuptonte se sa arrogant po sillej, duke i dalë kundër urdhrin të Zotit për t'i rënë në sexhde Ademit. Po kështu edhe vëllezërit e profetit Jusuf (a.s.), në një anë bënin planin se si ta vrisnin Jusufin, ndërsa në anën tjetër radhisinin arsyet që sipas tyre ishin logjike dhe legjitimonin këtë krim makabër:

"Vëllezërit e Jusufit thanë: 'Ne jemi një dorë kaq e fuqishme vëllezërisht, kurse babai ynë do më shumë Jusufin dhe të vëllain (Bunjamin)

sesa ne. Me të vërtetë që babai ynë është duke gabuar rëndë. Vriteni Jusufin ose hidheni atë në ndonjë vend, në mënyrë që babai juaj të fillojë t'u dojë vetëm ju. Pastaj pendohuni për atë që keni bërë dhe bëhuni njerëz të devotshëm për pjesën tjetër të jetës që u ka mbetur. (Jusuf, 8-9)

Po të lexohet me kujdes ajeti i mësipërm, kuptohet qartë se ata ishin të ndërgjegjshëm se vrasja është një krim makabër, por e justifikonin këtë krim me pretekstin se sjellja e padrejtë e babait të tyre ndaj bijve duke mos i dashur njëlloj ata, i kishte shtyrë ata drejt këtij veprimi. Nga ana tjetër, ata përpiqeshin të bindnin njëri-tjetrin se pas kryerjes së këtij krimi do të bënin pendesë të singërtë dhe do të shndërroheshin në njerëz shumë të mirë, sepse do të vendosnin që të mos bënin ndonjë veprim tjetër të gabuar. Ja se cila është një rrugë e shejtanit për të mashtruar njeriun. Pra, e bën njeriun t'i duket logjike dhe e natyrshme edhe vepra më makabre. Ja se si e pati shpallur që në fillim të herës shejtani këtë dredhi që do t'i bënte ai racës njerëzore:

"Iblisi tha: Zoti im! Meqë më përzure nga mëshira Jote, unë betohem se do të bëj të pamundurën që të largoj nga mëshira jote me përjashtim të njerëzve të devotshëm që nuk kam se çfarë t'u bëj, racën njerëzore, duke bërë që atyre t'u duken si gjëra të bukura veprimet më të mbrapshta të tokës." (Hixhr, 39-40)

Përpjekja për të legjitimuar çdo veprim që kryhet në përgjithësi, ose është shenjë e dytërisë, ose është shenjë e zemrës së sëmurë. Ja se çfarë thotë Zoti ynë në lidhje me ata që besojnë se duhet t'u përshtatemi të krishterëve dhe hebrenjve, madje edhe të lidhim miqësi të ngushta me ta, për shkak të përfitimeve personale që kanë nga kjo gjë:

"Ti i sheh se si ata që i kanë zemrat e sëmura vrapijnë e qëndrojnë përkrah hebrenjve dhe të krishterëve, duke pretenduar se kanë frikë se mos i gjen ndonjë belë në qoftë se nuk veprojnë kështu. Allahu sjell ndonjë urdhër apo shkakton një fitore të afërt dhe ata bëhen pishman që kanë vepruar në atë mënyrë." (Maide, 52)

Kjo do të thotë se mosrespektimi i kufijve të vendosur nga ana e Zotit, me gjithë paralajmërimet hyjnore për të mos e bërë këtë gjë duke menduar se "ku i dihet", është streha e legjitimitetit të një strukture të sëmurë dhe e një pozicionimi të paqëndrueshëm përpara situatave. Dyshja shejtan - ego personale në përgjithësi i qaset njeriut besimtar nga e djathta e tij, sa herë që dëshiron ta mashtrorë atë. Për shembull, njeriut që e ka pikë të dobët paranë i pëshpërit në vesh: "Myslimani sot duhet të jetë i pasur. Vetëm kështu ruhet madhështia e fesë islame dhe e myslimanëve. Fajdeja është haram, por si mundet një person që nuk ka kapital të vënë mënjane që të bëhet i pasur pa marrë fajde më parë? Sot ti je i detyruar të marrësh fajde, në qoftë se do të luftosh armiqtë e fesë islame. Ti duhet të përdorësh armën që përdor armiku yt. Në qoftë se fajden e merr duke pasur qëllim të mirën e fesë,

nuk bën faj." Personit që është i prirur të marrë rryshfet, shejtani i thotë: "Ti je melek, po të shohësh se si janë bërë njerëzit sot. Edhe ti ke gjynahet e tua, po ku ka njeri pa gjynahe në këtë botë? Të tjerët i marrin paratë me thasë, kurse ti thjesht je duke marrë një dhuratë. Kjo nuk konsiderohet rryshfet. Madje kjo është e drejta jote. Ti na qenke njeriu më i drejtë në botë? Se mos paguhesh aq sa e meritonin me punën që bën! Me këto dhurata që merr u zgjidh hallet njerëzve që ke për të mbajtur në shtëpi." Besimtarit që ka dëshirë të jetë përherë i pari në pozicione, shejtani i thotë në vesh: "Dëgjo këtu, mik! Po u zgjedhe ti në krye të kësaj pune, ke për të bërë shumë punë të hajrit. Të tjerët janë pa vizion, përtacë dhe të paaftë. Me të vërtetë që shpifja është gjynah, por nuk është asgjë kundrejt të mirave që ke për të bërë kur ti të bëhesh i pari. Kush nuk ka ardhur në krye të posteve të rëndësishme pa ua futur stërkëmbësin të tjerëve? Kur t'i kesh gjërat në dorë, ke për të pasur mundësinë t'u bësh mirë të tjerëve." Po kështu, personit që do të vijë në pushtet, shejtani i pëshpërit në vesh: "O vëlla! Po nuk erdhe në pushtet, nuk arrin dot t'i vësh në këmbë vlerat tuaja. Kështu që deri sa të vish në pushtet, ti duhet t'i përshtatesh ambientit që të rrethon. Mos u trego të tjerëve se çfarë mendon dhe dëshiron në të vërtetë. Sillu edhe ti si të tjerët. Namazet i fal kaza dhe, në qoftë se je i detyruar të pish pije alkoolike, mos u ndaj nga shokët se bën tevbe më vonë. Ti e ke nijetin të pastër. Veprat vlerësohen sipas qëllimit. A nuk është kështu? Prandaj, deri sa të mbërrish qëllimin që i ke vënë vetes, e ke hallall çdo gjë që do të bësh." Njeriut që merr pjesë në punë të hajrit, por nuk është i rregullt në kryerjen e namazeve dhe dhikrit të Zotit, shejtani i pëshpërit në vesh: "Ti je duke e çuar dëm veten për hir të njerëzve të tjerë. Vrapon sa andej-këndej edhe ditën, edhe natën. Nuk paske falur sabahun ose nuk je çuar në namazin e natës. Normal se je lodhur gjithë ditën. Mirë është t'i përmbushësh të gjitha adhurimet, por kryej një herë aq sa mundesh. Zoti të pranon edhe kështu!" Punëtorit apo nëpunësit që nuk e kryen detyrën në orarin zyrtar të punës, shejtani i pëshpërit në vesh: "A nuk e sheh se sa shumë je duke punuar! Askush nuk ta shpëbblen sa duhet punën që bën! Se mos je vetëm ti për të punuar në këtë zyrë pune, po të tjerët çfarë bëjnë?"

Ja pra, këto këndvështrime dhe të tjera do të thonë në kuptimin e plotë të fjalës të të vërë në lojë egoja personale dhe të veshësh gënjeshtërën me petkun e së vërtetës. Në qoftë se arrijmë të shihemi në pasqyrën e ndërgjegjes, do të dalë në shesh se kush janë veprimet e gabuara që kemi bërë. Vetëm se duhet ditur se jo të gjithë njerëzit e kanë guximin të shihen në këtë pasqyrë. Si rezultat, tek njeriu formohet një personalitet që ndjen kënaqësi tek mashtron vetveten, beson tek gënjeshttrat që ia mëson vetes me kalimin e kohës, madje nis t'i konsiderojë ato si të vërteta absolute. Kur mbërrijnë në këtë situatë, ata nuk mjaftohen vetëm duke e gënjyer veten, por kur kanë pushtet fillojnë t'i detyrojnë të tjerët që t'i besojnë edhe ata gënjeshttrat për të vërteta. Këta persona janë ujë nën lëkurë delesh.



Dinjiteti I BESIMTARIT

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

“Fuqia dhe dinjiteti janë të Allahut, të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve.” (Munafikun, 8)

Dimensioni i diturisë dhe ndërgjegjshmërisë

Fjala arabe izzet (dinjitet), që gjendet në Kuranin Fisnik, ka edhe kuptimet nder, respekt, fuqi, epërsi, ngadhënjim. Ajeti i mësipërm nënvizon faktin se dinjiteti absolut i përket Allahut, ndërsa dinjiteti në kontekstin njerëzor ka një vend të rëndësishëm në marrdhënien mes besimtarëve dhe jobesimtarëve. *Izzetul-mumin* do të thotë dinjiteti, respekti dhe nderi i besimtarit. Në qoftë se fjalën arabe mumin (besimtar) do ta vlerësojmë me kuptimin e fjalës besim (iman), që në rregullat e gjuhës arabe cilësohet ismu'l-fail bi mana'l-mastar, atëherë kjo do të përkthehej dinjiteti i besimit. Për më tepër, në një ajet të Kuranit thuhet: ***“Thuaj: Allahu im që je zotëruesi i vërtetë i pasurisë! Ti ia jep pasurinë atij që do dhe ia heq prej duarsh atij që do. Ti dikë e bën figurë të lartë dhe dikë tjetër e poshtëron.”*** (Ali Imran, 26), duke na mësuar se cili është burimi i vërtetë i dinjitetit. Ndërsa në një ajet tjetër të Kuranit thuhet: ***“Kush kërkon dinjitetin, le ta dijë se dinjiteti absolut i takon vetëm Allahut.”*** (Fatir, 10), duke e sqaruar njeriun se nga vjen dhe se ku duhet ta kërkojë burimin e vetëm të dinjitetit që ai dëshiron të fitojë. Ndërsa në një ajet tjetër të Kuranit, duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve selem, thuhet: ***“Mos të të brengosin ty fjalët e tyre. Nuk ka dyshim se dinjiteti dhe fuqia janë të Allahut. Ai dëgjon dhe di gjithçka.”*** (Junus, 65), duke na mësuar në këtë mënyrë edhe ne besimtarëve se asnjë lloj propagande nuk ka për ta dëmtuar

dinjitetin e myslimanëve.

Fakti që në dy ajetet e fundit na bëhet e ditur se gjithë dinjiteti i takon Allahut, nuk nënkupton aspak se koncepti i dinjitetit dhe përshkrimi me të nuk mund të përdoret nga njerëzit dhe në mënyrë të veçantë nga myslimanët. Madje përkundrazi, çdo nivel dinjiteti, nderi dhe epërsie që zotërojnë njerëzit, janë shembëllime të këtyre attributeve absolute të Allahut dhe duke qenë i ndërgjegjshëm për këtë fakt ato fitojnë edhe më shumë vlerë kur mbarten edhe nga njeriu. Në një ajet tjetër të Kuranit thuhet qartë se **“Fuqia dhe dinjteti janë të Allahut, të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve.”** (Munafikun, 8)

DIMENSIONI SJELLJE

Nga ana tjetër, fjala dinjitet shpreh pozicionin superior të një personi kundrejt personave të tjerë dhe fuqinë e tij më të madhe ekonomike dhe sociale. Në këtë kuptim, fjala izzet (dinjitet) është antonimi i fjalës “zillet”, që ka kuptimin “dobësi, nënçmim dhe paaftësi”. Kështu në një ajet të Kuranit thuhet: **“O besimtarë! Ai që heq dorë nga feja islame, le ta dijë mirë se Allahu do të sjell një popull tjetër që Ai i do ata dhe ata e duan Atë. Një popull dinjitoz kundrejt femohuesëve dhe modest ndaj besimtarëve.”** (Maide, 54) Në ajetin e Kuranit që përshkruan sahabët thuhet: **“Ai është Muhamedi, i Dërguari i Allahut. Ata që janë përkrah tij janë të ashpër me femohuesit dhe të mëshirshëm për njëri-tjetrin...”** (Feth, 29) Sjellja dhe qëndrimi që në një ajet të mëparshëm shprehet me fjalën “dinjitoz” (eizze), në ajetin tjetër shprehet me fjalët “të ashpër” (eshidda). Nga kjo kuptohet se “qëndrimi i ashpër dhe dinjitoz” ndaj femohuesëve është shprehje e dinjitetit në sjellje.

Po kështu, në këto dy ajete tregohet qartë se dinjiteti i myslimanit që buron nga besimi e bën atë modest dhe të mëshirshëm ndaj besimtarëve të tjerë, ndërsa çdo lloj qëndrimi tjetër nuk përputhet me dinjitetin e besimit. Me këto ajete bëhet e qartë se myslimani i vërtetë nuk mund të sillet si luan ndaj myslimanit dhe njerëzve më të dobët se ai, ndërsa nga ana tjetër të qëndrojnë si mace e butë përpara jobesimtarëve dhe armiqëve.

Humbja nuk shkaktohet përherë nga mungesa e fuqisë fizike, e figurës së lartë dhe e dinjitetit. Historia ka treguar se edhe personat e pajisur me anë të mira të njeriut humbasin. Vetëm se kjo situatë nuk e ndryshon dhe as nuk e eklipson të vërtetën absolute, pra dinjitetin dhe epërsinë që buron nga



besimi. Kështu, pas betejës së Uhudit, Allahu u tha kështu myslimanëve të cilët e kishin humbur betejën: **“Mos u demoralizoni dhe mos u mërzitni. Në qoftë se keni besuar me të vërtetë, ju jeni përherë më superiorë ndaj të tjerëve.”** (Ali Imran, 139) Me këto fjalë Allahu edhe i ngushëllonte ata, edhe u kujton të vërtetën e pandryshueshme të kësaj jete. Argumenti i pandryshueshëm i kësaj të vërtete është shprehur qartë në një ajet tjetër ku thuhet: **“Allahu është me ju.”** (Muhamed, 35)

Fjala izzet (dinjitet), që përmendet në Kuran në lidhje me qafirët dhe munafikët, përdoret për të vënë në pah qëndrimet e tyre prej mendjemadhi dhe inatçiu që ekspozonin përpara bazave të fesë islame. Në qoftë se do të duhej të jepej një shembull, mund të japim si shembull ajetin: **“Kur atyre u thuhet ‘Kijeni frikë Allahun!’ ata në të vërtetë bëjnë gjynah për shkak të mendjemadhësisë dhe dinjitetit të tyre.”** (Bakara, 206)

NË KËRKIM TË DINJITETIT

Në ajetin e Kuranit, ku thuhet: **“Ata i bëjnë shok Allahut, se kujtojnë se në këtë mënyrë do të fitojnë më shumë respekt dhe dinjitet.”** (Merjem, 81) shprehet shumë qartë sjellja pa kuptim, e gabuar dhe pa vend e personave që adhurojnë objekte dhe njerëz të tjerë përveç Allahut, duke shpresuar se në këtë mënyrë do të fitojnë vlerë dhe dinjitet. Të kërkojnë nder dhe dinjitet aty ku nuk e gjen dot, është një veprim i kotë, ashtu siç edhe e kemi bërë të qartë në krye të artikullit. Logjika e jobesimtarit nuk e rrok dot këtë të vërtetë.

Me ajetin e Kuranit **“Sad. Beto hem në Kuranin që është plot këshilla dhe paralajmërime se fëmohuesit i ka kapluar mendjemadhësia dhe dëshira e kundërshtimit, në vend që t’ia vënë veshin këtij paralajmërimi.”** (Sad, 1-2)

Të jesh njeri dinjitoz dhe të kërkojë të mbetesh përherë i tillë, është pa dyshim diçka e bukur. Vetëm se dinjiteti në fjalë duhet të burojë nga besimi dhe ka si kusht që t’i drejtohet Allahut të Lartësuar që ka dinjitetin absolut. Poeti Mehmet Akif Ersoj e pati thënë me një dhembje të madhe dhe me një britmë

që të këput shpirtin se “dinjiteti është vetë feja islame.”

“O myslimanë! Kjo fe, për të cilën u zotuat që në botën e shpirtërave është feja e dinjitetit, e madhësisë, e lumturisë dhe e diferencimit mes së mirës dhe së keqes. Feja jonë nuk është feja e nënçmimit, e të gJORËVE dhe e nënshtrimit.

Nëse sot na vënë shkelmin, këtë e meritojmë.

Kështu ka përfunduar dinjiteti ynë, ku ka shkuar morali ynë?

Individët, grupet myslimane dhe qeveritë myslimane që përpiqen të kërkojnë dinjitetin dhe respektin e tyre, duke lënë mënjanë myslimanët dhe duke iu drejtuar grupeve dhe rrethëve jomyslimane bëjnë të njëjtin gabim që bënin edhe jobesimtarët, rreth të cilëve na paralajmëron edhe vetë Kurani. Ky është një qëndrim dhe sjellje e kundërt në themel me dinjitetin e besimtarit. Ndërkohë që myslimanit i ka hije qasja dhe qëndrimi që pat shprehur i ndjeri Muhamed Hamidullah, kur pati thënë: “O vëllai im mysliman gjynahqar. Ti për mua je më i afërt sesa një jobesimtar.” Në të kundërt, ata që lënë mënjanë njerëzit e vërtetë me dinjitet që janë myslimanët, duke bashkëpunuar kundër tyre me armiqtë e fesë islame, janë të barabartë me mynafikët që luftonin fshehurazi myslimanët dhe i tradhtonin ata pas krahësh. Në lidhje me mynafikët, në Kuran thuhet se: **“A kërkojnë dinjitet ata që braktisin besimtarët dhe bëhen miq me qafirët? Le ta dinë mirë se dinjiteti i takon vetëm Allahut.”** (Nisa, 139), duke u lëshuar njëkohësisht edhe paralajmërime shumë të rrepta.

Ndoshta për shkak të këtyre të vërtetave, myslimanit që i pati thënë një dijetari që po kalonte rrugës të bënte dua të shpëronte ymeti Muhamed, ai i qe përgjigjur:

- Po. Më trego se kush është ymeti Muhamed dhe unë do të them se ti ke shpëtuar.

Prandaj, të gjithë myslimanët, si vëllezër feje që janë, duhet të bëhen bashkë sërish drejt Islamit, drejt besimit, drejt dinjitetit, drejt pasionit moral, drejt mëshirës dhe faljes hyjnore.

*“O myslimanë!
Kjo fe, për të cilën u
zotuat që në botën e
shpirtërave është feja e
dinjitetit, e madhësisë, e
lumturisë dhe e diferencimit
mes së mirës dhe së keqes
dhe. Feja jonë nuk është
feja e nënçmimit,
e të gJORËVE dhe
e nënshtrimit.*

DISTANCIMI nga fitneja

All Riza Temel

Kuptimi etimologjik i fjalës arabe fitne është pas-trimi me zjarr i xeherorëve me përmbajtje ari apo argjendi, në mënyrë që prej tyre të përftohen ari dhe argjendi i pastër. Ashtu sikurse ari i vërtetë dallohet në një përbërje xeherorësh falë temperaturës së lartë përvëluese të zjarrit, edhe personaliteti i vërtetë i personit del në pah vetëm pas ngjarjeve të rënda dhe të vështira që ai përjeton në jetë. Fitne në përgjithësi përdoret në kuptimin e sprovës. Të gjithë njerëzit gjatë jetës së tyre përballen me një sërë problemesh materiale apo morale, si në planin personal, ashtu edhe në planin shoqëror, si rezultat i të cilave ata sillen në mënyrë pozitive apo negative. Këto vështirësi dhe probleme janë një lloj farkëtimi. Falë qëndrimit që mban personi ndaj tyre dalin në pah edhe personaliteti dhe karakteri i tij.

Sipas imam Birgiviut, fitne konsiderohet çdo veprim që nuk ka asnjë vlerë legjitime për njerëzit dhe u shkakton atyre konflikte, mospajtime, vuajtje dhe kokëçarje. Fitneja është paracaktimi i njerëzimit, si në planin personal, ashtu edhe në atë shoqëror, i cili do ta ndjekë atë deri në Ditën e Kiametit. Moslejimi i fitnes është parësor, por në rast se ajo nuk parandalohet, atëherë besimtari duhet të mbajë një qëndrim prej myslimani të vërtetë para fitneve.

Profeti Muhamed (a.s.), e ka paralajmëruar shpesh ymetin e tij në lidhje me fitnet që do të ndodhnin në të ardhmen dhe u ka mësuar atyre se si duhet të sillen para atyre fitneve. Ai që shkakton shpërthimin e një fitneje, meriton mallkimin hyjnor. Profeti ka thënë: *"Fitneja është në gjumë, prandaj Allahu e mallkoi atë që e zgjon!"* (Axhluni, Keshfu'l-hafa, hadithi 1817)

Fitneja në fillim është si thëngjilli i mbuluar me hi. Shkaktimi i fitneve është si të nxjerrësh thëngjillin e mbuluar dhe t'i vësh flakën shtëpisë. Për shuarjen e zjarrit përdoret uji, prandaj edhe nxitësit e fitneve ngjajnë me personat që i hedhin benzinë zjarrit. Sjellja e myslimanit përpara fitneve duhet të ngjasojë të paktën me qëndrimin e milingonës që me ujin, që mbante në gojë përpiquej që të shuante zjarrin që Nemruti kish-te ndezur për të djegur profetin Ibrahim.

Çdo mysliman e ka për detyrë të mos bëhet mjet që u hap rrugën fitneve që shkaktojnë në mesin e myslimanëve dhe njerëzve të tjerë frikë, kaos, rrëmujë, masakra, gjynahe apo mohim të Zotit, përkundrazi ai duhet të përpiket të zhdukë nga faqja e dheut secilën prej këtyre fatkeqësive që i rëndojnë njerëzimit. Për ata persona që nuk mund të bëjnë as një-rën dhe as tjetrën, është detyrim fetar durimi dhe distancimi nga fitnet. Në qoftë se shkëndija e fitnes nuk shu-het që në fillim, zjarri i saj ka për ta kapluar të gjithë shoqërinë dhe ashtu siç digjet bari i njomë bashkë me të thatin, ashtu ka për tu përfshirë nga dënimi hyj-nor edhe i dhunuari së bashku me dhunuesin.

"Ruajuni nga fitnet që nuk do të përfshijnë vetëm zullum-qarët që keni në mesin tuaj." (Enfal, 25)

Fitnet zhdukin sigurinë e je-tës dhe të pasurisë tek njerëzit, duke formuar kështu në shoqëri një atmosferë pasigurie dhe paniku. Në një atmosferë dyshimi, mëdyshjeje, frike dhe pasigurie nuk zhvillohet asgjë e mirë. Prandaj vetë zhdukja e fitnes është në vetvete një e mirë e madhe. Ja se si e pësh-kruan Zoti pamjen e frikshme të fitnes: ***"Shkaktimi i fitnes është akt më i rëndë se sa vrasja e një nje-riu."*** (Bakara, 191)

Ka fitne të tilla që njeriu më parë preferon të vde-së sesa të jetojë nën ndikimin e tyre. Fitnet mund të shkaktojnë edhe vdekje masive të popullsisë.

Profeti (a.s.), na ka mësuar me këto fjalë në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajë një mysliman për-para fitneve: ***"Para shpërthimit të Kiametit kanë për t'u shfaqur fitne të errëta si nata pa hënë. Gjatë aty-re fitneve njeriu do të zgjohet në mëngjes si besimtar dhe do të shndërrohet në jobesimtar në mbrëmje. Do të jetë në mbrëmje besimtar dhe do të zgjohet në më-***

ngjes si jobesimtar. Gjatë fitneve ai që rri ulur është më i mirë sesa ai që rri në këmbë. Ai që ecën me hap të ngadaltë është më i mirë sesa ai që vrapon." (Ebu Davud, Fiten 2, Tirmidhi, Fiten 33.)

Në kohë fitneje e rëndësishme është sjellja e kon-trolluar me qëllim shuarjen e zjarrit të fitnes, hedhja pas krahësh e thashethemeve, mprehtësia për të kuptuar atë që fshihet pas ndodhive të përditshme dhe sjellja me objektivitet, duke lënë mënjanë inter-esin personal, dashurinë apo urrejtjen ndaj persona-ve të caktuar. Një mysliman nuk i ka hije të përhapë gënjeshtër që dëgjon, sepse në këtë mënyrë ai nxit elektrizimin për keq të masave të njerëzve. Profeti (a.s.) ka thënë: ***"Vetëm përcjellja e çdo fjale që dëgjon tek palët e tjera konsiderohet një lloj gënjeshtre."*** (Muslim, Mukaddime.)

Në kohë fitneje e rëndësishme është sjellja e kontrolluar me qëllim shuarjen e zjarrit të fitnes, hedhja pas krahësh e thashethemeve, mprehtësia për të kuptuar atë që fshihet pas ndodhive të përditshme dhe sjellja me objektivitet, duke lënë mënjanë interesin personal, dashurinë apo urrejtjen ndaj personave të caktuar.

"Mos paso diçka që nuk e njuh mirë se çfarë është, sepse veshët, sytë dhe zemra kanë për të dhënë llogari." (Isra, 36) ***"O besimtarë! Kur ndonjë fa-sik ju raporton në lidhje me një ndodhi, interesohuni nëse fjalët e tij janë të vërteta. Në të kundërt, do të dëmtoni një bashkësi të tërë dhe për këtë shumë shpejt do të bëheni pishman."*** (Huxhurat, 6)

Në ditët e sotme, kur mje-tet e komunikimit janë zhvilluar shumë, ato përdoren edhe si një armë e frikshme për krijimin e vatrave të fitneve, në mënyrë që të shkaktohet kaos, pasiguri dhe panik në shoqëri. Besimtari duhet in-formuar në mënyrë të shëndoshë, me qëllim që të shmangë dhe asgjësojë kërcëni-met, provokimet dhe kurthet që ngre teknologjia virtuale ndaj tij, si dhe duhet përgatitur psikologji-kisht ndaj këtyre kërcënimeve. Drejtuesit e institu-cioneve, mediave, arsimtarët dhe figurat me peshë sociale kanë detyrë të rëndësishme në këtë drejtim. Në ditët tona janë përhapur pa masë metodat e për-baltjes së personaliteteve, duke përdorur kamerat e fshehta, përgjimet pa leje dhe fotomontimet. Në këtë mënyrë, mbrojtja e të drejtave të personit ndaj kë-tyre kompleteve është vështirësuar edhe më shumë. Përkrah masave administrative, juridike dhe teknike kundër këtyre kompleteve virtuale, duhet nisur edhe një edukim moral. Burimi i shumë problemeve shoqë-rore është dobësia morale. Brezave u duhet mësuar rëndësia e të drejtës së njeriut, dëmi dhe gjynahu që

shkaktojnë thashethemet, përgojimet, shpifjet dhe fyerja e njerëzve të tjerë.

Drejtuesit e shtetit dhe liderët shpirtërorë duhet të sillen me më shumë përpikmëri dhe të tejkalojnë dobësitë humane, si pasionet, famën dhe pasurinë duke bërë sakrifica për të mirën e shoqërisë, në mënyrë që të parandalohen fitnet. Ata duhet të jenë shumbull për gjithë shoqërinë e tyre.

Le të mësojmë nga sjellja e sahabiut Said b. Ubade, një shembull i rrallë në parandalimin e fitneve:

Sikurse dihet, pas vdekjes së Profetit (a.s.), përpara myslimanëve u shtrua një çështje delikate, siç ishte ajo e zgjedhjes së kalifit. Ensarët dëshironin që kalif të zgjidhej Sad b. Ubade, duke pretenduar se posti i kalifit u takonte atyre për shkak të kontributit të madh që kishin dhënë për fenë islame. Ata i kishin hapur krahët profetit Muhamed (a.s.), kur i gjithë gadishulli arab e konsideronte Profetin dhe myslimanët e Mekës si armiq të urreyer, duke ndarë me myslimanët të gjitha mundësitë e tyre ekonomike. Kur panë se myslimanët muhaxhirë nuk e përkrahnin këtë gjë, ensarët u propozuan atyre të kishin dy drejtues shteti, njëri nga ensarët dhe tjetri nga muhaxhirët. Fjalën e mori kandidati për kalif nga ana e muhaxhirëve, Ebu Bekri, i cili tha se kurejshët gëzonin prej shumë kohësh një respekt dhe autoritet të madh mbi arabët e tjerë për shkak të Mekës dhe të Qabes, prandaj caktimi i kalifit nga mesi i Kurejshëve ishte zgjidhja më e saktë. Në fund fare edhe ensarët e pranuan si më të drejtë këtë qasje dhe hoqën dorë nga pretendimet e tyre. Diskutimi u mbyll aty dhe nuk u hap më. Në qoftë se ensarët nuk do ta kishin treguar këtë mirëkuptim dhe sacrificë, do të kishte plasur lufta për pushtet që mund të kishte shkuar deri në konfrontim të armatosur, që mund ta kishte errësuar dritën e fesë islame. Qëndrimi i ensarëve në një çështje kaq delikate parandaloi një fitne të madhe dhe bëri të mundur që drita e fesë islame të përhapej në mbarë botën. Kandidati për kalif i ensarëve nuk u përбетua para Ebu Bekrit, por nga ana tjetër nuk ngriti më pretendimin e tij për t'u bërë kalif. Ai emigroi nga Medina në Damask, duke pasur frikë se prania e tij në Medinë mund të shndërrohej në shkak fitneje. Ai nuk e përmendi më gjatë gjithë jetës së tij pretendimin për t'u bërë kalif i myslimanëve.


Pretendimi i njeriut në lidhje me diçka që nuk i takon, është kotësi, por heqja dorë nga ana e tij nga një e drejtë e tij normale, me qëllim parandalimin e një fitneje dhe sigurimin e të mirës publike është virtyt. Për këtë arsye myslimani duhet të ketë shpirtin dhe botëkuptimin e ensarëve. Ja se si e pëshkruan vetë Zoti personalitetin fisnik të tyre me fjalët: **“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarrë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”** (Hashr, 9)

Në historinë botërore në përgjithësi dhe në atë islame në veçanti kanë ndodhur fitne të mëdha. Disa prej tyre janë vrasja e Omerit, Osmanit, Aliut, betejat e Xhemelit dhe Sifinit, shfaqja e sektit harixhi, ngjarja e Qerbelasë etj.

Sado që besimtari nuk i dëshiron, fitnet kanë për të vazhduar deri në Ditën e Kiametit. Profeti (a.s.), na ka paralajmëruar për këtë të vërtetë: **“Njerëzit do të shohin ditë të tilla që as vrasësi nuk e di përse ka vlarë dhe as i vrari nuk do ta dijë përse është vlarë.”** (Muslim, Fiten 56.) Një situatë kaosi ku nuk dihet se çfarë dhe përse bëhet një veprim i dëmshëm është pikërisht situatë e fitnes për të cilën flet feja islame. Në këto situata nuk është e lehtë të gjendet se kush është me të drejtë dhe kush është pa të drejtë, ndërkohë që shtohen vrasjet e pazbardhura, krimet, sabotimet, lajmet e rreme dhe agjitacioni dekonstruktiv. Kjo është tabloja e një shoqërie të shkatërruar.

Krimi dhe gjynahu që kryejnë ata që shkaktojnë fitnet janë pa dyshim shumë të mëdha, por përgjegjësi do të kenë edhe ata që bëhen mjet për përhapjen e fitneve, qoftë edhe pa dashje, si edhe ata që çojnë ujë tek mulliri i fitnes. Besimtari e ka për detyrë të mos i hedhë benzinë fitnes, por ujë që ta shuajë atë. Në të kundërt, zjarri i fitnes do të përhapet gjithandej, duke bërë hi çdo gjë së bashku me shpresat. Të gjitha shtresat e shoqërisë duhet të jenë kurdoherë vigilentë ndaj çdo lloj fitneje dhe fitnexhiu, në mënyrë që të ruhen rregulli shoqëror, vlerat materiale dhe ato financiare.





Devotshmëria

Kriteri i vlerësimit tek Allahu

Doç. dr. Kerim Bulladë

Njerëzit kanë ardhur nga një origjinë dhe janë shumuar nga një nënë dhe një baba i parë. Në këtë kontekst, Kurani pati shpalluar një sistem universal vëllazërie dhe barazie. Kjo e vërtetë theksohet me këto fjalë në Kuran:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkon të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa, 1)

Ashtu si shprehet qartë në ajetin e mësipërm, e gjithë raca njerëzore është shumuar nga çifti i parë burrë-grua. Të gjitha racat dhe etnitë që kanë ekzistuar në histori dhe ende ekzistojnë sot kanë ardhur nga një çift burrë-grua. I gjithë njerëzimi ka vetëm një krijues. Ai është Allahu që ka krijuar racat, ngjyrat, gjuhët dhe etnitë sipas caktimit dhe vullnetit të Tij. Asnjë njeri nuk vjen në jetë me dëshirën e tij. Prandaj askush nuk mund të pretendojë se gjuha, raca, ngjyra dhe prejardhja që ka është më superiore se ato të të tjerëve që janë të ndryshëm prej tij. Ky fakt në Kuran theksohet fuqishëm dhe bëhet e ditur se të gjithë njerëzit janë të barabartë.

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej

jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Huxhurat, 13)

Sikurse kuptohet edhe nga ajeti i mësipërm, personi që meriton vlerësim tek Allahu është ai që sillet me devotshmëri për shkak të frikës nga dënimi i Zotit. Fjala arabe “etka”, që përmendet në origjinalin arabisht të ajetit, ka disa kuptime, si ruajtja nga ato gjëra që do ta dëmtojnë besimtarin në jetën tjetër, distancimi nga veprimet dhe fjalët që janë gjynah, braktisja e atyre gjërave që Allahu i ka shpallur të ndaluara. Kështu njeriu më i devotshëm është ai njeri që tregohet i kujdesshëm ndaj kufijve që ka caktuar Allahu, që ndan qartë hallallin nga harami dhe e organizon jetën e tij në varësi të urdhrave dhe ndalesave të Zotit. Njeriu fiton vlerë dhe respekt në varësi të bindjes që tregon ndaj Allahut.

Në ajetin e mësipërm të Kuranit refuzohen ekstremizmat me bazë racën, ngjyrën dhe kombësinë dhe theksohet fakti se ndarja e njerëzimit në fise dhe raca ka për qëllim vetëm njohjen e ndërsjellë, afrimin dhe shkrirjen me njëri-tjetrin. Ajetet refuzojnë botëkuptimin që mbështetet tek raca dhe kombësia, duke i konsideruar ato njërën më superior se tjetrën, duke shkaktuar në këtë mënyrë padrejtësi, zullum, push-time, luftëra dhe çdo lloj dhunimi tjetër të të drejtave të njeriut. Ky princip i Kuranit është revolucion i madh në historinë e njerëzimit.

Njerëzit e ndarë në familje, fise dhe kombe të ndryshme dallojnë nga njëri-tjetri edhe nga gjuhët që flasin, ngjyra e lëkurave që kanë dhe mënyra e jetës që varion nga ndikimi i brezave gjeografikë dhe klimave të ndryshme ku ata jetojnë. Vetëm se këto dallime natyrore nuk i ndajnë dot njerëzit në fisnikë dhe jofisnikë. Pretendimi i epërsisë së një race mbi racat e tjera, i një kombi mbi kombet e tjera, i një ngjyre mbi ngjyrat e tjera, i një bashkësie mbi bashkësitë e tjera janë veprimet më të padrejta që mund t'i bëhen njerëzimit. Në asnjë mënyrë gjuhët, racat, prejardhjet dhe statuset sociale nuk mund të jenë justifikim për sulmin, pushtimin dhe dhunimin e

të drejtave të njerëzve të tjerë. (Fazlurrahman, Muhammed (s.a.v) Siret Ansiklopedisi, Tercüme, kurul, İnkılâb Yayınları, İstanbul, 1996, III, 153-154)

Profeti (a.s.), i ka zbatuar me përpikmëri parimet e shpallura në ajetet e mësipërme dhe e ka shtjelluar këtë temë në hadithe të ndryshme. Në çlirimin e Mekës ai u qe drejtuar me këto fjalë njerëzve të pranishëm:

- Lavdëruar qoftë Allahu që bëri të zhvisheni nga mendjemadhësia dhe turpet e periudhës së xhahilitit. O njerëz! Të gjithë njerëzit ndahen në dy grupe. Të parët janë njerëzit që janë të mirë dhe ruhen nga veprimet e këqija. Këta janë njerëz të vlerësuar tek Zoti. Të dytët janë njerëzit gjynahqarë, që nuk u binden urdhrave të Zotit. Ata nuk janë të vlerësuar tek Zoti. Të gjithë njerëzit janë bijtë e Ademit. Allahu e krijoi Ademin nga dheu. (Ebu Davud, Edeb, 120; Tirmidhi, Menakib, 75; Ahmed b. Hanbel, II, 361, 524; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, 125)

Profeti i pati kritikuar qarta-zi ata që bënë luftë vetëm për arsye fisnore. Ata që miratojnë zullumin për hir të fisit dhe që e ndihmojnë atë edhe kur e ka gabim, Profeti i pati krahasuar me devenë që po bie në pus dhe përpiqen ta shpëtojnë duke e kapur nga bishti. Profeti ka thënë se këta njerëz do të mbyten brenda gropës së gjynaheve. Profeti e ka bërë të qartë se ai që bën dallime fisnore, lufton për hir të fisit dhe vdes, nuk është anëtar i bashkësisë islame. (Ebu Davud, Edeb, 121.)

Sikurse shihet, në shoqërinë që synon të ndërtojë Kurani dhe në shoqërinë që formoi Profeti, nuk ekzistojnë dallimet gjuhësore, racore, kombëtare apo farefisnore. Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara Allahut. Kriteri i vetëm që tregon se kush është më superior se tjetri, është devotshmëria. Njerëzit marrin vlerë në varësi të masës se sa janë ata të bindur ndaj urdhrave dhe ndalesave të Zotit. Për këtë arsye, Kurani ka urdhëruar garën mes besimtarëve se kush është më i devotshmi dhe e ka ndaluar ndihmën në padrejtësi dhe gjynahe. (Maide, 5/2.)

*Njeriu
më i devotshëm
është ai njeri që tregohet i
kujdesshëm ndaj kufijve që
ka caktuar Allahu, që ndan
qartë hallallin nga harami
dhe e organizon jetën e tij
në varësi të urdhrave dhe
ndalesave të Zotit. Njeriu
fiton vlerë dhe respekt në
varësi të bindjes që tregon
ndaj Allahut.*



Afrimi nga e djathhta

Dr. Murat Kaja

Në krye të rrugëve që njeriu mashtron veten ose mashtrohet nga të tjerët, është edhe "qasja nga e djathhta". Egoja e njeriut apo shejtani i qaset njeriut nga e djathhta, në mënyrë që ta bindë se puna që do të veprojë është legjitime. Njerëzit me qëllime të këqija, që vijnë nga larg, të shumtën e rasteve u qasen viktimave të tyre nga e djathhta. Ata prodhojnë argumente të rrejshme, që tregojnë se ajo që bëjnë është e saktë ose përpiqen t'i shtrembërojnë argumentet e vërteta. Në këtë mënyrë, ata mundësojnë kryerjen e veprave të këqija, ndërsa ndërgjegjen shprehen se e kanë të qetë. Ata dinë të përdorin mjaft mirë ndjenjat e sinkerta të njerëzve të tjerë, qëllimet e tyre të mira dhe dëshirën e tyre për të bërë mirë.

Allahu thotë në Kuran:

Djali u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: "Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm." Dhe iu betua atyre (duke thënë): "Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!" Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit..." (Araf, 20-22)

"Por djalli e cyti: 'O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?'" (Taha, 120)

Qëllimi i Ademit (a.s.), nuk ishte i keq. Ai vetëm dëshironte t'i afrohej edhe më shumë Allahut, të bëhej edhe ai një melek, në mënyrë që të qëndronte përherë në xhenet. Shejtani e mashtroi atë pikërisht duke ia përdorur këto qëllime dhe dëshira të mira që kishte.

Le të vëmë re gjuhën plot ekzagjerime dhe përbe-timin që bëri shejtani. Të ekzagjerosh ato që thua, të shfaqësh një modesti të rrejshme, të zgjosh tek bash-këbiseduesi ndjenjat e mëshirës dhe dhembshurisë janë metodat më të rëndësishme që përdorin mash-truesit.

Një tjetër pikë e rëndësishme është edhe fakti se njerëzit me zemër të mirë, kujtojnë se të gjithë një-rëzit e tjerë janë të tillë. Ata kujtojnë se të gjithë një-rëzit ia kanë frikën Allahut pandehin se “askush nuk guxon të përmendë emrin e Zotit për diçka të pavër-tetë, sepse të gjithë ia kanë frikën pasojave në këtë botë dhe në botën tjetër që të sjell ky veprim.” Kështu edhe Ademi (a.s.) dhe Havaja patën pandehur se as-kush nuk përбетohet në emër të Zotit për diçka të pavërtetë. E vërteta nuk ishte aspak ashtu. Njerëzit xhahilë, të cilët nuk e njohin sa dhe si duhet Allahun, sado i lartë qoftë niveli i arsimit që ata kanë, mund të hedhin pas krahësh urdhrat e Allahut, duke kryer vep-rime të gabuara që nuk përputhen me logjikën, madje ata mund të thonë edhe gënjeshtra në emrin e Zotit. Këtë rast e patën shprehur edhe xhindët që qenë bërë myslimanë, duke e dëgjuar Kuranin nga Profeti (a.s.):

“Disa të marrë nga ne flasin gënjeshtra për Alla-hun, kurse ne mendonim se as njerëzit, as xhindët nuk flasin gënjeshtra për Allahun.” (Xhinn, 4-5)

Njerëzit me mend kanë frikë dhe dridhen kur me-ndojnë se mund të kryejnë një gabim të tillë ndaj Allahut, pasi ata e dinë mirë madhështinë dhe fuqinë e Zotit. Njerëzit xhahilë dhe të privuar nga devocioni fetar për fat të keq, i mashtrojnë njerëzit e tjerë duke u thënë atyre gënjeshtra në emër të Allahut, duke bërë në këtë mënyrë një gjynah shumë të madh.

Për këtë arsye Allahu i Lartësuar na paralajmëron:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë as-pak fëmijën e vet e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Alla-hut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.” (Llukman, 33; Fatir, 5; Hadid, 20)

Shejtani i mashtroi njerëzit duke u kujtuar atyre at-ributet Falës i madh dhe i Mëshirshëm që ka Allahu. Në këtë mënyrë ai i shtyn ata që të bëjnë gjynahe. Kur u përzua nga xheneti, shejtani pati guxuar t’i thoshte kështu Allahut të Madhëruar:

Ai tha: **“Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e**

djathta dhe nga e majta e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!” (Araf, 16-17)

Ashtu sikurse kuptohet edhe nga ajeti i Kuranit, shejtani jo vetëm që do t’i afrohet njeriut nga e djath-ta, por do të përdorë çdo rrugë tjetër. Kështu ai do të përdorë edhe njerëzit e tij nga mesi i njerëzve dhe i xhindëve, në mënyrë që të realizojë qëllimet e tij. Ndihmësit e shejtanit nuk janë vetëm xhindët, por edhe shumë njerëz që do t’i qasen atij nga para, nga pas, nga e djathta dhe nga e majta. Allahu urdhëron dhe thotë:

“Kështu, çdo profeti Ne i kemi caktuar armiq dajtë e njerëzve dhe të xhindëve, të cilët e frymë-zojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe të zbukurara për mashttrim.” (Enam, 112, Nas, 4-6)

“Në të vërtetë, dajtë i nxisin miqtë e vet që t’ju kundërshtojnë juve.” (Enam, 121)

“Ne i kemi bërë dajtë roje të atyre që nuk besoj-në.” (Araf, 30)

Lum ata që arrijnë t’i kuptojnë këto dredhi dhe mashttime që në këtë jetë dhe arrijnë të marrin masa që të shpëtojnë prej tyre! Ata të cilët nuk i kuptojnë dredhitë e tyre dhe vijnë në vete vetëm kur të jenë në botën tjetër, ka për të qenë shumë vonë, sepse atje çdo gjë do të ketë marrë fund. Kjo panoramë që për-shkruan gjendjen e tyre të mjerë dhe pendesën që do të përjetojnë në momentin që do ta kuptojnë se janë mashtruar, duhet të shndërrohet në një mësim për të gjithë ne:

“(Engjëjve do t’u thuhet): “Mbldhini njerëzit e kë-qin, shokët e tyre (daj) dhe idhujt që i kanë adhu-ruar krahas Allahut e tregojuni atyre rrugën e Zja-rrit flakërues! Ndalini ata, se do të pyeten: “Ç’keni që nuk e ndihmoni njëri-tjetrin?” Por, atë Ditë ata do të jenë plotësisht të dorëzuar dhe do t’i afrohen njëri-tjetrit, duke u grindur. (Pasuesit) do t’u thonë (prijësve): “Ju na vinit nga ana e djathtë.” (Saffat, 22-28)

Në qoftë se njohuritë e njeriut në lidhje me Zotin, me fenë e tij dhe me arsyen e ardhjes së njeriut në këtë botë nuk janë të sakta dhe të shëndosha, atë kanë për-ta mashtruar shumë lehtë mashtruesit e shkathtë me këto punë. Madje, do t’u qasen atyre me fjalë të vër-teta. Më pas do të përdorin të gjithë mundësitë e atij personi, me qëllim përmbushjen e synimeve të tyre të mbrapshta. Prandaj njeriu duhet të jetë i imprehtë, të marrë informacionin nga burimet e sakta dhe të njohë shumë mirë dituritë themelore të fesë.



Xhafer Durmush

Bëhu FJALËMIRË!

“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t’ua vënë veshin.” (Ibrahim, 24)

Brenda një ore, u ula që të lexoja ajetet plot urtësi të Fjalës Hyjnore më tërhoqën shumë vëmendjen hollësi-të që janë të ngërthyera brenda fjalës arabe “kavl” që do të thotë “fjalë”. Ajetet që i japin formë botës shpirtërore të myslimanit, i rrëfejnë atij rrugën drejt angazhimit për punë të hajrit dhe të mira. Ata orientojnë gjuhën e tij. E kthejnë timonin e “fjalës” drejt mirësisë dhe bamirësisë, duke përdorur cilësi të ndryshme të tyre:

Për shembull, ato na mësojnë që fjalët tona duhet të jenë “fisnike” (kerim) kur u drejtohem prindërve tanë. (Isra, 23) Kjo do të thotë “folu prindërve me fjalë të mira dhe tregohu përherë bujar me ta.”

Në një ajet tjetër që na mëson sërish se si të flasim me prindërit tanë, na mësohet që fjalët tona të jenë “mejsur” (Isra, 28.), që do të thotë “t’u themi fjalë të mira, kurajuese dhe shpresëdhënëse”. Dua të tërheq vëmendjen se urdhri hyjnor, që fjalët të cilat u themi prindërve të jenë “mejsur”, vjen menjëherë pas ajetit që na urdhëron që “prindërve as mos t’u thuhet uf”, që të sillemi mirë me të afërmit tanë dhe t’u japim hakun që i takon të varfrit dhe jetimit.

Ajete të tjera na mësojnë që fjalët që do t’u themi grave, fëmijëve tanë, jetimëve dhe të varfërve të jenë

“maruf” (Bakara, 235; Nisa, 5 dhe 8), që do të thotë se ato duhet të jenë fjalë “që të gjithë njerëzit dëshirojnë që t’u thuhet”. Ka rëndësi fakti që urdhri i këtushëm ka lidhje edhe me të gjithë ata që përbëjnë rrethin tonë të afërt.

Fjalët që duhet t’u thuhet jetimëve duhet të jenë “sedid” (Nisa, 63; Ahzab, 70), që do të thotë “fjalë të sakta”. Ky ajet është zbritur për jetimët, në lidhje me të cilët Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë: “Ai që kujdest dhe mbron jetimin dhe unë kemi për të qenë kështu në jetën tjetër.” dhe tregoi dy gishtat e afuar të dorës.

Në një ajet tjetër urdhërohem të këshillojmë edhe njerëzit, për zemrat e të cilëve Allahu na bën të ditur se janë të ngurta ndaj fjalës së mirë. Fjalët që do t’u themi atyre duhet të jenë “belig” (Nisa, 63), që do të thotë “fjalë me efekt dhe të qarta”. Këtu dua të theksoj rëndësinë që i jep Kurani retorikës.

Profetët Musa dhe Harun (alejhimas selam), që u urdhëruan të përcillnin urdhrin e Zotit tek Faraoni, u mësuuan nga ana e Zotit t’i flasin atij me fjalë “lejjin” (Taha, 44), që do të thotë “fjalë të ëmbla dhe të buta.” Duhet menduar thellë në lidhje me rëndësinë që ka fjala e ëmbël dhe e butë kur u drejtohesh njerëzve të dhunshëm dhe të egër siç që faraoni.

Këtu duam të sqarojmë këtë gjë para së gjithash: megjithëse në ajetet e mësipërme na mësohet se cilën gjuhë duhet të përdorim kur u drejtohem personave të ndryshëm që takojmë në jetën tonë, nuk është e drejtë që këtë ta kufizojmë vetëm me këto grupe njerëzish. Përkundrazi, butësia, retorika, drejtësia dhe thjeshtësia na mësojnë rreth cilësive që ka të folurit. Ato na rrëfejnë edukatën e bashkëbisedimit, duke filluar nga njerëzit më të afërt deri tek ata më të largët dhe nga njerëzit më arrogantë deri tek ata më të thjeshtët. Ajetet na mësojnë se gjuha që duhet të përdorim me persona të ndryshëm nuk mund të jetë e njëjta, por ndryshon në varësi të bashkëbiseduesit tonë.

Natyrë e butë dhe e thjeshtë që karakterizonte gjithë jetën e Profetit (a.s.), është vërtetuar me ajetin e Kuranit: **“Ti je sjellë me të butë me ta falë mëshirës së Allahut.”** (Ali Imran, 159.) vetë Profeti i pati përmbledhur me “thirrjen drejt fjalës së bukur” cilësitë që tregohen në ajetet e mësipërme, kur i pati mësuar sahabët e tij: **“Ruajeni veten nga zjarri i xhehenemit, qoftë edhe duke dhuruar një gjysmë hurme. Kush nuk ka as një të tillë, atëherë le të flasë fjalë të mira.”** (Buhari, Edeb 34.)

Sipas mendimit tim, të gjitha këto duhen përmbledhur me ajetin e Kuranit, ku thuhet: **“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t’ua vënë veshin.”** (Ibrahim, 24) Nuk duhet harruar se “fjala e mirë”, të cilën na e mëson Kurani, duhet ushqyer në mënyrë të vazhdueshme me shkencë, meditim dhe vepra të mira.

Ashtu siç pati shkruar edhe Ibrahim Hakki Erzurumasi, me të drejtë feja jonë na mëson “të sillemi mirë me të gjitha krijesat dhe t’i trajtojmë sa më me dinjitet ato”. Feja jonë kërkon prej nesh që të edukojmë organet e trupit tonë, duart, këmbët, sytë, veshët dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, gjuhën tonë. Nga gjuha e myslimanit duhet të rrjedhë sheqer. Feja na mëson që fjalët tona të jenë fisnike, retorike, të buta dhe të thjeshta. Fjala e mirë zë vend në zemrën e çdo njeriu.

Zoti na ka dhuruar neve fjalën më të bukur hyjnore, Kuranin, duke na e mësuar atë përmes gjuhës së Profetit tonë, si një lloj sadakaje të fjalës së mirë.

Shkurtimisht, myslimanët e kanë detyrim fetar që ta përdorin fjalën me drejtësi dhe me butësi.

Lexo-Mendo

ÇFARË ËSHTË “SIBGATULLAH”?

Në suren Bekare besimtarët urdhërohen të thonë se **“janë ngjyrosur me bojën e Allahut”? Kush të ngjyros më mirë se sa Allahu? Ne jemi vetëm robërit e Tij!** (Bekare, 138)


Çfarë do të thotë sibgatullah?

Ngjyrosja e Allahut (sibgatullah) do të thotë natyra e pastër e njeriut, me të cilën Allahu e krijoi atë. Do të thotë boja e fesë islame. Feja islame, së bashku me besimin, adhurimet dhe moralin e lartë, e vetmja fe e pranuar tek Allahu. Përsosmëria shpirtërore dhe morale që fitohet vetëm në sajë të zbatimit dhe përjetimit të fesë islame. Feja e pandryshueshme e Allahut, ligji i Allahut në jetë.

Ashtu siç do të kuptohet edhe nga këto kuptime që merr fjala sibgatullah, është ngjyra e rrobës me të cilën u krijua njeriu, rroba mbi të cilën gjenden shenjat e besimit dhe të adhurimit. Meqë të dyja ato janë stoli

më vete, është bërë ky krahasim.

Në ajetin e mësipërm në vend të fjalës natyrë (fitrat) është përdorur fjala ngjyrosje (sibgat). Edhe arabët e krishterë përdorin fjalën sibgat, kur pagëzojnë fëmijët e tyre në ditën e shtatë të lindjes. Pagëzimi në një aspekt ka atë rëndësi që ka edhe akti i synetllëkut tek myslimanët. Kështu, në ajetin e mësipërm refuzohet pretendimi se “pagëzimi me ujë i fëmijës e bën atë të pastër fetarisht”, pasi të gjithë njerëzit janë krijuar me natyrë të pastër nga ana e Allahut. Në ajet përdoret fjala boja e Allahut, pasi të krishterët arabë përdornin një lëndë të verdhë në ujin e pagëzimit dhe kjo bënte që të pagëzuarit të dalloheshin se janë pagëzuar për shkak të ujit me bojë. Ajeti na mëson se duhet ruajtur boja e Allahut që është pastërtia e vërtetë, duke na e bërë të qartë se vetëm robëria ndaj Allahut bën të mundur ruajtjen e pastër të natyrës njerëzore.





Historia e Elefantit

Jasin Demlrxhi

Elefanti është një kafshë që ka tërhequr përherë vëmendjen e njerëzve për shkak të fizikut të tij të madh dhe të fuqishëm.

Në lidhje me njohjen e parë mes njeriut dhe elefantit ekziston një përrallë, që është shumë e rëndësishme, sepse përmes saj pasqyrohet bota e brendshme, mendimet dhe sjelljet e njeriut.

Ajo hedh gjithashtu dritë edhe rreth fenomeneve që ndodhin në shoqëri.

Kjo përrallë na mëson se si e njohën njerëzit e verbër elefantin dhe si e përshkruan atë.

Fjalët që ata formuan për të përshkruar elefantin janë shumë kuptimplote. Secili prej tyre i bënte një përshkrim të vetin atij trupi të madh, por që përshkrimet nuk kishin pikë të përbashkët.

Ja se si rrëfëhet në veprën Tefsiri Ruhu'l-Bejan kjo histori:

Ishte një qytet banorët e të cilit kishin të gjithë probleme me shikimin.

Këta banorë kishin dëgjuar rreth elefantit dhe ishin shumë kureshtar rreth kësaj kafshe.

Kishin dëgjuar se elefanti është një kafshë me trup të stërmadh dhe shumë i fuqishëm.

Ata dëshironin që ta njihnin nga afër këtë kafshë.

Një ditë prej ditësh nga ai qytet kaloi një karvan.

Në qytet u përhap lajmi se bashkë me karvanin ishte edhe një elefant.

Atëherë banorët e qytetit në formë grupesh vinin tek karvani për të shuar kureshtjen e tyre në lidhje me elefantin.

Njëri prej tyre zgjati dorën drejt kafshës.

Dora e tij i zuri veshin e madh të elefantit.

Ai mendoi se elefanti është një kafshë në formë mburoje.

Një tjetër zgjati dorën dhe preku hundën e stërgjatë të elefantit.

Ai mendoi se elefanti është një kafshë e madhe si kolonë.

Një tjetër preku shpinën e elefantit.

Ai mendoi se elefanti është një kafshë në formë tavoline.

Kështu këta persona e imagjinuan në mendjet e tyre elefantin në formën që ata prekën me duart e tyre.

Të gjithë e shuan kureshtjen që kishin për elefantin dhe u kthyen të gjithë të lumtur në qytet.

Kur u kthyen në qytet secili prej tyre e përshkruante elefantin në formën që e kishte perceptuar atë.

Populli u kishte besuar, por kur ishin ulur të bisedonin me njëri-tjetrin secili kishte filluar ta përshkruante sipas mendjes së vet.

Madje kishin filluar që të përdornin edhe argumenta për të mbështetur mendimet e tyre.

- Thonë se elefanti, në kohë lufte, vihet në ballë të ushtrisë. Kështu që elefanti është si mburojë.

- Thonë se në luftë elefanti përdoret për të sulmuar ushtarët e armikut, prandaj ai është në formë heshte.

- Elefanti mban pesha shumë të rënda, kështu që ai duhet të jetë në formë të sheshtë. - argumentonin njerëzit.

O njeri! Pa mendo tani se si e përkufizonin ata njerëz elefantin.

Si mund të shpëtonin ata nga kundërshtimi që lindin nga mënyra sesi e përshkruante elefantin secila palë?

Të gjithë njerëzit e urtë e dinë se askush nuk mund të bëjë përshkrimin e saktë të elefantit, qoftë edhe duke përdorur argumentet e tyre.

Njerëzit e tjerë janë sjellur përherë në këtë mënyrë që të kuptonin ngjarjet sociale.

Ata janë përpjekur që të sqarojnë këto ngjarje vetëm nëpërmjet mendimeve të tyre të njëanshme, sipërfaqësore dhe të ngushta.

Ndërkohë që Zoti ka urdhëruar dhe ka thënë se: **“E vërteta është vetëm ajo që vjen nga Zoti yt. Mos u bëj edhe ti dyshues.”** (Ali Imran, 60)

Në qoftë se njeriu e njeh me të vërtetë Zotin, profetin e Tij të dashur dhe librin hyjnor, ai nuk ka për të rënë kurrë në rrugë të gabuar. Ai që mbërrin marifetullahun, nuk ka për të qenë kurrë i verbër ndaj ngjarjeve.

Ai që i dorëzohet Allahut, poseduesit të gjithçkaje, do të shpëtohet nga të gjithë llojet e dyshimeve. Allahu është pronari i vetëm dhe i plotfuqishmi. Ai di gjithçka. Ai sheh dhe dëgjon gjithçka. Ai nuk ka asnjë atribut që bie ndesh me madhështinë e Tij. Ai vepron me vullnetin dhe dëshirën e Tij. Ai ka krijuar të mirën, të keqen, besimin dhe mosbesimin. Nuk ka krijues tjetër përveç Tij. **“Askush nuk është i ngjashëm me Të.”** (Shura, 11)

Ai u ka dërguar njerëzve shumë profetë. Muhamedi

(a.s.) është i fundit prej tyre. Ai që i bindet Profetit i është bindur vetë Allahut. Ja se si shprehet ky urdhër hyjnor në ajetet e Kuranit:

“Bindjuni Allahut, Profetit dhe drejtuesve tuaj.” (Nisa, 59)

“Veproni ato që u ka urdhëruar Profeti dhe largohuni nga ato gjëra që ai ua ka ndaluar.” (Hashr, 7)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ua ka ndaluar besimtarëve që të shoqërohen me njerëzit bidatçinj dhe e ka bërë të qartë se ai është larg tyre. Në një hadith ai ka thënë:

“Do të vijë një bashkësi që e refuzon traditën profetike dhe kërkon të deformojë fenë. Mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i njerëzve do të jetë mbi ta.” (Dejleml, Hadith no: 8879, 882.)

Ja se si na këshillon Ismail Hakki Bursevi, pasi na ka treguar ngjarjen e elefantit:

“Ai që do të jetojë në një kohë kur besimet janë të shumta, kontradiktat e panumërta dhe dijetarët e paktë në numër, duhet të ketë parasysh dymbëdhjetë pikat që do të përmend më poshtë. Ato janë stolia dhe ekuilibri i palëkundur i dijetarëve, themeli i lumturisë së përbashkët. Ai që ka këto karakteristika, është njeri i Zotit dhe ndjekës i rrugës hyjnore. Kush nuk i ka këto karakteristika, do të bjerë në gjendjen e cytësit të mbrapshtë që i shtyen njerëzit drejt veprimeve të gabuara. Dymbëdhjetë pikat janë:

- 1- Bashkëbisedimi me besimtarët e devotshëm.
- 2- Të zbatosh urdhrat dhe këshillat e tyre.
- 3- Të jesh i kënaqur me caktimin e Zotit.
- 4- Të jesh në paqe me krijesat e Allahut.
- 5- Mos të shtypësh popullin.
- 6- Po pate mundësi t'u bësh mirë atyre.
- 7- Të jesh i devotshëm, të ngopesh me pak ushqim dhe të ushqehesh vetëm me rrugë hallall.
- 8- Mos të jesh i pangopur.
- 9- Mos të flasësh kur nuk është e nevojshme dhe mos të kapesh nga iluzionet se je i ditur.
- 10- Të jesh i moralshëm.
- 11- Të bësh jetë modeste.
- 12- Mos të kesh pretendime, të jesh përherë në lutje.

Allahu na e bëftë të mundur të gjithëve ne besimtarëve që të dimë se çfarë është e vërteta që ta pasojmë atë dhe çfarë është e gabuara që të distancohemi prej saj.

MOS LUAJ *me natyrën njerëzore*

Njeriu është një enigmë e vështirë për t'u kuptuar. Në dallim nga krijesat e tjera njeriu është pajisur me intelekt, por të shumtën e rasteve ai nuk vepron në përputhje me mendjen e tij, por nën ndikimin e dëshirave të tij. Dëshirat lindin nga qendra e brendshme e njeriut, siç janë intelekti, egoja apo vetë natyra njerëzore ose nga pëshpëritjet që na bëjnë krijesa që gjenden jashtë nesh. Ka rëndësi shumë të madhe që njeriu të arrijë të zbulojë se nga e marrin shtysën dëshirat e tij, në mënyrë që ai të mund të kryejë veprimin e saktë. Dëshirat drejt të cilave na nxisin shejtani dhe egoja janë të panevojshme dhe të dëmshme, ndërsa dëshirat drejt të cilave na shtyn natyra jonë njerëzore janë të shumtën e herëve të domosdoshme dhe të vlefshme. Pjesa më e madhe e njerëzve e zgjedhin rrugën nga do të shkojnë më shumë nga nxitësit që përmendëm më lart, sesa nga përdorimi i intelektit. Për këtë arsye, edhe imam Rabani, ashtu si gjithë sufistët e tjerë, e këshillon të nxënësin e tasavvufit (salik) që para së gjithash ta ruajë zemrën e tij nga ndjenjat e pavlefshme:

"Besimtari nuk duhet të synojë apo të dëshirojë gjë tjetër në këtë botë më shumë se sa Zotin. Në qoftë se besimtari nuk e arrin këtë nivel, koka dhe këmbët e tij do të zgjidhen nga lidhjet e bindjes ndaj Zotit. Atëherë besimtari bëhet rob i dëshirave të egos së tij dhe duke u shkuar pas dëshirave dhe epsheve të tij, hyn nën urdhrat e shejtanit duke u bërë kështu skllavi i egos së tij. Në qoftë se njeriu e arrin fatlumturinë që ia fal pikësynimi i Zotit, kjo ka lidhje me arritjen e shkallës së veliut të veçantë, që do të thotë arritja e një amshueshmërie të plotë shpirtërore dhe e një shkrirjeje të plotë me dëshirat e Zotit." (Mektubat, Volumi III, Letra 27)

Imam Rabani na mëson se duke u dhënë fund dëshirave të panevojshme, njeriu nuk duhet të ngatërrojë

me njëra-tjetrën dëshirat që burojnë nga humanizmi i njeriut. Ka ndodhur që shumë sufistë e kanë kuptuar gabimisht këtë gjë. Sipas imam Rabanit, njeriu ka disa nevoja në natyrën e tij të pastër njerëzore që duhet t'i përmbushë. Rrugëtari (salik), i cili dëshiron të bëjë përpara në rrugën e përshtatshmërisë islame nuk do të thotë se do të bëhet melek dhe nuk do të ketë më nevoja humane që duhet të përmbushë. Në qoftë se përsosmëri shpirtërore do të thotë mosplotësim i nevojave personale, atëherë Zoti do të na kishte krijuar si melekët dhe do të kishte kërkuar prej nesh të bëhemi si ata. Për këtë arsye, plotësimi i nevojave të njeriut në ushqim dhe pije në një masë të ekuilibruar nuk bie ndesh me përshtatshmërinë:

"Edhe besimtarët e pjekur nga aspekti i devocionit mund të kërkojnë dhe dëshirojnë gjëra të caktuara në këtë jetë. Kështu për shembull, Profeti ynë (a.s.), e kishte shumë qejf të shijonte ujin e ftohtë dhe ëmbël-sirën. Megjithatë dëshira e tij më e madhe ka qenë pa dyshim udhëzimi i ymetit, ashtu sikurse bëhet e qartë edhe në Kuran.

Njeriu i kërkon disa gjëra si rezultat i natyrës së tij njerëzore. Këto kërkesa të njeriut vazhdojnë bashkë me të deri në fund të jetës së tij. Kështu në klimë të nxehtë natyra e njeriut kërkon freskun, ashtu sikurse në kohë të ftohtë ai ka nevojë që të ngrohet. Këto lloj kërkesash nuk bien ndesh me natyrën e njeriut dhe kushdo që dëshiron t'i plotësojë sa më mirë këto nevoja nuk konsiderohet se është i dhënë pas qejfeve të tij, sepse përmbushja e nevojave të natyrës njerëzore konsiderohet jashtë kuadrit të detyrimeve fetare dhe burimi i tyre nuk është nefsi emmare."

Me këto fjalë imam Rabani shpalos qartazi dallimin



e rëndësishëm mes mistikës islame dhe murgërisë së krishterë apo misticizmit indian. Mistikët e këtyre dy besimeve mohojnë nevojat njerëzore që Allahu ka vënë në natyrën njerëzore në emër të përshtatshmërisë. Ata ndalojnë martesën dhe shkojnë aq larg në jetën askete, sa disa prej tyre vdesin për shkak të kësaj jete. Ndërkohë që Profeti e pati ndaluar prerazi këtë lloj asketizmi. Nevojat që mëson feja islame dhe kanë mësuar mistikët myslimanë që të braktisen janë nevojat e panevojshme dhe të ekzagjeruara:

“Nefsi është i prirur ndaj shpërdorimit të asaj që konsiderohet mubah, ndaj haramit dhe ndaj gjërave të dyshimta. Nefsi nuk ndërhyr në gjërat e nevojshme dhe të pashmangshme të jetës. Burimi i angazhimit me gjëra të kota është interesimi i tepruar me gjërat që janë mubah në vetvete. Gjëja mubah, që përdoret së tepërmi dhe në mënyrë të padrejtë ndodhet pranë gjërave që janë haram. Në qoftë se njeriu e ngre pak këmbën drejt saj si rezultat i cytjeve të shejtanit ka për ta parë veten brenda rrethit të haramit. Atëherë dervishët që nisin jetën e tasavvufit e kanë jetike që të mjaftohen vetëm me atë masë të domosdoshme që i duhet çdo njeriu për jetën e tij të përditshme. Tejkalimi i kësaj mase hyn në fushën e mubaheve të panevojshme dhe të tepruara.

Për këtë arsye dervishi nuk duhet që të pasojë çdo gjë që i vjen ndërmend dhe ia do xhani, por duhet të meditojë mirë më parë se cili është burimi i dëshirës që i ka kapluar zemrën. Imam Rabani shprehet se dëshirat burojnë nga njëra prej dy burimeve që janë frymëzimi i melekut dhe cytjet e shejtanit:

*Shkaqet e jashtme që shkaktojnë daljen në pah të dëshirave, vijnë nga dy burime. Ajo mund të jetë një këshillues i Zotit që të orienton drejt së mirës. Çdo besimtar i mirë ka në zemër një këshillues nga Allahu i Lartësuar. Në të kundërt, është vetëm shejtani që mbjell farat e armiqtësisë dhe të sherrit në zemrën e njeriut.”***“Shejtani u premtonte dhe i mban me shpresa, por fjala e shejtanit nuk është gjë tjetër përveçse mashtrim.”** (Nisa, 76)

Sipas imam Rabanit, mposhtja e cytjeve të shejtanit është më e lehtë sesa cytjet e nefsit, sepse në qoftë se cytjet e shejtanit na vijnë nga jashtë, cytjet e nefsit vijnë nga brenda nesh dhe janë të ngërthyera me natyrën tonë njerëzore:

Shkurtimisht, çdo veprim që buron nga nefsi emmare është një sëmundje vetjake dhe bie ndesh me pozitën e njeriut si rob i Zotit, pasi është një helm vdekjeprurës për besimin. Kurse pëshpërimat e shejtanit, si dhe çdo gjë tjetër e mbrapshtë që na vjen nga jashtë, mund të konsiderohen si sëmundje kalimtare që kanë kurë më të shkurtër. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk ka dyshim se dredhitë e shejtanit janë të tejkalueshme.”** (Nisa, 120). Fatkeqësia e njeriut është egoja e tij. Egoja jonë, që është armiku i shpirtit dhe miku më i keq që kemi në këtë jetë. Shejtani është armiku i jashtëm; na mund dhe na shmang nga rruga e drejtë vetëm falë ndihmës që i jep atij armiku ynë i brendshëm që është egoja.

Një tjetër vështirësi që të krijon lufta me egon është fakti se egoja është edhe armiku i vetvetes. Nuk është e lehtë të edukosh një krijesë apo person që ia do të keqen vetes. Këtë mund ta arrijnë vetëm myrshidët e mëdhenj:

Krijesa më injorante në këtë botë është nefsi emmare, sepse ai është edhe armiku i vetes... Ai ia do të keqen vetes. Qëllimi kryesor i tij është të shkatërrojë veten. Ai kërkon që të ngrejë krye kundër Zotit, që është dhuruesi i të gjitha begatave për të dhe t'i bindet shejtanit që është armiku i Zotit.

Pra, si përfundim, themi se pretendimi i disa mistikëve që rrugëtari (salik) duhet të mohojë nevojat e tij bazë të natyrës njerëzore në emër të edukimit të nefsit, nuk është i drejtë. Përmëshja e nevojave tona njerëzore me të cilat jemi krijuar, nuk e pengon zhvillimin shpirtëror. Rëndësi ka që mos të kalojmë masën teksa e bëjmë këtë gjë. Kalimi i masës me përmëshjen e nevojave shpie në kalimin e masës me mospërmëshjen e tyre dhe e kundërta, prandaj detyrimet e panevojshme në emër të mistikës shkaktojnë efekt të kundërt duke bërë që mospërmëshja e nevojave jetike dhe logjike të kësaj jete të zëvendësohen me kryerjen e haramëve. Allahu na ndihmoftë të gjithëve në këtë luftë të vështirë! Amin!

Pyetjet

Bëje një të mirë dhe hidhe në det,
Po s'ta diti peshku, ta di Zoti vetë!



A jeni gjendur ndonjëherë pa ujë, pa bukë dhe pa ajër? A ju kanë sulmuar ndonjëherë banesat me armë të rënda ose bomba? A ju kanë fishkëllyer ndonjëherë plumbat pranë veshit? A keni përjetuar në jetën tuaj ndonjëherë nga këto situata të rrezikshme për jetën? A nuk i keni pasur para jush ushqimet dhe në frigorifer ato që tepruan prej ushqimeve tuaja? A keni jetuar ndonjëherë në një shtëpi pa tavan, pa mur apo pa dyer? A keni bluar misër apo grurë në mulli? A ju është djegur rroba teksa përpiqeshit të ndiznit zjarrin në vatër? A nuk jeni edhe ju njëri nga përtacët që përtojnë të bëjnë miellin gati për bukë, megjithëse në kuzhinë kanë sobën, nga rubinetat rrjedh uji dhe në dollape gjendet mielli? A jeni edhe ju një nga njerëzit që teksa jetojnë në rehati dhe në bollëk, tregohen mosmirënjohës ndaj Zotit dhe hahen me vete përse nuk arrijnë të fitojnë edhe më shumë?

A ju ka munguar ndonjë gjë fëmijëve tanë? A kanë përjetuar ata periudha të gjata kur nuk gjenit dot bukë për t'u dhënë për të ngrënë? A kanë veshur vallë ata rroba me arna? A ka ndodhur që shtëpitë tona të ngjasojnë sadopak me shtëpinë e Profetit? A ka ndodhur që në dollapin tuaj ushqimi i vetëm për t'u ushqyer të mbetej një gjysmë kile orizi? A ka ndodhur që mos ta kemi ndezur sobën tri ditë njëra pas tjetrës, për shkak se nuk kemi pasur se çfarë të gatujmë brenda saj? A na ka mjaftuar një vakt për gjithë ditën? A kemi ditur të ngopemi për një ditë të tërë vetëm me një lloj ushqimi?

Sa ditë me radhë keni udhëtuar pa pasur asnjë para në xhep? Sa herë jemi ndjerë të turpëruar që jetojmë në një botë ku fjala e fundit e fëmijës që vdiq nga uria ka qenë: "Do të më japë bukë Allahu kur të shkoj në xhenet!", ndërsa ne jetonim mes luksit apo kur dëshirojmë të hymë në xhenet, ndërsa nga ana tjetër kemi të ftohtë të marrim abdest? Sa herë kemi frenuar të marrim një rrobë të re, megjithëse dollapin e kemi të mbushur dëng me rrobat e mëparshme? Sa hise kemi ne nga përpikmëria fetare që e konsideron shpenzim të kotë kërkimin e një gjëje më shumë se tri herë?

Teksa shpenzojmë me miliona lekë për kolltuqe që vetëm do të hijeshojnë shtëpinë, për vela nusërie që nuk do t'i veshim më shumë se një herë në jetë apo për shtëpi luksi që nuk kanë asnjë farë lidhjeje me banesat ku jetonte i Dërguari i Allahut, a keni ndjerë ndonjëherë brerjen e ndërgjegjes për gjithë këto shpenzime të panevojshme që po kryeni?

A jemi bërë edhe ne si ata që nuk e lënë asnjë çast pas dore thirrjen në rrugën e drejtë dhe të punëve të mira dhe nuk kanë rënë nën robërinë e egos së tyre, as prej frikës nga gjynahet dhe as nga shpresa për sevapet? A kemi thënë me zemër: "O Zoti im i Madhëruar! Falënderuar qofsh Ti që je Krijuesi im, i Cili i fal edhe gjynahet e mëdha dhe je aq i Mëshirshëm, sa që pranon dhe shpërblen shumëfish edhe veprat e mira sado të vogla të jenë ato?" A kemi mësuar nga pika e ujit që të ngrihemi sërish në këmbë edhe kur na ka vënë poshtë jeta?

Pa m'u përgjigjini! A jemi edhe ne si koprracët që, nga një anë e duan xhenetin, por nga ana tjetër nuk duan të japin asgjë që ta fitojnë atë? A jemi edhe ne si gafilët që edhe e dëshirojnë përjetësinë, edhe nuk duan të vdesin, megjithëse vdekja është fillimi i jetës së re? A jemi edhe ne si ata njerëz që rrinë duke u qarë për hallet e kësaj jete dhe nga ana tjetër janë të kapur fort pas saj?

A jemi të edukuar në jetën tonë nga pesë namazet që falim gjatë ditës? A mundëm t'i themi Zotit tonë që u përgjigjet duave tona: "Na bëj të mundur të jetojmë për të fituar pëlqimin Tënd, të shpenzojmë frymën tonë në rrugën Tënde, cilido qoftë çmimi që do të paguajmë për këtë gjë?"

A arritëm t'i konsiderojmë si miqtë tanë të hajrit ata që na pastrojnë nga thashethemet dhe gjynahet tona? A arritëm t'i pranojmë si miqtë tanë të vullnetshëm ata që nuk duronin dot problemet tona dhe qëndrimin tonë vend-numëro dhe u përpoqën aq shumë për përparimin tonë? A e kuptuam se Allahu nuk ruan atë që ia bën kurban urdhrin e Tij egos personale, por ruan personin që ia bën kurban egon personale urdhrin të Zotit?

A arritëm dot të shihemi në pasqyrë me atë që kemi dhe nuk kemi, qoftë një herë të vetme pa bërë asnjë koment dhe pa asnjë paragjykim? A arritëm që të biem në sexhde në paqe me veten dhe me kokëfortësi ndaj anarkisë së botës, që duket se nuk do t'i vijë fundi? A bëmë vallë dua për çdo njeri që e konsideronim me zemër të afërt për ne, fëmijët, miqtë dhe shokët tanë që me kalimin e kohës kuptuam se në të vërtetë rrinin shumë larg nesh dhe kjo na bëri që të na dhimbte në zemër?

A arritëm të shohim me syrin e zemrës që sheh shumë larg, më shumë sesa me sytë e ballit që të shumtën e herëve na i tregojnë gabim ato që shohim? A arritëm të derdhim lot edhe për personat që na kanë bërë keq në jetë dhe a u lutëm për mirësi edhe për ta? A kemi hequr dorë nga diskutimi i gjërave që nuk dime?

Po jemi mësuar. Jemi mësuar me çorapët, tenxheren, pjatën, karrigen, tavolinën, kompjuterin, telefonin, çantën dhe portofolin. Po, a e kemi kuptuar se ajo që na fut frikën kur mendojmë për ndarjen nga kjo jetë, në fakt është frika që ne përjetojmë nga ideja e ndarjes me ato gjëra me te cilat jemi mësuar?

A reagojmë ende me fjalët: "Nuk dua punë të vështira, nuk kam të bëj unë me hallet, as që dua të kem problem! Në qoftë se kjo punë e hajrit më prish interesat e mia, as më shkon mendja ta bëj atë!"? A vazhdojmë ta mashtrojmë veten tonë duke ngritur pesha pesë kilëshe, megjithëse mund të ngrejme pesha dyzet kilëshe? A e kemi konsideruar ftesë në mirësi, në qoftë se i kemi bërë thirrje një herë egos sonë të përmirësohet? A na është kujtuar ndonjëherë Musai, i cili e pati ftuar sa e sa herë faraonin në rrugën e drejtë? A kemi marrë hise nga pasioni i zjarritë i të Dërguarit të Allahut, i cili ia shpjegonte me këmbëngulje dhe durim të vërtetën ymetit të tij?

A e kemi sakrifikuar institucionin e "vëllazërisë fetare" për hir të dobësive tona personale? A mund të hyjë në xhenet një mysliman, i cili nuk i sheh me syrin e "motrës myslimane" gratë e tjera, përveç gruas së tij, por i sheh me vështrimin e ndotur nga qëllimet e mbrapshta? A ka besuar gruaja mendjeprishur që meshkujt e tjerë myslimanë, përveç burrit të saj, nuk i konsideron si "vëllezër të fesë"?

A kemi dalë shëndoshë e mirë në të vërtetën, duke

u distancuar nga njerëzit mjerranë dhe të pafat, për të cilët dhe të cilat xhelozia është shndërruar në një sëmundje kronike dhe pasi ia kanë shtrydhur mirë e mirë lëngun punës, nuk arrijnë të bëjnë dallimin mes dëshirës për një myrshid të përsosur dhe një mashkulli?

Vërtet! Megjithëse Merkuri është planeti që gjendet më afër diellit, në të vërtetë planeti më i ngrohtë i sistemit diellor, a nuk është Venusi? Kjo e vërtetë e ligjeve universale a nuk na shtyn që të konceptojmë më mirë fjalët: "Ai që gjendet në Jemen është afër meje", që thoshin të parët? A nuk e kemi kuptuar vërtetë se përfitimi shpirtëror nuk arrihet falë afërsisë fizike, por falë afërsisë shpirtërore?

A kemi marrë edhe ne hise nga sjellja e Umerit, i cili gëzohej me fjalët: "I lumi unë që kam miq që më rrëfejnë rrugën e drejtë", kur vëllezërit tanë të fesë përpiqen të na largojnë nga veprimet e gabuara që kryejmë, duke parandaluar me këto fjalë egon tonë që të mos mbahet me të madhe para kësaj të mire që po na bëjnë? A jemi akuzuar për mungesë respekti, ndërkohë që prisnim respekt? A e kemi quajtur "urdhrin për të mirë" egoizëm dhe e kemi shtypur pa të drejtë bashkëbiseduesin tonë?

A ia kemi bërë shqyrin, si për mbështetjen që na është dhënë, ashtu edhe për situatat që na kanë penguar? A jemi distancuar nga ofendimi dhe mërzitja, në vend që të falënderonim Allahun që na ka krijuar përmes njerëzve të tjerë situata pengimi përpara nesh, duke dashur të na mësojë në këtë mënyrë se, "po të mos ishin ato pengesa, nuk do të dilte kurrë në pah guximi ynë i vërtetë"?

A nuk është për të ardhur keq që anëtarët e ymetit të Muhamedit (a.s.), i cili i pati sfiduar myshrikët duke u mësuar atyre se vlerat nuk kanë asnjë çmim, kur u pati thënë se "edhe po t'i vinin hënën në njërën dorë dhe dieillin në dorën tjetër, ai nuk do të hiqte dorë deri në vdekje nga feja islame", janë gati të heshtin para padrejtësive për dy para që do të marrin nga ajo heshtje dhe të manifestojnë dobësinë e tyre ndaj përfitimeve personale, a thua se janë duke bërë garë me Napoleonin se kush është duke fituar më shumë?

Vërtetë, a të dëgjon ty ai që nuk e dëgjon Profetin? A u jep rëndësi këshillave të tua, personi i cili nuk i zbaton urdhrat e udhëheqësit të tij fetar? Kaq gjë e madhe është se të tjerët flasin keq për ty, kur ata ndërkohë nuk lënë pa thënë gjë për Allahun që i krijoi? A është shndërruar në parimin e jetës tënde puna vetëm për hir të Allahut, pa i kushtuar rëndësi faktit nëse flasin të tjerët apo jo? A kemi arritur të qëndrojmë drejt pa u treguar të dhunshëm dhe arrogantë dhe të jemi të drejtë sipas drejtësisë së Zotit? A jemi të bindur se suksesi vjen vetëm e vetëm prej Allahut?

Kaq pyetje besoj se mjaftojnë, megjithëse ato mund t'i shtojmë edhe më shumë. Nuk e di se kush do t'u përgjigjet atyre apo do t'i lërë pa përgjigje nga lexuesit e mi? Bëje një të mirë dhe hidhe në det, po nuk ta diti peshku, ta di Zoti vetë.

Prodhimi i Mirësisë

Idris Arpat

Kur njeriu nuk ka asnjë ideal dhe qëllim në jetë, atë e kaplon *gafleti*, që mund të përkufizohet me fjalët “të shkosh pas vijës së shumicës së njerëzve”. Pra të bëhesh si gjithë të tjerët pa kushte. Të bëhesh si gjithë të tjerët do të thotë të mos jetosh jetën tënde dhe të mos kesh asnjë rol. Të bësh përpara jo në drejtimin nga do të shpjerë ndërgjegjja, por në drejtimin që të çon turma. Të luash në tribunë dhe të mos kesh asnjë parim.

Çfarë është qëllimi dhe ideali? Të kesh ëndrra të mëdha për të realizuar. Për shembull, të synosh të shkruash romanin më prekës në botë, të bëhesh një intelektual ose shkencëtar, zëri i të cilit ka peshë në planin ndërkombëtar, të bëhesh një mufesir (komentues i Kuranit) që përpiket ta shpjegojë Kuranin në mënyrën më të saktë në përputhje me qëllimin hyjnor. Le ta themi që në krye të herës se qëllimi kryesor është pëlqimi i Allahut.

Qëllimi është i madh dhe do kohë të realizohet. Ash-tu siç është ylli në majë të malit. Edhe nëse ke vendosur të hipësh në majë të malit për ta arritur atë, ylli ka për të shndritur sërish në majën tjetër të malit. Nuk do të arrish ta kapësh atë, por në emër të tij ti do të ngrihesh lart e më lart, në majat që nuk i kanë shkelur të tjerët.

Në rininë e tij njeriu e kaplon dëshira e zjarhtë që të “shpëtojë botën”. Ndodh shpesh në jetë që në vitet në vazhdim të kuptosh se është ëndërr t’i japësh kah lagjes tënde, farefisit tënd, madje edhe familjes tënde. Vetëm se edhe në këto raste njeriu bën një luftë të vërtetë dhe të madhe në emër të rolit që dëshiron të luajë në shoqëri, duke shfrytëzuar kapacitetet e tij në të mirë të shoqërisë.

Vallë kjo është “bamireshia (ihsan)”, për të cilën flet edhe feja islame? Ky është kuptimi i deizës **“Ta adhurosh Zotin, sikur të jesh duke e parë Atë.”** Të jesh i vetëdijshëm se po kryen detyrën tënde të robërisë ndaj Zotit që sheh dhe dëgjon gjithçka.

Në qoftë se do Allahun (xh.sh.) dhe pëlqimi i Tij është qëllimi parësor për ty, nuk ka dyshim se çdo veprim dhe fjalë që do të thuash do ta kryesh që të fitosh kënaqësinë e Tij. Në qoftë se pozicioni të cilit kemi dëshirë t’ia fitojmë miratimin dhe pëlqimin me punën tonë është një pozicion i lartë, kjo do të bëjë që të rritet përpikmëria jonë ndaj punës që bëjmë. Në qoftë se puna që kryejmë është ajo që dëshirojmë të bëjmë dhe e përmbushim atë a thua se jemi duke kryer një adhurim, kjo do të thotë se punën tonë e bëjmë si artistë të vërtetë duke u shkrirë tërësisht me të. Deviza

"Allahu është i Bukur dhe e do të bukurën" do ta ngrejë në pedestal ndjeshmërinë dhe emocionin që na vlon përbrenda.

Çfarë është arti? Arti është prodhim i mirësisë. Kush quhet mysliman? Ai që shpëndan vetëm mirësi me punën e tij.

Ajetin e Kuranit **"Thuaj robërve të Mi që të flasin fjalët më të mira"** (Isra, 53) është e mundur ta kuptojmë në formën "Myslimanët duhet të jenë në krye edhe në artin e fjalës".

Një jetë e shkuar me mbarësi, larg ekstremizmit dhe e ekuilibruar është një vepër arti.

Njeriu, ose duhet të shkruajë një libër që ia vlen ta lexosh, ose duhet të jetojë një jetë që ia vlen t'a shkruash.

Nga ky botëkuptim kalon edhe rruga për të mos u harruar pasi të kesh vdekur. Të dyja janë vepra arti. Edhe libri i shkruar bukur, edhe jeta e mirë lënë pas gjurmë.

Allahu (xh.sh.), na nxit që të prodhojmë vetëm mirësi dhe bukuri duke na vendosur brenda botës të cilën e ka pajisur me mijëra e mijëra bukuri! Mos vallë dëshiron të na thotë: "Unë jam Allahu që e do të bukurën. Çdo gjë që krijohet, e krijohet të bukur. Edhe robërit e Mi të krijojnë vetëm gjëra të bukura"?

Kur e përkufizuar myslimanin si "njeriun që prodhon të bukurën", hyn në mes vetveti edhe dimensionin e krijimit. Pra myslimani duhet të prodhojë në mënyrë të vazhdueshme. Në qoftë se ai nuk prodhon ose ajo që prodhon nuk është e bukur, do të thotë se ai nuk arrin ta përmushë qëllimin e tij. Robërit e Allahut që krijojnë çdo moment janë edhe ata krijues në përmasat e tyre njerëzore.

Nuk dua të keqkuptohem. Hijeshia dhe bukuria i mbulon të gjitha hapësirat. Besimin, adhurimin, moralin, të drejtën, arkitekturën, mjedisin, letërsinë, muzikën dhe në masë të caktuar edhe pikturën. Prandaj e nënvizoj këtë fjalë me ato përmasa që përfshijnë kuptimet e fjalëve se: myslimani është personi që e zbulon jetën e tij. Kjo është robëria e mirë për të cilën ne flasim. Qëllimi kryesor i çdo veprimi është pëlqimi i Allahut. Ndjenjat e bukura dhe emocionet pozitive janë shpërblimet e para të realizimit të objektivit.

Atëherë, çfarë do të thotë humbje e idealizmit dhe **"e enigmës së mirësisë"**? Do të thotë një jetë materiale. Do të thotë vdekje e jetës së shpirtit. Do të thotë të harrosh synimin, të mbytesh tek mjeti dhe të marrësh fund.

Bota myslimane, për fat të keq, prej disa shekujsh ka humbur jo vetëm forcën e vet krijuese, zbuluese dhe emocionet e shpikjeve shkencore, por paralelisht me këto ka humbur edhe ndjenjën e estetikës. Bota e

madhe myslimane e kupton fenë e saj vetëm si përmushje të disa ritualeve dhe vetëm kaq. Ka shekuj që bashkësia e Muhamedit (a.s.), nuk i ka ofruar gjë jetës botërore. Ajo nuk arrin t'i dalë për zot nderit dhe dinjitetit të saj, është mësuar të shtrohet në dru dhe është bërë normale për të që të humbë jetë myslimanësh. Ajo i konsideron stoli zinxhirët e shtypjes dhe robërisë që i kanë hedhur përsipër. Ka mbetur në nivelin fillestar të përdorimit të intelektit dhe të prodhimit të shkencës dhe mendimit.

Përse ka ndodhur kjo vallë? Përse kemi përfunduar në një mendim fetar shterpë, megjithëse kemi mbi 6000 ajete të Kuranit dhe po aq hadithe?

Përgjigja e kësaj pyetjeje pret dijetarët dhe shkencëtarët myslimanë të kujdesshëm, hijerëndë, që mbajnë mbi çdo gjë të vërtetën dhe e nderojnë shkencën dhe diturinë.

Duhet të kryejmë punë të pandërprera. Myslimanin i kanë hije punë të rregullta, të planifikuara dhe të programuara shumë mirë. "Humbja e shpresës është vdekje", por më mirë të punosh dhe të mos kesh shpresë që nuk do t'i mbledhësh frytet, sesa të rrih pa punuar.

Çështja jonë kryesore duhet të jetë zgjidhja e problemit të mirëqenies së popullit. Ky është kushti themelor i qëndrimit në këmbë dhe i mbijetesës në këtë botë. Lufta për të qëndruar në këmbë drejt është një mundësi shumë e madhe, që nuk e kanë të gjithë njerëzit dhe popujt. Kjo nuk është e gjitha. Mes qëllimeve të kësaj jete është të jetosh për të mirën e shoqërisë, të hapësh rrugën për horizonte të reja, të ndikosh në formimin e një atmosfere më të pastër dhe më të moralshme. Këto synime presin njerëz me horizont të gjerë, me botë të pasur ideore dhe me sytë e zemrën të kthyer nga Arshi i Lartë. Në përfundim, këta persona vdesin dhe ia lënë begatinë e punës së tyre kësaj bote të vdekshme dhe njerëzve të vdekshëm që ajo mban brenda saj.

Kësaj jete duhet t'i caktohet një qëllim i vetëm: pëlqimi i Allahut. Fitimi i këtij pëlqimi ua hap rrugën edhe shumë mirësive të tjera.

Nënçmimi njerëzor që e ka emrin dukje sa për sy e faqe dhe sa për t'u dukur i mirë në sytë e njerëzve, nuk përputhet me tevhidin.

Njeriu nuk është dhe nuk duhet të pranojë të bëhet robi i njerëzve të tjerë.

Dëshira për realizimin e diçkaje e mban të gjallë njeriun. Emocioni dhe gjallëria e personit pa ideale vjen e fiket, prandaj besimtari duhet t'i mbajë gjallë dëshirat dhe kërkesat në shpirtin e tij, sepse mungesa e tyre e shndërron në një besimtar të ngrirë. Kjo për myslimanin do të thotë vdekje.

MREKULLITË E Kuranit

QETËSIMI I ZEMRËS ME PËRMENDJEN E ZOTIT

Studime islame dhe amerikane vërtetuan se mendimi rreth Zotit xh.sh. i lehtëson brengat. Po studiuesit gjetën se njeriu që beson në Zot dhe ka bindjen se Allahu xh.sh. mund ta shërojë atë, ka probabilitet më të lartë shërimi krahasuar me ateistin që nuk beson në ekzistencën e Zotit. Studimi sqaron se sinjalet e lëshuara prej trurit ndryshojnë kur njeriu mendon për Zotin xh.sh.. Për këtë arsye, mjekët këshillojnë për domosdoshmërinë e përmendjes (dhikër) së Allahut xh.sh. gjatë sëmundjes dhe për lutje, sepse kjo bën që të sëmurët të jenë më të fortë, e rrjedhimisht e ndihmojnë procesin e kurimit, sidomos në sëmundjet kronike. Po ashtu, studiuesit vunë re se përmendja e Allahut xh.sh. barazpeshon sekretimin e hormoneve, rregullon funksionimin e zemrës dhe e bën atë më të qëndrueshme. Larg të metave është Allahu xh.sh. që na ka urdhëruar për këtë dhe e ka bërë përkujtimin e Tij qetësi dhe rehati për zemrën. Ai xh.sh. thotë: **“Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun zemrat e tyre qetësohen; pra ta dini se me të përmendur Allahun, zemrat stabilizohen.”** (Rad, 28)

ANTIMATERIA

Në një eksperiment të bërë së fundmi, shkencëtarët monitoruan që çdo materie apo substancë në ekosistem, ka anën e saj të kundërt dhe kur takohen së bashku këto të dyja, pra materia dhe antimateria, ato shkatërrohen duke çliruar kështu energji të madhe. Ky eksperiment thekson gjithashtu se universi është i projektuar mbi parimin dypalësh. Larg të metave është Allahu xh.sh. që na e rrëfeu këtë fakt që para katërmbëdhjetë shekujsh kur tha: **“Dhe nga çdo gjë Ne kemi krijuar dy palë¹, në mënyrë që ju të vini veshin!”** (Dhariat, 49)

1. Siç është p.sh. drita dhe errësira, subjekti dhe objekti, e thata dhe e njoma, aktivja dhe pasivja, mashkulli dhe femra, e gjalla dhe e pajeta. Gjithashtu, ky varg mund të aludojë fare mirë edhe për vlerën universale të ligjit të gjinive.

*"Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të
(me Kuranin - namazin), është e sigurt se Zoti yt
do të të ngre në një vend të lavdishëm."*

(Isra, 79)

Një Ajet

Në ajetin e mësipërm, Pejgamberit i kërkohet të zgjohet nga gjumi në një pjesë të natës dhe të falë namaz.

Ky lloj namazi është quajtur namazi i Tehexhudit nisur nga kuptimi i kësaj fjale në gjuhën arabe.

Pejgamberi (a.s.) u ka tërhequr vëmendjen sahabeve, të cilët rrinin tërë natën zgjuar për të falur namaz, duke u thënë se është një lodhje e madhe për trupin, prandaj nuk e ka parë të arsyeshme të merren tërë natën me adhurime.

Nga sa kuptohet nga ajeti në fjalë, namazi i Tehexhudit është një adhurim që i përket vetëm të Dërguarit të Allahut. Ka nga dijetarët që mendojnë se ky adhurim është mendup dhe nafle, pra një virtyt më shumë për të Dërguarin e Allahut.

Arsyeja e një mendimi të tillë është se Pejgamberit (a.s.) i janë falur të gjitha gjynahet. Natyrisht që një gjë e

tillë nuk bëhet fjalë për bashkësinë e tij. Namazi i natës është një falje e gjynaheve të tyre.

Të tjerë dijetarë kanë theksuar se namazi i natës i quajtur Tehexhud është një farz më shumë për Pejgamberin (a.s.) i shtuar mbi pesë kohët e ditës dhe ky farz i posaçëm është për të përfocuar edhe më shumë prioritetin e tij mbi bashkësinë Islame.

Nisur nga vijimi i ajetit **"është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm"**, vendi i lavdishëm është vendi ku bëhen falënderimet dhe mirësitë. Ky post i lartë i përket Pejgamberit (a.s.).

Në Ditën e Gjykimit çdo bashkësi, apo e thënë ndryshe i gjithë njerëzimi do kërkojë të shpëtojë sa më shpejt nga ajo pritje e frikshme nëpërmjet ndërmjetësisimit të Profetit dhe me të shpëtuar nga kjo pritje do ta falënderojë. Makami Mahmud mund të quhet ndryshe edhe makami shefaat.

Transmetohet nga Aishja (r.a.),
se Pejgamberi -(a.s.)-, ngrihej natën dhe falte namaz
deri në enjtjen e këmbëve. Nisur nga kjo e pyeta:

"O i Dërguari i Allahut! Pse e mundon veten kaq shumë ndërkohë që Ty
të janë falur të gjitha gjynahet?"

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

"Pse të mos jem një rob falënderues?"

(Buhari, Muslim)

SHPJEGIME

Pejgamberi (a.s.) ngrihej natën dhe
adhuronte Allahun deri sa këmbët i
enjtëshin ndërkohë që Aishja shqetë-
sohej shumë për këtë. Ajo mendonte
se Ai bënte adhurim me frikën e gjy-
naheve apo me dëshirën që të falej.
Prandaj ia kujtoi edhe shprehjen që
zë vend në hadith "Allahu t'i ka fa-
lur të gjitha gjynahet". Prandaj ajo e
pyet se përderisa Allahu të ka falur
të gjitha gjynahet që ke bërë dhe ato
që do bësh përse e mundon veten kaq
shumë? Natyrisht i Dërguari i Allahut
s'mund të rrinte në heshtje. Ai iu për-

gjigj se po bënte vetëm detyrën e një
robi për ta falënderuar me sa kishte
mundësi Allahun për mirësinë e ma-
dhe të faljes.

Sipas Aishes, i Dërguari i Allahut për
një kohë të gjatë ka qëndruar me orë
të tëra në këmbë duke bërë adhurim
dhe këtë e shijonte me një kënaqësi
tepër të madhe, por me të shtuar në
peshë nisi të falte namaz i ulur. Rin-
te një kohë të gjatë ulur dhe lutej, kur
donte të binte në sexhde ngrihej në
këmbë, pas një farë kohe ulej në ruku
dhe në sexhde sërish.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. I Dërguari i Allahut, natën bënte shumë adhurim
për ta falënderonte Zotin.
2. Falënderimi për mirësinë është një detyrë njerëzore.
3. Ka shumë rrugë për ta falënderuar Allahun
për mirësitë e dhëna. Kjo mund të shprehet edhe me gjuhë
ashtu sikurse mund të bëhet edhe me adhurim natën
siç vepronte vetë Pejgamberi (a.s.).
4. Nëpërmjet kësaj, Pejgamberi (a.s.)
tregonte se kjo është mënyra më e mirë për të shprehur
robërinë ndaj Allahut.

Një Hadith



FALËNDERIMI

Çdo njeri me ndërgjegje dhe logjikë ia ka për borxh një falënderim edhe atij që i jep qoftë edhe një gotë ujë. Dhe kur i jepet rasti, ia kthen atë mirësi me të njëjtën gjë. Nisur nga kjo, mund të themi se qëndrimi i njeriut në mënyrë të ftohtë e të vrenjtur përballë të gjitha mirësive që i ka falur Allahu i Madhëruar, nuk është aspak i logjikshëm.

Të mos harrojmë se të gjithë ne po mbushim kasetën e jetës, e cila do të hapet për t'u shikuar në Ditën e Gjykimit. Dhe, kur të vdesim, do të varrosemi me veprat tona. Ndërsa në ditën e llogarisë hyjnore, sytë, veshët, lëkura dhe të gjitha organet tona do të fillojnë të flasin, duke shpalosur çdo gjë që kemi bërë në jetën e kësaj bote.

Ibrahim bin Ethem dhe **Shakik-i Belhi** ishin dy miq të ngushtë për hir të Allahut. Në një prej bisedave të tyre zhvillohet një dialog shumë mësimdhënës:

Shakik-i Belhi e pyet Ibrahim bin Ethem:

"Si e siguron jetesën?"

Ibrahim bin Ethem përgjigjet:

"Kur gjejmë falënderojmë, kur nuk gjejmë durojmë!.."

Shakik-i Belhi thotë:

"Kështu bëjnë edhe qentë e Horasanit!" Pas këtyre fjalëve, Ibrahim bin Ethem i pyet:

"Po ju çfarë bëni?"

Shakik-i Belhi përgjigjet:

"Kur gjejmë, falënderojmë dhe dhurojmë. Kur nuk gjejmë bëjmë durim duke falënderuar."

Të dashurit e Allahut, duke qenë të vetëdijshëm se sado që të falënderojnë për mirësitë e panumërta të Allahut, asnjëherë nuk është e mjaftueshme, gjithmonë janë përpjekur t'i shtojnë sa më shumë falënderimet. Gjithashtu, falënderim; do të thotë që robi të jetë i devotshëm ndaj Zotit të tij që i ka falur mirësi të panumërta, si në fjalë ashtu edhe në vepra. Pra, të jetojë me pasionin e adhurimit.

FALËNDERIMI PËR VETËDIJEN E FALËNDERIMIT

Sado që të falënderojmë për mirësitë e pafundme të Allahut të Madhëruar, përsëri ne nuk mund ta pagujmë dot borxhin e falënderimit. Një nga të dashurit e Allahut, **Mehmed Emin Efendi**, në një letër drejtuar një prej nxënësve të vet, ndër të tjera shpreh:

"...Në një frymë, ka dy mirësi (njëra është mundësia për të marrë frymë dhe tjetra mundësia për ta dhënë). Për këtë arsye, për çdo frymë duhen dy falënderime. Çdo orë bëhen një mijë frymëmarrje dhe, shumëzuar për dy falënderime, në njëzet e katër orë, duhen bërë dyzet e tetë mijë falënderime. Nëse njeriu i lë të gjitha punët dhe mundohet vazhdimisht të falënderojë Allahun, duke thënë "faleminderit, faleminderit...", ai përsëri nuk mund t'ia japë hakun falënderimit. Madje, ai nuk mund të plotësojë asnjë në një mijë prej falënderimit ndaj Allahut."

Sipas një transmetimi, Musai (a.s.), i drejtohet Allahut duke i thënë:



“O Zot! Falënderimi im ndaj Teje është një mirësi më vete që më ke dhënë. Por edhe kjo kërkon falënderim të veçantë. (Atëherë, si mund të të falënderoj ashtu siç e meriton?)”

Allahu i Madhëruar i shpall Musait (a.s.), këto fjalë:

“Kur ti e pranon se çdo mirësi është prej Meje, atëherë edhe Unë këtë pranim do ta konsideroj si falënderim.” (Ihja, IV, 163.)

Përveç pranimi se të gjitha mirësitë janë prej Allahut, të tregosh edhe delikatesën e falënderimit të atyre që u bënë shkak që ato mirësi të vijnë tek ne, është një kusht i rëndësishëm i falënderimit të Allahut. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Kush nuk i falënderon njerëzit, nuk e ka falënderuar as Allahun.” (Ebu Daud, Edeb, 11/4811; Tirmidhi, Birr, 31.)

Falënderimi është pasqyra e njerëzimit. Falënderimi ndaj njerëzve, aq sa është një çështje edukate dhe morali, është edhe një çështje trajnimi të kalimit nga metaforikja, tek e vërteta. Kjo, sepse falënderimi i njerëzve me kusht që të mos harrohet Krijuesi, në fund të fundit përsëri është një kthim tek Allahu.

Një robi shumë falënderues nuk i mjafton të njohë vetëm dobinë e mirësive. Falënderim është të njohësh pronarin e vërtetë të mirësive dhe ta adhurosh Atë. Pra, mirësitë duhet të ta zgjerojnë horizontin e meditimit dhe të të çojnë drejt Allahut. Për rrjedhojë, edhe zemrat, edhe dashuria orientohet drejt njohjes së Allahut.

Nëse ne e harrojmë personin që na ka dërguar një dhuratë të çmuar dhe mjaftohemi vetëm me falënde-

rimin e personit që na e sjell atë, kjo është shumë e çuditshme dhe e gabuar. Në të njëjtën mënyrë, nëse ne e harrojmë Furnizuesin e vërtetë të mirësive që kemi, duke u përqendruar vetëm tek shkaqet që i kanë sjellë ato mirësi, apo tek vetë mirësia, kjo tregon një mosmirënjohje shumë të madhe. Për njeriun nuk mund të imagjinohet turp dhe humbje më e madhe se sa të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive, pra të harrojë Allahun.

PJESËT E FALËNDERIMIT

Një falënderim i pranuar, nuk është një falënderim i shprehur vetëm me fjalë. Një falënderim i vërtetë përbëhet nga tre elementë të lidhur me njëri-tjetrin. Këto janë; **dija**, **gjendja** (ndjenja) dhe **vepra**.

- **Dija**; të jesh i vetëdijshëm se të gjitha mirësitë vijnë prej Allahut.

- **Gjendja** (ndjenja); të ndjesh respekt, dashuri dhe mirënjohje ndaj pronarit të vërtetë të mirësive.

- **Vepra**; të jetosh në përputhje me këto ndjenja, duke e shprehur falënderimin me fjalë dhe me vepra. Gjithashtu, edhe mirësitë duhet t'i përdorësh në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe të

ruhesh nga mosbindja ndaj Tij.

Kur i nderuari **Xhunejd Bagdadi** ishte shtatë vjeç, daja i tij, **Serijj-i Sakati**, e merr me vete në haxh. Në një prej bisedave që u zhvillua në Qabe, u fol për falënderimin. Pasi të gjithë të diturit shprehën mendimin e tyre, Serijj-i Sakati, u kthye nga Xhunejdi i vogël dhe i kërkoi që edhe ai të fliste. Xhunejdi, pasi u mendua pak, u shpreh në këtë mënyrë:

“O Zot!
Falënderimi im
ndaj Teje është një mirësi
më vete që më ke dhënë.
Por edhe kjo kërkon
falënderim të veçantë.
(Atëherë, si mund
të të falënderoj ashtu siç
e meriton?)”

"Falënderim është të mos tregohesh i pabindur me atë mirësi që të ka falur Allahu dhe të mos e përdorësh atë mirësi vetëm për këtë botë."

Pra, edhe përdorimi i mirësive që të ka dhuruar Allahu në përputhje me kënaqësinë e Tij, është një nga elementet plotësuese të falënderimit. Pra, edhe falënderimi i gjuhës është i nevojshëm, por nuk është i pranueshëm. Falënderimi duhet të provohet me vepra të mira dhe largim nga gjynahet.

Përveç kësaj, është edhe falënderimi për çdo organ të trupit që na ka falur Allahu. Dhe kjo bëhet duke i përdorur në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe duke i ruajtur nga haramet dhe të dyshuarat.

Lidhur me këtë çështje, **Bishr-i Hafî**, shprehet:

"Falënderimi i atij që falënderon vetëm me organin e gjuhës është i paktë, sepse falënderimi i syrit është që, kur të shohë diçka të mirë ta marrë, e kur të shohë një të keqe, të mbyllet. Falënderimi i veshit është që, kur të dëgjojë një të mirë, ta mësojë përmendsh e kur ta dëgjojë një të keqe, ta harrojë atë. Falënderimi i duarve është që me to të mos kapë asgjë që nuk është e drejta e tyre. Falënderimi i stomakut është të ushqehet me hallall. Falënderimi i mendjes dhe i zemrës është të jenë të mbushura me dije dhe urtësi. Ndërsa falënderimi i këmbëve, është të mos shkojnë askund tjetër përveçse në të mirë. Kush vepron kështu, bëhet me të vërtetë prej falënderuesve."

Të mos harrojmë se, të gjithë ne po mbushim një kasetë jete, e cila do të hapet e do të shihet në ditën e gjykimit. Në ditën e llogarisë hyjnore, sytë, veshët, lëkura dhe të gjitha organet tona do të fillojnë të flasin, duke shpalosur çdo gjë që kemi bërë në jetën e kësaj bote. Këtë e vërteton edhe Kurani Fisnik, kur shprehet:

"Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë." (Fussilet, 20)

Atëherë, duhet menduar se sa shfaqje të fuqisë hyjnore kemi parë me sytë tanë dhe kemi falënderuar; dhe sa pamje të shëmtuara kemi parë e jemi bërë gjy-

nahqarë! Sa e kemi dëgjuar me veshët tanë shpalljen hyjnore, sunetin, zërin e së drejtës dhe të së mirës; dhe sa gjëra të padobishme kemi dëgjuar, duke e çuar dëm këtë mirësi! Ku e kemi shpenzuar energjinë e trupit tonë! A ua kemi kushtuar atë mirësive brenda kufijve hyjnorë apo mos ndoshta jemi zhytur në haramet dhe punë të këqija? Ja pra, nuk duhet harruar kurrë se nëse, në ekranin hyjnor do të shohim skenarin e jetës sonë.

GJYSMA E FESË...

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

"Besimi ndahet në dy pjesë. Gjysma është tek durimi e gjysma tjetër tek falënderimi!" (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, fq. 127.)

Durim do të thotë të mos e prishësh ekulibrin përballë kushteve të ndryshueshme të jetës, të jesh i qëndrueshëm ndaj fatkeqësive që të bien, pa u ankuar dhe ta detyrosh veten (egon) të kryejë detyrat e devotshmërisë dhe të ruhet nga haramet.

Ndërsa **falënderim** do të thotë t'i drejtohesh Allahut me të gjitha shfaqjet e devotshmërisë, të cilat janë shprehje e mirënjohjes ndaj Tij, për mirësitë e panumërta që ka dhuruar.

Abudallah Ensari, rëndësinë e falënderimit në Islam, e ka shprehur me këto fjalë:

"Falënderim; është emri i njohjes së mirësisë, sepse falënderimi të çon në njohjen e dhënësit të mirësisë. Për rrjedhojë, në Kuranin Fisnik, Islamit dhe besimit, i është dhënë emri "shukr/falënderim".

Të njohësh Allahun si pronarin e vërtetë të mirësive, do të thotë falënderim. Ndërsa e kundërta e kësaj, është mohimi. Pra, të mohosh që të gjitha mirësitë vijnë prej Allahut. Pra, e kundërta e falënderimit të mirësisë është mohimi i saj, gjë e cila është shkak i humbjes së përjetshme.

Për rrjedhojë, në ajetet ku zhvillohet biseda midis Allahut dhe Iblisit, shihet qartë se sa i rëndësishëm është falënderimi në fenë tonë të lartë:

Kur Iblisi nuk iu bind urdhrat të Allahut dhe u dëbua nga prezenca hyjnore, kërkoi që Allahu t'i jepte afat. Dhe atij iu dha afat deri në Ditën e Kiametit -si një



1. - Feriduddin, Attar, Tezkiretu'l-Evliya, fq. 452, Ilim ve Kultur Yayınları, Bursa 1984.

urtësi e sprovës që do të kalojë njeriu në këtë botë. Atëherë, Iblisi, i tha kështu Allahut të Madhëruar:

“...Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë!” (Araf, 16)

Disa prej komentuesve të Kuranit janë shprehur se kuptimi i shprehjes; **“në rrugën Tënde të drejtë”**, është **“rruga e falënderimit”**. Kjo, sepse siç kuptohet edhe nga ajeti vijues, në sajë të devijimit dhe tundimeve që do të bëjë, shejtani shprehet:

“...Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk do të jenë mirënjohës!” (Araf, 17)²

Caku përfundimtar ku shejtani dëshiron ta tërheqë njeriun, është mosbesimi, pra mohimi. Nga kjo, kuptohet se, të jesh vazhdimisht në falënderim të Allahut, të pranosh se të gjitha mirësitë janë dhuratë e Tij dhe të njohësh dobitë e atyre mirësive që ka falur Ai, duke i përdorur në rrugën e drejtë për të kënaqur Allahun, është një shfaqje devotshmërie, e cila e trondit shumë shejtanin.

Falënderimi nuk ka ndonjë kufi të caktuar. Profetët dhe të urtët, që janë edhe të dashurit e Allahut, kanë treguar devotshmëri të pashoqe. Por megjithatë, ata gjithmonë kanë qenë të shqetësuar, se mos nuk kanë falënderuar ashtu siç i takon madhësisë së Allahut.

Për rrjedhojë, Profeti ynë (a.s.), falte namaz nate derisa i enjteshin këmbët dhe për shkak të të qarës, i lageshin rrobat dhe vendi ku bënte sexhde. Kur iu tha:

“O Resulullah! Përse e lodhni veten kaq shumë, ndërkohë që ju janë falur të gjitha gabimet e të shkuarës dhe të ardhmes?” Ai u përgjigj:

“A të mos bëhem një rob që e falënderon shumë Allahun?...”³

NA BËJ PREJ TË PAKTËVE!..

Njëherë, **Omeri** (r.a.), takoi një besimtar, i cili lutej vazhdimisht:

“O Allah! Më bëj prej të paktëve!”

Omeri (r.a.), nuk arriti ta kuptonte se çfarë donte të thoshte ai person me këtë lutje. Prandaj e pyeti:

“Përse lutesh kështu?” Besimtari iu përgjigj:

“Allahu i Madhëruar, urdhëron: **“...Pak nga robërit e Mi, janë falënderues!”**⁴ Për këtë arsye, edhe unë dëshiroj të bëhem prej asaj pakice fatlume.”

Omeri (r.a.), i cili u mahnit prej këtij mendimi të bukur, tha me keqardhje:

“Turp për mua. Të gjithë janë më të zgjuar dhe më ditur se Omeri!” (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 81.)

Ky është ai Omer (r.a.), në kohën e udhëheqjes së të cilit janë çliruar shumë vende, janë futur në Bejtu’l Mal⁵ thesaret e Bizantit dhe Persisë dhe kur mirëqenia e popullit është ngritur si asnjëherë deri atëherë. Mirëpo, ky Omer (r.a.), ashtu siç ka qenë e detyruar edhe më parë, mjaftohej me një pagë shumë të vogël dhe mbante hutbe me rroba të arnuara.

Madje, të afërmit e tij, të cilët nuk mund ta duronin këtë gjendje të tij, me anë të vajzës së tij Hafsës (r.anha), i shprehën dëshirën që ai ta shtonte disi sasinë e mundësive dhe të jetonte pak më rehat. Mirëpo ai u përgjigj:

“Dy miqtë (Profeti -a.s.- dhe Ebu Bekri -r.a.-) dhe unë, ngajmë me tre udhëtarë që bëjnë të njëjtën rrugë. I pari prej nesh arriti në vendin e tij.

Po ashtu edhe i dyti prej nesh shkoi nga e njëjta udhë dhe u takua me të parin. Si i treti që jam, edhe unë dëshiroj të takohem me shokët e mi. Nëse shkoj me shumë ngarkesë, nuk mund t’i arrij ata! Apo mos nuk dëshironi që unë të jem i treti në këtë udhë?”⁶

Po ashtu, edhe një prej sahabëve të pasur, **Abdurrahman bin Auf** (r.a.), i cili e falënderonte shumë Allahun, një ditë kur ishte agjërueshëm, iu vunë përpara disa lloje ushqimesh, që të hapte iftarin. Mirëpo, ky sahabi i bekuar, u ngrit nga sofa me lot në sy dhe tha:

“Mus’ab bin Umejri ra shehid (dëshmor) në Uhud. Ai ishte më i mirë se unë. Mirëpo edhe për qefin nuk kish te gjë tjetër përveç një trikoje. Por edhe me të, nëse i mbuloje kokën, i ngeleshin këmbët jashtë. E, nëse



2. - shih. Ihja, IV, 153.

3. - shih. Ibn-i Hibban, II, 386.

4. - Sebe, 13.

5. - Bejtu’l-Mal: Thesari i shtetit

6. - Shih. Ahmed, Zuhd, fq. 125. Shebenderzade Ahmed Hilmi, Tarih-i Islam, I, 376.

i mbuloje këmbët, i ngelej koka jashtë. Ndërsa tani, neve na është dhënë çdo gjë si pasuri e kësaj bote. Në të vërtetë, kam frikë se shpërblimi i mirësive tona na është dhënë në këtë botë. (Vallë, a mos na pakësohet shpërblimi i mirësive në botën tjetër?)” (Buhari, Xhe-naiz, 27.)

Siç shihet, nga frika se mos nuk e plotësonin dot detyrën e falënderimit, ata edhe mirësitë që i kishin hallall i përdornin me kujdes. Po ashtu, ata e konside-ronin të mjaftueshme edhe sasinë më të vogël të një mirësie, me qëllim që ta jepnin më lehtë llogarinë e saj para Allahut.

Ndërsa ata që janë të privuar nga këto ndjenja, në përgjithësi janë të pavëmendshëm ndaj këtyre mirë-sive të Allahut. Pa u menduar fare se a do të mund ta kryejnë siç duhet falënderimin, ata vazhdojnë të kër-kojnë me lakmi të gjitha mirësitë e kësaj bote. Dhe për këtë arsye, robërit që janë me të vërtetë falënderues, janë shumë të paktë.

MORALI HYJNOR

Çdo njeri me ndërgjegje dhe logjikë ia ka për borxh një falënderim edhe atij që i jep qoftë edhe një gotë ujë. Dhe kur i jepet rasti, ia kthen atë mirësi me të njëjtën gjë. Nisur nga kjo, mund të themi se qëndrimi i njeriut në mënyrë të ftohtë e të vrenjtur përballë të gjitha mirësi që i ka falur Allahu i Madhëruar, nuk është aspak i logjikshëm.

Nga ana tjetër, për njeriun, kapitali i të cilit është “asgjëja”, është e pamundur t’ia kthejë Allahut me të njëjtën të mirë që Ai i ka falur. Megjithatë, Allahu i Madhëruar, në sajë të mirësisë dhe mëshirës së Tij të pafundme, na shpërblen për çdo punë të mirë -sipas qëllimit dhe sinqeritetit-nga dhjetë deri në shtatëqind fish. Kjo është si domosdoshmëri e Cilësisë së Tij “esh-Shekur”⁷. Në ajetet fisnike, urdhërohet:

“...Allahu është Mirënjohës dhe nuk nxiton në dë-nime!” (Tegabun, 17)

“...Padyshim Allahu është Falënderues dhe i Gji-thëdijshëm.” (Bekare, 158)

Allahu i Madhëruar i pranon veprat e mira të robërve të Tij, falënderimet, durimin, mirënjohjen, sinqeritetin dhe jetën që bëjnë me devotshmëri dhe, duke ua shpër-blyer me shumëfish, shfaq emrin/cilësinë e Tij, “esh-Shekur”. Ja pra, tregimi i mirënjohjes dhe falënderimit për të përfutur prej këtij morali hyjnor, është një ho-rizont shpirtëror i veçantë për besimtarët e përsosur.

7. - esh-Shekur: Mirënjohës. Pra është Ai që të falënderon për atë të mirë që veprime dhe për këtë të shpërblen shumëfish në këtë botë dhe në botën tjetër.

Në ajetin kuranor, lidhur me **Nuhun** (a.s.), urdhëro-het:

“...Ai ka qenë vërtet një rob mirënjohës!” (Isra, 3)

Nuhu (a.s.), e falënderonte gjithmonë Allahun në çdo veprim që bënte, që prej ngrënies e pirjes e deri tek veshja. Kur vishej, hante apo pinte, thoshte **“bismi-lah”**; kur mbaronte së ngrëni apo kur zhvishej, thoshte **“elhamdulillah”**. Për këtë arsye, Allahu e quajti atë, pra, “rob mirënjohës e falënderues”. Dhe për të nxitur falënderimin edhe tek njerëzit e tjerë, e bëri këtë ve-për të tij shembull për gjithë njerëzimin.⁸

FALËNDERIM NË ÇDO SITUATË..

Arritja e kënaqësisë së Allahut kërkon ta falënde-rosh Atë, jo vetëm në kamje, por edhe në skamje. Pra, falënderimi është një virtut i palëkundshëm i zemrës së besimtarit, edhe nëse ndryshojnë kushtet e jetës.

Lidhur me këtë çështje, gjendja e **Ejjubit** (a.s.), është një shembull shumë mësimdhënës:

Gruaja e tij Rahime, një ditë i thotë Ejjubit (a.s.):

“Ti je profet! Sikur t’i kërkoje Allahut shërim e t’i hiq-te këto vuajtje!”

Pasi dëgjoi këto fjalë, Ejjubi (a.s.), i drejtohet së sho-qes dhe i thotë:

“O Rahime! Zoti im më ka dhënë tetëdhjetë vite shë-ndet. Ndërsa koha e sëmundjes sime, nuk është bërë ende tetëdhjetë vite. Vetëm disa vite kam që vuaj. Prandaj, kam turp t’i kërkoj Allahut shëndet.”

Ejjubi (a.s.), nga turpi që ndjente për shkak se nuk e kishte plotësuar falënderimin për pjesën e jetës që kishte kaluar në shëndet, ngurronte të kërkonte shërim prej Zotit. Dhe si shpërblim i falënderimit dhe durimit të tij, Allahu i Madhëruar, i Cili është **“esh-Shekur”**, pra, i Cili shpërblen me shumëfish më tepër, i fali Ejjubit (a.s.), edhe më shumë shëndet, begati dhe rehati se ç’kishte më parë.

Sa bukur e shpreh edhe ky shembull falënderimin që tregonin njerëzit e devotshëm:

Gruan e devotshme, **Rabian** -Allahu qoftë i kënaqur prej saj-, e pyetën:

“Kur kënaqet Allahu nga rob i Tij?” Ajo u përgjigj:

“Kur rob i falënderon sikur është në mirësi, edhe kur gjendet në vuajtje dhe vështirësi...”

Besimtarët e devotshëm e dinë mirë se falënderimi nuk është një adhurim që bëhet vetëm në kohë të re-hatisë. Sado fatkeqësi të mëdha t’u bien, tek ata falë-nderimi ndaj Allahut është bërë pjesë e karakterit. Për këtë arsye, në vend që të ankohen prej vështirësive me

8. - shih. Ibn-i Hanbel, ez-Zuhd, fq. 50.

të cilat përballen si domosdoshmëri e sprovave hyjnore, ata shfaqin virtytin e falënderimit ndaj Allahut, i Cili i ka ruajtur nga fatkeqësi edhe më të mëdha se ato.

MIRËSIA E VËRTETË...

Në Kuran, urdhërohet:

"Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t'ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke Mu bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!" (Bekare, 152)

"...Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia; por, nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë!" (Ibrahim, 17)

Falënderimi, është shkak i begatimit të mirësive. Ndërsa mosfalënderimi, është mohim i mirësisë, mosmirënjohje dhe shkak i humbjes së begatisë e mirësisë. Po ashtu, mosfalënderimi shkakton edhe zemërimin e Allahut. Lidhur me këtë çështje, Fudajl bin Ijaz -rahmetullahi alejh-, ka thënë:

"Vazhdoni të falënderoni, sepse mirësia që të ikën njëherë prej duarsh, rrallë mund të kthehet përsëri." (Ihja, IV, 232.)

Ndërsa gjendja e të dashuruarve pas Allahut në çështjen e falënderimit, nuk ka të bëjë fare me shtimin apo pakësimin e mirësive. Për ta, e rëndësishme është të shtojnë afërsinë me Allahun, duke falënderuar për ato mirësi.

Lidhur me këtë fakt, Mevlana i nderuar, shprehet:

"Të falënderosh për mirësinë, është më e kënaqshme se vetë mirësia. Ai që e dashuron falënderimin, a mund ta lërë atë dhe të anojë nga mirësia?.. Në derën e mikut tënd të çon vetëm falënderimi. Mirësia, përveçse të zgjon, mund të të vërë edhe në gjumë. Ndërsa falënderimi të mban gjithmonë të zgjuar. Mblidhe mendjen dhe me anë të mirësisë së falënderimit, gjuaj mirësinë e vërtetë!"

PËRMBLEDHJE

Edhe sikur të gjithë njerëzit të na i falin pasuritë e tyre, në fund të fundit, këto janë përfitime që mund të

përdoren vetëm brenda afatit të jetës. Vdekja do të na i marrë të gjitha dhe pasuria e kësaj bote do të ngelet po në këtë botë. Ndërsa mirësia e besimit që na ka falur Allahu, do të na çojë në një lumturi të pafundme. Për këtë arsye, detyra jonë më e rëndësishme është të mund ta falënderojmë dhe t'i jemi mirënjohës Allahut për mirësinë e besimit që na ka falur. Ndërsa çështja jonë më e rëndësishme, është të mund të arrijmë në prezencën hyjnore duke u përpjekur të falënderojmë vazhdimisht dhe me një zemër të pastër.

Duhet të mendojmë vazhdimisht se kemi ardhur në jetë si njerëz, si besimtarë dhe si populli (umeti) i Muhamedit (a.s.) dhe i Kuranit, vetëm si mirësi e Allahu dhe pa paguar asgjë. Të gjitha këto janë mirësi për të cilat ne jemi të dobët të falënderojmë siç duhet. Në shumicën e mirësive materiale kemi shumë të përbashkëta me kafshët dhe dallimi nga ato është shumë i vogël. Mirësitë e vërteta, të cilat na ndajnë nga kafshët dhe na ngrenë në superioritetin njerëzor, janë pikërisht këto mirësi shpirtërore. Mirëpo, sa jemi duke falënderuar për këto mirësi? Sa gëzohemi ne me një mirësi të kësaj bote! Por, sa mirënjohës dhe falënderues jemi për mirësinë e besimit dhe përkatësisë sonë si umeti i Muhamedit (a.s.), të cilat do të na çojnë drejt lumturisë së pafundme?

I nderuari **Mevlana**, thotë:

"Kur arrin mirësitë dhe begatitë e Allahu, falënderoje Atë; edhe personin prej të cilit sheh mirësi, falënderoje dhe kujtoje! Ja pra, pikërisht për këtë arsye Allahu i Madhëruar, ka urdhëruar: "Dërgoni salavatë për Profetin!", sepse Muhamedi (a.s.), është një qenie e veçantë dhe e pashoqe, të cilin e marrin shembull të gjithë besimtarët!"

O Zot! Na e bëj të mundur të falënderojmë gjithmonë për mirësinë e nderit që na ke dhënë duke na bërë umetin e të dashurit tonë Muhamedit (a.s.)! Shtoji mirësitë e Tua ndaj nesh dhe falënderimin tonë ndaj Teje! Na ngrit në pozitën e njerëzve që janë falënderues të vërtetë, duke i frymëzuar zemrat tona me mirësinë e falënderimit!

Amin!..



TË ARRISH TË FALËSH

Xhelaledin Ozbek



Të falësh do të thotë të mos kthesh me të njëjtën monedhë veprimet e gabuara që bëhen në adresën tonë. Edhe në rastet kur këto veprime kryhen me qëllim kundra nesh, duhet t'i lëmë kohë vepruesve që të kuptojnë se janë duke bërë gabim.

Ta kthesh të keqen me të njëjtën monedhë mund të bëjë që të zmadhohet edhe më shumë konflikti.

Ndërkohë në rast se reagojmë me durim ndaj një veprimi të gabuar teksa pala tjetër pret që të reagojmë ashpër, mund të bëjë që pala që ka vepruar padrejtësisht të kuptoj gabimin që ka bërë dhe të pendohet rreth saj.

Në rast se ruajmë qetësinë ndaj veprimit të gabuar që kryhet ndaj nesh dhe vazhdojmë të ruajmë marrëdhënie të sinqerta me personin që ka gabuar, nuk ka dyshim se shumë shpejt ai do të pendohet për atë që ka bërë. Në mënyrë që ta

ruajmë me të vërtetë sinqeritetin tonë nuk duhet të harrojmë se mund të kemi qenë ne shkaku që ai të reagoonte në mënyrën e gabuar. Mund të mos i kemi konceptuar drejt ndjenjat dhe mendimet e tij dhe t'i kemi folur me fjalë që mund ta kenë nxehur. Në përgjithësi asnjë njeri normal nuk dëshiron të bëhet i keq me të tjerët. Megjithatë ne nuk duhet të mërzitemi për shkak të gabimeve dhe gjynaheve të tij. Ne duhet të kërkojmë falje për të nga Allahu që është Falës i Madh.

Ai që falë të tjerët ka për t'u falur nga Zoti. Ai që na fal nuk bëhet armiku ynë. Kështu duke falur të tjerët ne shpëtojmë nga të bërët armiq. Ose fitojmë një mik të ri, ose e ruajmë miqësinë e mëparshme. Të bësh miq në vend të armiqëve dhe të ruajmë miqësitë e vjetra ka shumë përfitime. Në rast se nuk tregohemi të mirkuptueshëm, mund të bëjmë armiq.

Të falësh është një shprehje e bukur. Të gjithë shprehjet e bukura e parandalojnë të keqen që mund të vijë nga një shprehje e keqe duke krijuar një kundërbalancë ndaj tij. Zhvillimi i një shprehjeje të bukur, e rrit edhe më shumë aftësinë tonë për zhvillimin e shprehjeve të tjera të mira.

Ne duhet të kemi një personalitet që di të falë. Prandaj ne duhet të zhvillojmë personalitetin duke edukuar egon tonë. Të gjithë njerëzit e kanë potencialisht shprehinë e faljes së gabimeve të të tjerëve, por ajo nuk del në pah vetvetiu. Ekzistojnë rrugë dhe mënyra që të nxjerrim në pah këtë shprehje.

Para së gjithash duhet të heqim dorë nga sjelljet e gabuara që veprojmë në mënyrë që të kërkojmë nga të tjerët që të na falin për veprimet e gabuara që kryejmë ndaj tyre. Prandaj duhet të shmangim të gjithë sjelljet e pakontrolluara. Nuk duhet të veprojmë pa e ditur më parë se çfarë rezultati kanë për të shkaktuar sjelljet tona. Në qoftë se kemi kryer ndonjë veprim të gabuar, me dashje ose pa dashje, si rezultat i të cilit kemi thyer zemrat e njerëzve të tjerë apo i kemi bërë padrejtësi atyre, duhet të dimë që të kërkojmë falje prej tyre. Nëse u kemi hyrë në hak, duhet t'ia kthejmë mbrapsht atë. Në qoftë se nuk kemi mundësi që t'ua kompensojmë të keqen që u kemi shkaktuar, duhet të kërkojmë prej tyre hallallëk. Atyre që na e bëjnë hallall të keqen që u kemi shkaktuar, duhet t'u jemi shumë mirënjohës, ndërsa prej atyre që nuk gjejnë forcë që të na e bëjnë hallall, duhet t'u kërkojmë që të na japin kohë, në mënyrë që me të parën herë që të mundemi t'u kompensojmë dëmin që u kemi shkaktuar. Në qoftë se nuk arrijmë t'i gjejmë personat që u kemi bërë padrejtësi ose ata kanë vdekur, atëherë duhet të bëjmë punë të hajrit në emrin e tyre.

Gjynahqari duhet të kërkojë mjete që të falet nga të tjerët jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime. Ashtu sic është "dhënia hua Allahut" që përmendet në Kuran që nënkupton plotësimin e nevojave të njerëzve nevojtarë në mënyrë që të fitojmë pëlqimin e Allahut. Prindërit mund të kërkojnë nga Zoti që t'ua falë fëmijët e tyre. Besimtari duhet të bëjë istigfar jo vetëm

për prindërit e tij, por për të gjithë besimtarët. Nga Zoti mund të kërkohet falje edhe si një person i vetëm, edhe në grup si një bashkësi.

Zhvillimi i ndjenjës së faljes së gabimeve së të tjerëve arrihet duke e trajtuar njeriun gjynahqar si një person që ka mbetur pas në kapërcimin e shkallëve që të shpien drejt perfeksionimit shpirtëror dhe takimit me Allahun, pasi ka përdorur keq lirinë e tij humane të zgjedhjes në vend që ta trajtojmë atë si një gabimtar të pandreqshëm.

Nëse dëshirojmë që të na falin gabimet që kemi bërë së pari duhet ta pranojmë se kemi gabuar dhe të pendohemi singërisht për atë që kemi vepruar. Duhet të jemi të vendosur se nuk do ta kryejmë më asnjëherë atë gabim. Vetëm nëse e bëjmë këtë gjë meritojmë të falemi nga Zoti. Rruga më e mirë që mos ta përsërisim më gabimin e bërë më parë është të kryejmë ato veprime që janë e kundërta e veprimit të gabuar që kemi kryer. Këto veprime duhen kthyer në natyrën tonë. Në mënyrë që mos të bëjmë gabime të tjera, duhet që t'i drejtohemi Zotit. Jeta, synimet dhe qëllimet tona duhet të jenë mbi të vërtetat absolute. Ky duhet të jetë parimi ynë i përgjithshëm dhe i pandryshueshëm. Vetëm nëse e mbërrijmë këtë fazë atëherë konsiderohemi se jemi penduar singërisht.

Besimtari mund të falë çdo njeri dhe çdo faj që është kryer ndaj tij, madje duhet t'i falë ato. Ai duhet që mos t'ia falë aspak vetes së tij gabimet që bën dhe cytjet që i ka bërë egoja e tij. Prandaj besimtari duhet që t'ia bëjë vetes llogarinë. Ai duhet të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme veten e tij se në çfarë gjendje është dhe se sa afër apo larg është ndaj Zotit me mendimet dhe ndjenjat e tij.

Edhe falja e ka edukatën e saj, sipas së cilës duhet të veprojmë. Edhe ngatërrestarët mund të falin, por falja e tyre nuk ka shenjë mëshire. Ata e shtypin nën peshën e faljes personin që e falin. Gabimtar i mund të shpëtojë nga pesha e dënimit të fajit, por këtë herë ai do të shtypet nga forma me të cilën falet. Njerëzit e devotshëm nuk e lëndojnë me fjalë apo gjeste personin që kanë vendosur ta falin. Madje as i thonë me fjalë se e kanë falur. Ai sillet me gabimtarin a thua se ky nuk ka bërë asgjë të keqe për t'u falur. Në këtë mënyrë ai ia mbulon edhe gabimet e kaluara.

Besimtarët në mënyrë të vecantë duhet të distancohen nga veprimet e gabuara që bëhen në mënyrë publike nëse dëshirojnë që të fitojnë faljen e Zotit, sepse të gjithë besimtarët e ymetit do të falen me përjashtim të atyre që kryejnë haptazi gjynahe. Në qoftë se gjynahun që kryejmë nuk e di kush tjetër përvec Allahut, dëmi i saj kufizohet vetëm me veten tonë. Në rast se edhe të tjerët janë dëshmitarë të gabimeve tona, dëmi i gjynaheve nuk kufizohet vetëm me ne. Veprimi i një gjynahu në mënyrë publike bën që ai veprim të përhapet në mesin e njerëzve dhe të nis të konsiderohet si diçka normale duke ulur kështu reagimin e njerëzve ndaj atij veprimi.

Kështu ne jemi bërë shkak që të përhapet kryerja e një veprimi të keq në mesin e njerëzve.

Njeriu që ka bërë tevbe dhe është falur duhet që mos të bëhet mik me njerëzit e këqinj në mënyrë që ta ruaj këtë gjendje, pasi janë miqtë që shoqëroheni ata të cilët e largojnë njeriun nga qëllimi i tij i mirë dhe e bëjnë që të lindin tek ai mëdyshje në lidhje me vendimin e saktë që mund të ketë marrë.

Në rast se e shndërrojmë aftësinë tonë të faljes së të tjerëve në shprehinë tonë atëherë marrim hise nga atributi Gafur i Allahut. Kështu ne e zhvillojmë potencialin që kemi brenda nesh me anë të atributit Gafur të Zotit duke e manifestuar edhe në jetën tonë të përditshme. Kështu ne veprojmë me një shprehje që është pasqyrim i njërit prejtributeve të Allahut.

Allahu na i fal me qindra herë gjynahet tona për shkak të atributit të Tij, Gafur. Mëshira dhe falja e Zotit nuk kanë kufi. Prandaj besimtari nuk duhet ta ndërpresë asnjëherë shpresën e tij nga falja e Zotit. Vetëm të humburit e presin shpresën nga mëshira e Zotit. Shpresa e madhe tek mëshira e Zotit nuk duhet të na shtyjë neve drejt papërgjegjshmërisë. Besimtari duhet të qëndrojë mes shpresës dhe frikës. Me frikë nënkuptojmë rrëqethjen që të shkakton madhështia e Zotit. Frika e besimtarit nënkupton gjendjen e gatishmërisë që të shkakton frika e humbjes së dashurisë së Zotit. Frika e besimtarit buron nga dituria e tij. Prandaj ata që ia kanë më shumë frikën Allahut, janë dijetarët.

Allahu, që është Gafur, i fal vetëm besimtarët e devotshëm. Ai nuk i fal mohuesit për sa kohë që ata nuk heqin dorë nga mohimi i tyre. Allahu që është Gafur nuk i fal ata për sa kohë që i bëjnë shirk Allahut. Mushriku ka afat që të falet deri në frymën e fundit, sepse deri në atë moment ai e ka mundësinë që të heq dorë nga shirku. Ai që vdes si mushrik, nuk do të falet. Mundësia e personit të ditur që të shpëtojë nga shirku është më e madhe se e atij që është injorant. Prandaj njeriu duhet që të shtojë sa më shumë nivelin e tij të diturisë. Ai duhet ta ruaj dhe ta forcojë besimin e tij duke bërë vepra të mira dhe duke i dhënë formë jetës së tij në varësi të diturisë që ai ka. Për sa kohë që veprojmë në këtë mënyrë aq më shumë i pakësojmë gabimet tona. Edhe kur gabojmë, dimë se duhet që të pendohemi dhe e stolisim veten tonë me tevbe dhe istigfar. Megjithatë magfreti i vërtetë arrihet me anë të dhuntisë hyjnore, jo vetëm me pendimin e robit.

Fitimi i dhuntisë hyjnore arrihet me lutje drejtuar Allahut.

Allahu im! Unë jam treguar shumë i padrejtë me veten time! Unë kërkoj strehë tek Ti nga e keqja e veprimeve të mia! Unë po heq dorë nga gjynahet e mia! Vetëm Ti mund të m'i falësh gjynahet e mia! Më fal me faljen Tënde! Më mëshiro! Vetëm Ti je Mëshiruesi, Mëshirëmadhi!



Sahabi që nuk heshtte para padrejtësisë

Zejd ibn Erkam (r.a.)

Ky sahab pati transmetuar nëntëdhjetë hadithe nga Profeti Muhamed. Në moshë të thyer, kur i kërkonin që të raportonte hadithet që dinte, ai nuk pranonte, duke thënë se tashmë kishte filluar të harronte për shkak të moshës dhe e kishte të vështirë t'i riprodhonte me përpikmëri hadithet që ruante në kujtesë. Shumë hadithe të transmetuara nga Zejdi gjenden të regjistruara në Kutubi Sitte apo në libra të tjerë të haditheve. Tetëdhjetë e katër prej tyre, duke llogaritur edhe ato që përsëriten në kapituj të ndryshëm, gjenden në librin Musned të Ahmet b. Hanbelit (IV, 366-375)

Zejdi sillej me përpikmëri të madhe në lidhje me raportimin e haditheve dhe kur kërkohej ndonjë njohuri fetare prej tij. Kjo karakteristikë e tij vihet re në këtë raportim:

Raportohet nga ibn Ebu Evfa se, kur shkonim pranë Zejd ibn Erkamit, kërkonim prej tij të raportonte hadithet që dinte nga i Dërguari i Allahut. Ai na përgjigjej se tani është plakur dhe ka nisur të harrojë. Raportimi nga i Dërguari i Allahut është një punë me përgjegjësi. (Ibn Asakir, Kenz, V/239)

Zejd ibn Erkam ishte ortak në tregti me Bera ibn Azibin, prandaj ai kishte njohuri mbi artin e tregtisë, veçanërisht në këmbimin e arit me argjendin. Ai nuk i jepte përgjigje çdo pyetjeje që i bëhej në lidhje me fushën e fikhut, por ata që pyesnin i drejtonte të shkonin të pyesnin persona që kishin më shumë njohuri sesa ai në lidhje me atë çështje. Në lidhje me këtë rast, rrëfen Ebu Minhali:

- Pyeta Zejd ibn Erkam dhe Bera ibn Azibin në lidhje me shkëmbimin e arit me argjendin. Asnjëri prej tyre nuk më jepte përgjigje, se të dy tregoheshin të kujdeshëm në këtë çështje. Sa herë që i drejtohesha njërit prej tyre, më adresonte tek tjetri, duke më thënë: "Shko dhe pyete atë më mire, se ai është dijetar dhe

njohës më i mirë se sa unë në këtë çështje. (Ibn Abdulber, Xhami, II/166)

Një dijetar nga Kufeja, që i takonte brezit të tabiinëve, rrëfen këtë ngjarje në të cilën tregohet përpikmëria e tij:

- Jezid ibn Hajjani rrëfen se një ditë kishin shkuar Husajn ibn Sebre dhe Amr ibn Muslimi tek shtëpia e Zejd ibn Erkamit. Pasi hymë brenda dhe u rehatuam Husajn ibn Sebre mori fjalën dhe tha:

- O Zejd! Ty të ka dhuruar Allahu shumë mirësi. Ti je takuar me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ke bashkëbiseduar me të, je falur pas tij dhe ke marrë pjesë në luftë së bashku me të. Të gjitha këto janë arsye të ndihesh i privilegjuar dhe i gëzuar. O Zejd! Na rrëfe se çfarë ke dëgjuar nga i Dërguari i Allahut!

Pasi e dëgjo, Zejd ibn Erkam (r.a.), i tha:

- Nipi im! Vallahi jam bërë plak tani. Ka kaluar shumë kohë nga ato ditë për të cilat pyet ti. I kam harruar një pjesë të atyre që kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut. Prandaj mësoni ato që u them dhe mos më kërkonin të kujtoj gjëra që nuk i mbaj mend mirë.

Pastaj Zejdi vazhdoi duke thënë:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u ngrit në këmbë kur ishim tek burimi i ujit Hum, që gjendet mes Mekës dhe Medines dhe mbajti një ligjëratë. Pasi e lavdëroi Allahun më parë, tha këto këshilla:

- O njerëz! Edhe unë jam një njeri si ju! Së afërmi do të më vijë edhe mua engjëlli i Zotit dhe do të më ftojë që të shkoj në jetën tjetër. Po ju lë pas dy gjëra të rëndësishme. Njëra është Kurani, udhërrëfyes dhe dritë për njerëzit që t'i shpjerë ata në rrugën e drejtë. Kapuni fort pas tij.

Pasi na këshilloi gjerë e gjerë në lidhje me kapjen fort pas Kuranit, vazhdoi duke thënë:

- Po ju lë pas edhe familjen time profetike! Kijeni frikë Allahun dhe respektojeni familjen time. Kijeni frikë Allahun dhe respektojeni mirë familjen time!

Husajn ibn Sebre e ndërpreu Zejdin dhe e pyeti:

- Kush quhet familja e Profetit? A nuk janë edhe gratë e Profetit pjesë e familjes profetike?

Zejdi u përgjigj:

- Gratë e Profetit janë të gjitha pjesë e familjes profetike. Më saktë, të gjithë ata që e kanë të ndaluar të marrin pjesë nga sadakaja janë pjesë e familjes profetike.

- Kush e ka të ndaluar të marrë sadaka? - pyeti Husajni.

- Familja e Aliut, e Akilit, e Xhaferrit dhe e Abasit, - u përgjigj Zejdi.

- Të gjithë antarët e këtyre familjeve e kanë haram të marrin pjesë nga sadakaja? - pyeti sërish Husajni.

- Po. - u përgjigj Zejdi. (Muslim, Fedailu's-sahabe 36)

Sipasnjëraportimitjetër, i Dërguari i Allahutkathënë:

- Po ju lë pas dy gjëra të rëndësishme. Njëra prej tyre është Libri i Allahut. Kapuni fort pas saj. Ai është litar i që ju mban juve të lidhur me Allahun. Kush e lëshon këtë litar humbet rrugën e drejtë dhe kush e mban fort atë, do të jetë përherë në rrugën e drejtë... (Muslim, Fedailu's-sahabe 37.)

Nga Zejd ibn Erkami janë raportuar hadithe në lidhje me tema të ndryshme. Njëra prej tyre është edhe ky hadith, në të cilin tregohet përpikmëria e Ebu Bekrit për t'u distancuar nga çdo llokmë haram. Hadithi është:

Ebu Bekri kishte një skllav që nganjëherë i bënte ndonjë rreng. Një ditë skllavi në fjalë i solli një ushqim në shtëpi Ebu Bekrit. Ebu Bekri mori një llokmë nga ai ushqim. Skllavi e pyeti Ebu Bekrin:

- Çfarë ka ngjarë me ty sot? Çdo herë që të kam sjellë ndonjë gjë për të ngrënë më ke pyetur më parë se nga vinte ai ushqim, ndërsa sot nuk më pyete.

- Më kishte marrë shumë uria. - i tha Ebu Bekri. - Me të vërtetë, nga e solle këtë ushqim?

- Kalova sot nga një miku im, që e kam njohur që nga kohët e xhahilijes. Po bënin një dasmë dhe më dha nga ky ushqim.

Kur i dëgjoi këto fjalë, Ebu Bekri u nxeh shumë me skllavin e tij dhe i tha:

- Ti ke vendosur të më shkatërrosh mua apo si e ke hallin?

Pastaj nisi ta provokonte me duar stomakun që të villte, por i thanë se mundohej më kot ashtu, se vetëm me ujë mund ta villte ushqimin. Ai urdhëroi t'i sillnin ujë.

Nga një anë mundohej të pinte ujë, ndërsa nga ana

tjetër përpiquej ta villte atë që kishte ngrënë. Kështu vazhdoi deri sa e volli tërë ushqimin.

- Allahu të faltë. - i thanë ata që gjendeshin aty. - Gjithë këtë e bëre vetëm për një kafshatë?

Ebu Bekri u përgjigj:

- Do ta nxirrja atë kafshatë edhe po ta dija se do të më dilte shpirti më parë, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë se vendi që meriton trupi që rritet me haram është zjarri i xhehenemit. Kisha frikë se trupi do të ushqehet me këtë kafshatë. (Ebu Nuajm, Hilje I/31)

Zejdi (r.a.), u mësonte sahabëve të tjerë duatë që duhet të lexojë një besimtar gjatë jetës së përditshme:

I Dërguari i Allahut (a.s.), kur e përfundonte namazin, thoshte këto dua:

- O Zoti im! Zoti i çdo gjëje! Unë dëshmoj se vetëm Ti je Zot! I vetëm dhe pa shok!

- O Allahu im! O Zoti im! Zoti i çdo gjëje! Unë dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari Yt!

- O Allahu im! Zoti i çdo gjëje! Unë dëshmoj se të gjithë besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin.

- O Allahu im! O Zoti im! Zoti i çdo gjëje! Më bëj mua të sinqertë me veten time dhe me familjen time, si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën tjetër.

- O Zot madhështor dhe bamirës. Më prano lutjet që t'i drejtoj. Allahu është më madhështori.

- O Allahu im! Ndrìçoji qiejt dhe tokën. Allahu është më madhështori.

- Mua më mjafton vetëm ndihma e Allahut. Ai është mbrojtësi më i mirë. Allahu është më madhështori. (Bidaye, IV/243; Hilje, I/119)

Në një hadith tjetër ai na mëson këtë dua nga Profeti.

Zejd ibn Erkami raporton se i Dërguari i Allahut (a.s.), bënte këtë dua:

- Allahu im! Më ruaj nga pamundësia fizike, përtacia, koprracia dhe dënimi i varrit.

- Allahu im! Më fal devotshmërinë dhe më pastro nga çdo lloj gjynahu. Vetëm Ti i fal gjynahet.

- Allahu im! Më ruaj nga njohuritë e padobishme, nga zemra e pandjeshme, nga egoja që nuk di të ngopet dhe nga duatë që nuk pranohen prej Teje! (Muslim, Dhikr 73)

Në vitet e fundit të jetës së tij, Zejd ibn Erkam u vendos në Kufe, ku edhe vdiq në vitin 686 (66 hixhri).

Allahu qoftë i kënaqur me të. Zoti ynë na bëftë të gjithëve të sinqertë në fe si Zejdi dhe na mundësoftë shefaatin e Profetit.

Amin!



Mos e sillni rruzën NË SHKOLLË

Nuredin Nazarko

Në kushtet në të cilat jetojmë dhe në rrethanat tranzitive në të cilat gjendemi, çdo ditë përhasemi me problematika dhe sfida nga më të llojllojshmet. Secili sektor i jetës, secili dimension i saj ka problematikat specifike. Kjo nuk do të thotë që çdo sektor i jetës funksionon i pavarur nga një sektor tjetër, përkundrazi. Për t'u mbajtur me ide të caktuara dhe për t'u formuar profesionalisht, njeriut i duhet të kalojë në zinxhirin arsimor dhe për më tepër të djersijë dhe sakrifikojë shumë nga koha dhe energjitë e tij. Në rast se kalon zinxhirin arsimor pa djersitur dhe sakrifikuar, atëherë misioni i tij mbetet i dështuar.

Shkolla është një institucion i rëndësishëm në jetën e një kombi. Zhvillimi në drejtimin e duhur të arsimit, çon në kahun e duhur dhe zhvillimin e kombit, si dhe anasjelltas. Institucioni i shkollës e merr kuptimin nga

ata të cilët e gjallërojnë, nga ata të cilët i japin jetë, nxënësit dhe mësuesit. Janë raportet që krijojnë këto dy palë, ato që e çojnë ose jo ecurinë normale të shkollës në limanin e duhur ose jo. Sot, shumëçka ka ndryshuar nga kohët e mëhershme në shkollën shqiptare.

Ndryshimi më themelor që ka pësuar shkolla shqiptare është hapja ndaj dinamikave të reja të zhvillimit, paçka se nxënësit apo mësuesit në përgjithësi nuk mund të jenë në mënyrë absolute në sinton absolut me kërkesat e këtyre dinamikave të zhvillimit. Sot më shumë se kurrë mund të aksesojmë informacionin që shpërndahet, libra në versionin e-book, botime nga më të ndryshmet dhe të llojllojshmet, që dikur as që mund t'i ëndërroje dhe jo më t'i kishe në dispozicion. Por, krahas mundësive të shumta që ofrohen sot për të mësuar, vërehet gjithmonë e në rritje një ulje

e dëshirës për t'u zhytur në thellësitë e librave, për të nxjerrë prej këtyre thellësive perlat e çmuara që mbajnë. Nxënësit sot, jo vetëm që nuk zhyten në thellësitë e librave, por nuk u kushtojnë aspak vëmendje, as atyre që mundohen t'u tregojnë rrugën e thellësive të librave.

Arsimimi i njeriut ecën në dy binarë të rëndësishëm, edukata dhe profesionalizmi. Mund të kemi nxënës të talentuar, nxënës që mësojnë, nëpunës të aftë të së nesërme, por në qoftë se nuk janë mbajtur me edukatën etiko – morale kemi për të parë akoma më shumë çudira në sjelljen e tyre ndaj mësuesve, ndaj prindërve dhe ndaj qenies njerëzore.

Brezi bashkëkohor i nxënësve, është një brez i cili gjendet nën një trysni të fuqishme të rrethanave ku jeton, trysni e ndihmuar fuqishëm nga mjetet e komunikimit masiv, programacionet e të cilave i thurin lavde dhe i bëjnë jehonë mitit të të qenit vetvetja. Nxënës pa asnjë lloj koherence etiko – morale, nxënës pa asnjë lloj skrupulli përballë atyre që, edhe pse ndoshta nuk qëndrojnë në lartësinë e duhur, përpiqen t'u mësojnë ato që dinë, apo t'u tregojnë se çfarë nuk duhet të jenë. Jo vetëm që vuajnë nga mungesa e dëshirës për të lexuar, por vuajnë dhe nga një defçit i madh i sjelljes me edukatë dhe nderim, për atë që përpriqet t'u kumtojë shenjat e rrugëtimit në përkohësi.

Mjediset e institucioneve shkollore sot janë kthyer në mjedise ku gëlojnë sjellje nga më amoralet dhe më negativet, vlerësim ky i bërë pas kalimit në filtrat e etikës dhe moralit. Duhet theksuar, me forcë madje, se sjellja e njeriut nuk mund të vlerësohet nga miti i të qenit vetvetja, por vlerësohet nga parimet etiko – morale.

Sjellja jo e duhur nuk mund të justifikohet as me krikat e adoleshencës, as me ndonjë arsytim tjetër të pavlefshëm. Justifikimet u shërbejnë atyre që janë të paaftë për t'u përballur me sfidat e vetvetes, u shërbejnë prindërve për të justifikuar edukimin jokorrekt që u kanë përcjellë fëmijëve të tyre. Për shkak të një edukimi jokorrekt qysh 20 vjet para lindjes së fëmijës dhe trysnisë së rrethanave ku jetojmë, mjediset shkollore nuk reflektojnë më kulturë. Kultura këtu nuk duhet kuptuar thjesht si korrektësi në sjelljen e jashtme, të dukshme të individit. Megjithëse nuk na bën zemra, por duhet ta pranojmë realitetin, pa zburimet zyrtare.

Rruga ka depërtuar në shkollë. Sjelljet rrugaçërore dhe jokorrekte shfaqen në vazhdimësi. Askush nuk mund të justifikohet me tranzicionin e stërzgatur apo me shprehjen popullore "bëj një sy qorr, e një

vesh shurdh." Mund edhe të mos mësojnë, sepse tek e fundit jo të gjithë e mbartin këtë aftësi, por nuk mund të tolerohet mungesa kaq e theksuar e edukatës në institucionet ku mendohet se farkëtohen brezat e së ardhmes. Të mendosh se fëmija do të të edukohet vetëm në shkollë është një nga gabimet më fatale që bëjnë prindërit. Kur shohin dështimin me fëmijën e tyre, e kanë të lehtë ta gjejnë fajtorin, shkolla, mësuesi. Por, a e ka pyetur ndonjëherë veten ky prind, se si e ka edukuar që nga hershmëria fëmijën e vet që sot ia adreson fajet shkollës dhe mësuesit?

Shumë syresh prej nxënësve po importojnë në mjediset e shkollës sjelljet e rrugës dhe forca e këtyre sjelljeve është më kokëfortë sesa ajo çfarë ofron shkolla si institucion, apo familja si foleja e parë dhe e vetme e gatimit të njeriut të ardhshëm. Përballë kësaj batice, institucioni i shkollës po ndjen vështirësi të panumërta, në edukimin e atyre që prezencën në mjediset e shkollës e kanë kthyer në vendin ku shtyjnë kohën me gallatë. Në vend që shkolla të korrigjojë rrugën, sot është rruga që po i imponohet shkollës. E njëjta sjellje si në rrugë, si në shkollë. I njëjti fjalor, si në rrugë, si në shkollë.

Nuk mund të pretendojmë që të kemi dy standarde sjelljeje, një lloj sjelljeje për prezencën në rrugë, një lloj sjelljeje për prezencën në shkollë. Sjellja duhet të jetë etike dhe morale, si brenda shkollës, ashtu edhe jashtë saj, si nga nxënësit ashtu edhe nga prindërit e mësuesit. Ajo duhet të jetë e reflektuar në çdo çast jetësor. Në rast se kërkojmë modifikim të sjelljes vetëm kur nxënësit janë prezentë në shkollë, kjo do të thotë se nuk kemi forcë që të korrigjojmë dështimin e familjeve për të mos lejuar rrugën që të zërë vënd tek fëmija.

Shumica tashmë po imponon modele të sjellurit, ku në vend të dëgjimit të këshillave të përcjella nga mësuesi – edukator, dëgjohen këngëtarët e ashtuquajtur vip-a, ku në vend të lodhjes dhe djersitjes për të përfituar dije, harxhohet energji në gallatë dhe hajgare. Vërshimi i rrugës brenda shkollës sot është bërë i pafrenueshëm dhe ky është një shqetësim serioz, sepse në rast se nuk bashkëpunojnë të gjithë aktorët me seriozitet në frenimin dhe dëbimin e rrugës nga shkolla, nuk do të jetë e largët dita që edhe ata pak të mirë që rezistojnë në të tilla mjedise, do të asimilohen dhe atëherë kombi me siguri do të marrë rrugën e përparimit pa kthim drejt shtjellave të humnerave të fundbotshme.

Prindër, nxënës, mësues, instanca shtetërore iu lutem, mos e sillni rrugën në shkollë!



Ala nuk mund të më shikojë Mua!

Adem Saraç

Krahas të gjitha pengesave, Islami vazhdonte të përhapej. Tashmë dielli kishte lindur. Kështu që ky proces do të vazhdonte deri në Kiamet.

Sa më shumë që Islami të përhapej dhe fatlumët të nderoheshin me fenë e Allahut Teala, politeistët zemëroheshin edhe më tepër. Krahas të gjitha masave që merrnin dhe të gjitha pengesave që nxirrnin, prapë se prapë nuk arrinin ta ndalonin Islamin. Në vend që t'i shikonin ngjarjet dhe të zgjoheshin nga gjumi i shkujdesjes, politeistët zhyteshin më shumë në errësirë dhe nxirrnin metoda të reja për ta ndaluar Islamin dhe për ta luftuar atë.

Ata filluan të silleshin më me ashpërsi dhe më me ngurtësi në armiqësi ndaj myslimanëve duke

nisur që nga i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam. Ata e tepruan aq shumë, saqë i nxisnin njerëzit e tyre të pavlerë dhe injorantë për të sulmuar të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam. Dielli i të Dy Botëve u plagos në këtë sulm të pamëshirshëm.¹

Politeistët nuk mjaftoheshin vetëm me sulmet fizike, por provonin çdo lloj mënyre për ta ndaluar Islamin. Veçanërisht sulmi psikologjik kishte arritur dimensionet më të larta. Domethënë, ata e sulmonin të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam, duke bërë çdo lloj shpifjeje që nuk i besonin as vetë dhe thoshin se ai ishte poet, magjistar, fallxhor dhe i çmendur.²

1. M. Asim KËKSALL, Historia Islame, vëll. 1, fq. 347.

2. Ibn Is'hak, es-Siretu'n-Nebevije, fq. 308.

Vallë, çfarë u bënin politeistët tradhtarë shokëve të dashur të të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, kur vetë Pejgamberit ia bënin këto? Ata i kapnin myslimanët një nga një dhe dy nga dy, u vishnin rroba prej hekuri në trupat e tyre të zhveshur, i shtrinin nën diellin e nxehtë dhe i linin të digjeshin derisa u shkrihej lëkura.³

Pasi mushrikët / politeistët e panë fuqinë e Islamit, kaluan në një sulm më të organizuar. Çdo fis u bënte ndëshkime të ashpra dhe tortura çnjerëzore atyre që bëheshin myslimanë nga gjiri i tyre.

Tashmë ishin bërë të përditshme burgosja, rrahja, torturimi, zvarritja nëpër tokë, të lënë pa ngrënë e pa pirë dhe mbajtja e myslimanëve nën diellin përvëlues në vendet dhe orët më të nxehta të Mekës. Politeistët e pashpirt çdo mysliman i bënin tortura sipas njeriut dhe vendit.⁴

Ata që nuk mund t'i kapnin dhe t'i torturonin, i sulmonin në mënyra të tjera. Prej këtyre kishte myslimanë që mbroheshin nga fisi dhe të afërmit e tyre.

Kur fatkeqi Ebu Xhehil, i cili kryesonte në çdo lloj torture, dëgjonte se dikush fisnik dhe i mbështetur nga të afërmit e tij bëhej mysliman, menjëherë shkonte dhe e ofendonte:

-Ti ke lënë fenë e babait tënd! Ai ka qenë më i mirë se ti. Domethënë se ti nuk ke aspak konsideratë për mendimin e tij dhe ia ke ulur nderin, ashtu ë? Beto-hemi se edhe ne do të të konsiderojmë të çmendur! Përveç të tjerash, do të ta vërtetojmë se je në gabim të plotë. Kështu që do të të bëjmë ta humbësh nderin!

Krahas kësaj, nëse personi që ishte bërë mysliman, ishte një njeri që merrej me tregti, atë e sulmonin me një mënyrë tjetër duke i thënë:

-Ti je një burrë tregtar, por tani nuk do të të lëmë të merresh me tregti. Të betohemi se do të ta ndalojmë aktivitetin tregtar dhe do të ta shkatërrojmë pasurinë.⁵

Në Mekë tashmë vazhdimisht flitej për Islamin. Edhe myslimanët, edhe politeistët vazhdimisht flisnin vetëm për Islamin. Ndërkohë që myslimanët flijonin jetën e tyre për ta mësuar dhe zbatuar Islamin, edhe politeistët flijonin jetën e tyre për ta ndaluar Islamin dhe për t'i nxjerrë myslimanët nga feja e tyre. Domethënë, të gjithë sakrifikonin sipas besimit të tyre.

3. Ibn Sa'd, et-Tabakatu'l-Kubra, vëll. 3, fq. 233.

4. Taberi, Tarihu'l-Umem ve'l-Muluk, vëll. 2, fq. 220.

5. Belazuri, Ensabu'l-Esraf, vëll. 1, fq. 198.

Krahas të gjithave, Islami po përhapej dhe myslimanët po shtoheshin. Politeistët fatkeqë u tërbuan edhe më shumë. Sikur të mos mjaftonin torturat dhe dhuna që ushtronin kundër myslimanëve, tashmë nxisnin edhe njëri-tjetrin. Situata degradoi aq shumë, sa që myslimanëve ua mbyllën të gjitha rrugët.

Kur xhaxhai i të Dërguarit të Allahut (a.s.), Ebu Talibi vuri re se mushrikët e kaluan cakun në tërbimin e tyre, mbledhi bijtë e Hashimit dhe Muttalibit dhe i ftoi që ta mbronin Pejgamberin (a.s.). Këta dy fise e pranuan menjëherë propozimin e Ebu Talibit dhe u bashkuan me atë. Ndërsa tradhtari Ebu Lehebi e refuzoi këtë propozim dhe ftesë.⁶

Shtëpia e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, ishte ndërmjet shtëpive të dy fqinjëve të këqinj të tij, Ebu Lehebit dhe Ebu Muajtit. Këta të pafat nuk u mjaftuan me gjithë këto tortura dhe dhunime, por merrnin edhe plëndësat e kafshëve dhe i hidhnin para derës së të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Edhe pse i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, nuk tha gjë për një kohë të gjatë, më së fundi nuk rezistoi dot pa e shprehur shqetësimin e tij:

*"O bijtë e Abdi Menafit! Çfarë fqinjësie është kjo kështu!"*⁷

Kur nga njëra anë thoshte këto fjalë, nga ana tjetër përpiquej të pastronte papastërtitë e hedhura para derës së tij.

Kur xhaxhai i tij, Hamzai (r.a.), dëgjoi për këtë veprim të shëmtuar, edhe pse ato ditë akoma nuk ishte bërë mysliman, deshi t'i jepte fund kësaj pune.

Përsëri një ditë tjetër, kur fatkeqi Ebu Lehebi dëshi të hidhte para derës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), papastërtinë që kishte sjellë, erdhi xhaxhai i Pejgamberit (a.s.), Hamzai. Edhe pse gjithmonë e respektonte Ebu Lehebin ngaqë e kishte vëlla të madh, ai nuk e duroi dot këtë veprim kaq të shëmtuar. Ndërkohë që tradhtari Ebu Lehebi po e hidhte papastërtinë para derës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), madje, mbi derë, në mënyrë që ajo të hynte brenda, Hamzai (r.a.), ia kapi enën në të cilën kishte papastërtinë dhe ia hodhi në kokë Ebu Lehebit.⁸

Ebu Lehebi, i cili nuk e kuptoi se çfarë ndodhi në atë moment, kur pa se këtë ia bëri vëllai i tij, nga njëra anë fshinte papastërtinë prej kokës dhe nga ana tjetër filloi të bërtiste me të madhe duke i thënë:

6. Ibnu'l-Esir, el-Kamil fi't-Tarih, vëll. 2, fq. 65.

7. Ebu'l-Ferexh Ibnu'l-Xhevi, el-Vefa bi Ahvali'l-Mustafa, vëll. 1, fq. 182.

8. Ibnu'l-Esir, el-Kamil fi't-Tarih, vëll. 2, fq. 70.

-Budalla, budalla i mjerë!

Ebu Leheb fatkeqi nuk u mjaftua me kaq. Ai vazhdimisht e gjuante me gurë shtëpinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga shtëpia e tij dhe nga shtëpia e fqinjit të tij, Adijj ibn Hamrau's-Sakafi.⁹

Edhe bashkëshortja e Ebu Lehebit, Ummu Xhemili, e kalonte cakun në armiqësinë që shfaqte ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe aspak nuk ngelte prapa nga bashkëshorti i saj në mohimin e fesë dhe inatin e vet.

Ummu Xhemili, jo disa herë, por çdo natë mblidhte ferra dhe degë me gjemba, i bënte grumbull të madh, i lidhte në kurriz dhe i hidhte në rrugën që kalonte i Dërguari i Allahut (a.s.), në mënyrë që t'i nguleshin në këmbë dhe ta plagosnin atë.

Ndërsa i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, kalonte mbi to sikur po shkelte mbi rrerë apo mbi pambuk.¹⁰

Përsëri një ditë tjetër, ndërsa i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, po qëndronte pranë Qabes me mikun e tij të dashur, Ebu Bekrin (r.a.), Ummu Xhemili shkoi atje. Në dorë kishte një gur të madh. Kur Ebu Bekri e pa atë, u shqetësua shumë. Andaj u kthye nga Pejgamberi dhe i tha:

"O i Dërguari i Allahut! Kjo që po vjen është tradhtarja Ummu Xhemili. Ajo është një grua e poshtër. Po vjen drejt teje. Kam frikë në mos të shikon. Andaj gjej një mënyrë dhe largohu para se kjo grua tradhtare të të bëjë ndonjë gjë të keqe ose shko në ndonjë qoshe ku ajo nuk mund të të shikojë.

"Ajo nuk mund të më shikojë mua!"¹¹

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i cili iu përgjigj kështu mikut të tij të dashur, nuk lëvizi aspak nga vendi i tij.

Me të vërtetë ashtu ndodhi. Ummu Xhemili nuk e pa dot të Dërguarin e Allahut (a.s.). Allahu i Lartësuar bëri që kjo grua tradhtare të mos e shikonte atë. Kjo grua e poshtër arriti të shikonte vetëm Ebu Bekrin. Sapo e pa Ebu Bekrin (r.a.), u nxeh dhe

i shkoi pranë:

-O Ebu Bekr! Ku është shoku yt?

-A nuk shikon asnjë njeri pranë meje?

-Mos u tall me mua! Unë nuk shoh asnjë njeri pranë teje. Andaj më thuaj se ku është shoku yt!

-Ç'të duhet ai?

-Nëse ai është poet, betohem se edhe unë jam një grua poete. Edhe bashkëshorti im është poet. Ja, unë po e satirizoj atë këtu pranë teje!

Kjo grua fatkeqe tha poezi që e satirizonin të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam. Edhe pse Ebu Bekri ndërhyri, nuk arriti ta bënte të heshtte atë tradhtare. Ajo sa vinte e nxehej edhe më shumë:

-Të betohem se po ta shikoja atë, do ta gjuaja më këtë gur në fytyrë dhe do t'ia thyjeja hundët e turinj-të. Na qenka edhe poet, pale!

-Jo! Për Zotin shoku im nuk është poet! Ai nuk thotë poezi. Betohem në Allahun se ai nuk të ka satirizuar ty!

-Patjetër që ti je një njeri i besueshëm, por Kurejshit e dinë mirë se unë jam vajza e të mëdhenjve të tyre. Andaj, askush nuk mund t'ia dalë mbanë me mua!

Gruaja tradhtare u largua duke murmuritur ashtu siç erdhi. Ebu Bekri mori frymë thellë dhe tha:

"O i Dërguari i Allahut! A nuk të pa ajo ty?

"Nuk më pa. Allahu ia mori shikimin asaj dhe mua më bëri të padukshëm për të!"¹²

Ebu Bekri, radijallahu anh, u shqetësua shumë për të Dërguarin e Allahut (a.s.), për të cilin flijonte çdo gjë të tij, sepse atë e donte shumë. Të gjithë jetën e tij e kaloi me të. Ai nuk ishte vetëm shoku i të Dërguarit të Allahut (a.s.), por një pjesë prej shpirtit të tij...

Padyshim se Allahu Teala është i fuqishëm për çdo gjë. Edhe këtu e mbrojti të Dërguarin e Tij nga sulmi i asaj gruas tradhtare. Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Ajo nuk mund të më shikojë mua."

Sal-lallahu alejhi ve selem...

12. Dhehebi, Tarihu'l-Islam, fq. 147.



9. Ezraki, Ahbaru Mekke, vëll. 2, fq. 200.

10. Kadi Ijaz, esh-Shifa, vëll. 1, fq. 291.

11. Ebu Nuajm el-Isfahani, Delailu'n-Nubuvve, vëll. 1, fq. 193.



Devotshmëria dhe frikë-respekti ndaj Allahut të Lartësuar

Mustafa Asim Kyçkashçe

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Huxhurat, 13)

Frikë do të thotë të ruhesh nga ndonjë dëm që e ndjen nga brenda dhe e pret që të ndodhë. Andaj, të kesh frikë do të thotë ta ruash veten dhe ata që i do nga ky dëm.

Kjo pritie e padëshirueshme mund të mbështetet edhe te iluzioni, edhe te dija...

Ne kemi frikë që mbështeten te iluzioni, si frika ndaj errësirës, frika ndaj vendeve të mbyllura, frika ndaj lartësisë etj. Edhe besëtytnitë dhe besimet e humbura u ngjajnë këtyre.

Nga ana tjetër kemi edhe frikë reale që bazohen te përvoja si frika nga të sëmurët prej të ftohtit, frika nga aksidenti për shkak të shpejtësisë së lartë, etj. Ndërkohë që frikërat e bazuara në iluzione na pengojnë, frikërat e vërteta na bëjnë të marrim masa.

Ne kemi një të ardhme për të cilën jemi të njoftuar dhe të cilës i besojmë, madje i besojmë “jakinen”, domethënë, në mënyrë të prerë dhe sikur e shohim me sy. Vdekja, Vvarri, Tubimi në Ditën e Gjykimit, Llogaria, Peshorja, Ura e Siratit... Andaj, frika ndaj këtyre duhet të na inkurajojë për t’u mbrojtur, në mënyrë që të mos biem në shkatërrim kur t’i përjetojmë këto faza.

Domethënë, duhet të na inkurajojë për devotshmëri...

Devotshmëria vjen nga rrënja “vikaje” që do të thotë të mbrohesh.

Për shembull, ne veshim rroba që na mbrojnë nga i nxehti dhe i ftohti. Ndërsa nëpër luftëra veshim mburoja dhe parzmore që të na mbrojnë nga çfarëdo lloj goditjeje. Veprimi i mbrojtjes në ajetin fisnik, pra vikaje, e cila është rrënja e takvasë, shprehet kështu:

“Nga ajo që ka krijuar, Ai ka bërë për ju hije; ka bërë për ju streha nëpër male; ka bërë për ju rroba që t’ju mbrojnë nga nxehtësia; ka bërë për ju veshje prej metali për t’ju mbrojtur në luftë. Kështu, Ai i përsos begatitë e Veta mbi ju, me qëllim që ju t’i bindeni vullnetit të Tij.” (Nahl, 81)

Ndërkohë që besimet e devijuara e largojnë njeriun nga të vërtetat abstrakte dhe e shpjen te idhujt konkretë, besëtytnitë dhe iluzionet, Islami i tërheq nga konkretet dhe i shpie te abstraktja. E thellon dhe i jep përshpirtje.

Allahu, i Cili të ka dhuruar një rrobë që të mbron nga i nxehti i diellit, ka krijuar edhe një petk që të të mbrojë nga zjarri i xhehenemit: Petku i devotshmërisë.

Njeriu, me mendjen që ia ka dhënë Allahu Teala, ka bërë rroba që nuk i shpon plumbi, të padjegshme dhe që nuk fusin ujë. Atëherë, nëse dëshiron një petk që të të mbrojë në Mahsher, në Urën e Siratit dhe në zjarr, ja ku është petku i devotshmërisë...

Sa herë që lutemi: ***“Na mbro nga ndëshkimi i zjarrit!”*** (Ali Imran, 16), e përdorim foljen që vjen nga “vikaje”. Andaj, Allahu do të na mbrojë, por nëse ne e mbrojmë veten, domethënë, nëse jetojmë me devotshmëri.

Nga cilat gjëra të tjera duhet ta ruajmë veten?

Allahu Teala ia kë vënë detyrë vetes për t’i njoftuar njerëzit rreth gjërave prej të cilave duhet të mbrohen:

“Allahu kurrë nuk e çon në humbje një popull që më parë e ka udhëzuar në rrugë të drejtë, pa ia bërë të njohur se prej çfarë duhet të ruhet. Me të vërtetë, Allahu është i Dijshtëm për çdo gjë.” (Teube, 115)

Nëse e lexojmë me kujdes ajetin e mësipërm, Zoti (xh. xh.), shprehet se një individ apo shoqëri e cila nuk ndalohet prej gjërave haram dhe që nuk e zbaton besimin pasi të udhëzohet dhe të bëhet myslimane, ngelet ballë për ballë me rrezikun për ta humbur udhëzimin dhe për të rënë sërish në humbje. Andaj nuk mjafton vetëm besimi, sepse devotshmëria është kusht.

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Hashr, 9)

“Prandaj frikësojuni Allahut sa të mundeni, dëgjoni e binduni dhe shpenzoni për bamirësi në të mirën tuaj. Ata që e ruajnë veten nga lakmia e saj, pikërisht ata janë të fituarit.” (Tegabun, 16)

Kopracia dhe pangopësia e shtyjnë nefsin drejt mëkateve dhe e zvarrisin drejt ligësive. Andaj ne duhet ta ruajmë veten edhe nga këto.

Ja një lutje që engjëjt e bëjnë për njerëzit dhe që shprehet në Kuranin Fisnik:

“Ata (engjëjt), që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: “O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues! O Zoti ynë, çoji ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me të devotshmit prej prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të vërtetë, është shpëtimi i madh!” (Gafir, 7-9)

Nëse nefsi nuk mbrohet nga ndjenjat e liga dhe nga veprat e këqija që janë rezultate të këtyre ndjenjave, në të ardhmen do të ketë një llogari të rëndë dhe Dita e Mahsherit do të jetë shumë e vështirë për të:

“Qysh do të mbroheni ju, nëse mbeteni jobesimtarë, Ditën në të cilën fëmijët do të thinjen?” (Muzzemmil, 17)

Nëse ajo ditë kalon keq për ne, do të thotë se në fund të ditës na pret ndëshkimi i xhehenemit. Përndryshe, do të arrijmë shpëtimin siç shprehet edhe Allahu Teala:

“Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë dhe Ai do t’i shpëtojë prej dënimit të zjarrit flakërues.” (Duhan, 56)

Ndërsa ata të cilët do të mbrohen atë ditë në sajë të devotshmërisë së tyre, do të shprehen:

“...Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese (e Zjarrit).” (Tur, 27)

Frika që ka njeriu nuk është vetëm kundrejt vetes së tij. Njeriu frikësohet apo duhet të shqetësohet edhe për familjen dhe fëmijët e tij. Allahu Teala thotë:

“O ju që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëjt të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.” (Tahrim, 6)

Edhe Zekerija frikësohej se mos binin në humbje fetarisht pasardhësit e tij. (Merjem, 5)

Të gjithë pejgamberët janë shqetësuar për popujt e tyre dhe i kanë paralajmëruar, në mënyrë që të mos ndëshkohen.

Largimi nga të këqijat dhe mbrojtja prej tyre, në të njëjtën kohë është çështje morali, humanizmi dhe ndershmërie. Për shembull, përpikëria për ta mbajtur fjalën e dhënë pas një marrëveshjeje të bërë është devotshmëri. Në ajetin e 56-të të suren Enfal, Allahu i Madhëruar flet për të pandershmërit e politeistëve, domethënë, për ata që nuk zbatonin asnjë lloj rregulli dhe i shkelnin marrëveshjet. Sikundër kësaj, ka edhe nga besimtarët prej atyre që nuk janë të devotshëm. Kjo çështje, përveç besimit është edhe një kriter moral...

Në ajetin e mëposhtëm dhe në ajete që hyjnë në temë me të njëjtat kushte, dëshmojmë edukimin e Zotit me anë të ndjenjës së frikës. Kështu, Allahu i Lartësuar na fton te ndjenja e frikësimit në shumë raste për sa u përket çështjeve familjare, sociale dhe njerëzore:

“Ndarja mund të bëhet dy herë. Më pas, gruaja ose të mbahet me të mirë, ose të lejohet të ikë me të mirë. Burrave nuk u lejohet të marrin gjë nga ajo që iu kanë dhënë atyre, vetëm nëse të dyja palët frikësohen se nuk do t’i zbatojnë kufijtë e Allahut. Pra, nëse të dy frikësohen se nuk do të mund t’u përmbahen kufijve të Allahut, atëherë nuk është gjynah për asnjërin, nëse gruaja i jep diçka burrit (për t’u ndarë nga ai). Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkëlmi ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë keqbërësit.” (Bakara, 229; Nisa, 3, 25, 35.) Po, këto ajete u drejtohen myslimanëve, por ja që pranimi i Islamit nuk i sjell në pah automatikisht këto ndjenja.

Në këtë ajet fisnik të mëposhtëm, në të cilin përdoren tri folje të ndryshme në lidhje me frikën, ftohemi te ndjenja e frikës dhe empatia:

“Le të druajnë nëse ata lënë pas vetes fëmijë të mitur, duke u brengosur për ta, le të kenë frikë Allahun dhe le të flasin drejt.” (Nisa, 9)

Frika e parë është frikë personale dhe e natyrshme, si për shembull:

Po nëse vdes në moshë të re dhe në një formë të papritur, kush do t’u dalë për zot fëmijëve të mi të dobët dhe në gjendje të mjerë?

Cila është ndjenja që mund ta heqë këtë frikë: “Sigurisht se nga umeti i Muhamedit (a.s.), do të ketë njerëz që t’u dalin për zot fëmijëve dhe t’i ndihmojnë ata.”

Këtu frika e dytë shndërrohet në empati:

“Nëse dëshiron ta ndjesh për vete këtë siguri, duhet të kesh shumë frikë që të mos u bësh padrejtësi jetimëve të të tjerëve.”

Ndër parimet kryesore në Islam është që të duash edhe për të tjerët atë që do për vete. Këtu ka edhe një kërcënim të fshehtë, sepse kaderi bën drejtësi: "Nëse ti u bën padrejtësi jetimëve të të tjerëve, një ditë edhe dikush nga pasardhësit e tu mund të ngelë jetim dhe mund të bëhet objekt i dhunës së të tjerëve. Andaj ki frikë për këtë!"

E treta dhe e fundit, e gjithë çështja lidhet me frikën kundrejt Allahut të Lartësuar. Qëllimi i fundit që synohet të arrihet është frika ndaj Allahut Teala, sepse Ai në të vërtetë do të na i mbrojë fëmijët tanë. Nëse ne nuk i mbrojmë fëmijët e të tjerëve, Ai është që do të na marrë në llogari për këtë. (Shik. Rum, 28; En'am, 81.)

Ndërsa fjala hashjet që ne shpeshherë e përkthejmë frikë-respekt, mbart në vete frikën bashkë me respektin dhe admirimin.

Ruajtja nuk bëhet nga qenia e Allahut Teala, por nga zjarrri dhe të këqijat. Ne mbrohemi jo nga qenia e Allahut, por nga ndëshkimi dhe zemërimi i Tij.

Ndërsa fjala hashjet është një lloj frike që mbart shumë madhërim. Domethënë, të përulesh me mahnitje kundrejt fuqisë dhe artit madhështor të Atij dhe të dridhesh prej emocionit. Për këtë arsye, sa më shumë të shtohet dija dhe njohja e Allahut (xh.sh.), aq më shumë shtohet edhe frikë-respekti. Në shumë ajete, edhe shprehja "bi'l-gajb / edhe pse nuk e shikon" e shoqëron hashjetin. Ky theksim, siç tregon fuqinë e besimit, shpreh se kjo frikë plot madhështi ushqehet me dije, meditim dhe mësim.

Këtë dridhje sigurisht që duhet ta ndjekë ndjenja për t'u mbrojtur:

"Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë." (Nur, 52)

Nëse adresa e frikës nuk është Allahu Teala, atëherë hyjnë në funksion iluzionet. Për këtë arsye, Allahu urdhëron që të gjitha ndjenjat e frikës, të cilat i ka njeriu, t'i drejtojnë nga Ai:

"S'ka kurrfarë fajësimi për Profetin, kur bën atë që i ka urdhëruar Allahu. Kështu ka qenë ligji i Allahut edhe për ata (profetë) që kanë qenë më parë, - urdhri i Allahut është vendim i detyruar të ndodhë -, e të cilët kumtuan shpalljet e Allahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. Allahu mjafton si llogaritës." (Ahzab, 38-39)

"Ja, djalli frikëson vetëm ithtarët e vet. (Atëherë,)

mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!" (Al Imran, 175)

Allahu i Madhëruar na paralajmëron kundrejt djallit të mallkuar duke na njoftuar për hilet, mashtrimet, kurthet dhe vesveset e tij. Kështu që shprehet se ai është një armik i qartë. Andaj ne duhet të kemi frikë që të mos biem në kurthin e shejtanit.

Por kuptimi në këtë ajet është që të fillojmë t'i zbatojmë urdhrat e Allahut Teala. Domethënë, bindjuni urdhrave të Allahut duke iu frikësuar Atij dhe mos u bëni ushtarë të djallit duke iu frikësuar shejtanit!

Ka edhe frikëra të tjera që Allahu i Lartësuar i refuzon:

Vrasja e fëmijës, aborti dhe koprracia për shkak të frikës së riskut... (Isra, 31, 100)

Frika nga armiku me të cilin do të bëhet luftë... (Nisa, 77; Muhamed, 20.)

Frika ndaj përçmimit të përçmuesit... (Maide, 54)



Këto frikë e mbyllin njeriun. Frika nga përçmimi i ka privuar nga Islami shumë njerëz që kishin pozitë në jetën e tyre personale e shoqërore si Ebu Talibi.

Frika që Allahu Teala hodhi në zemrat e armiqve nëpër luftëra siç ndodhi në luftën e Bedrit, është një frikë e tillë që e mbyll dhe e mposht njeriun. Për shkak të saj, njeriu nuk e bën dot atë që mund ta bënte. Sytë errësohen dhe zemrat sa nuk çajnë kraharorin nga të rrahurat e forta të tyre. Ja kështu do të jenë edhe shfaqjet e frikës, ngaqë do të ketë zero shpresë, të cilat do t'i përfetojnë mohuesit e Zotit dhe mëkatarët në ahiret. Edhe frika që përdoret me foljen "feza"

është e njëjta frikë.

Ndërsa frika ndaj Allahut Teala, nga e cila përfitojmë në këtë botë, nuk është një frikë e tillë. Ajo është një frikë që i dridh zemrat, që e zbut njeriun, që e bën të derdhë lot, që e shpie në sexhde, që ia shton butësinë, që e bën të mëshirshëm, që e inkurajon për të bërë adhurim dhe që e ftoh nga mëkati, pra, një frikë që e bën njeriun të veprojë pozitivisht. Kjo ndodh ngaqë akoma ka shpresë për ta tërhequr mëshirën e Zotit të Madh. Dera e pendimit është e hapur dhe njeriu e ka të mundur të rregullohet.

Qëllimi i kësaj frike është që të mos e lërë njeriun të bjerë në shkujdesje, sepse mendimi: "Sidoqoftë ka kohë për t'u penduar" – është një budallallëk. Mendimi: "Sidoqoftë Allahu fal" – është paturpësi. Njeriu që mediton rreth krenarisë, fuqisë dhe madhësisë së Allahut Teala, ka frikë nga Ai në çdo kuptim.

Ajdën Tallaj

Do t'i mëshitetemi Allahut DHE DO TË PUNOJMË ME ENTUZIAZËM

Falënderimet dhe lavdërimet e pafundme qofshin për Allahun e Lartësuar, i Cili na dhuroi Islamin duke na sjellë në këtë botë nga prindër myslimanë dhe i Cili na dhuroi rrugën e mesme, e cila mbart një nder të madh!

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të gjithëve që ta kuptojmë drejt dhe ta zbatojmë Islamin që është mirësia më e madhe e kësaj bote! Edhe pse vazhdimisht po vështirësohet zbatimi i të gjitha dispozitave të Islamit në këtë botë, ku me të vërtetë po punohet për t'i shkatërruar vlerat dhe që po zien nga dehja e interesit, pozitës, pasurisë dhe parasë, të cilat janë prej sëmundjeve të kësaj bote, me ndihmën e Allahut Teala nuk është i pamundur.

Nga njëra anë, nefsu'l-emmare, nga ana tjetër kurthet e shejtanit të mallkuar dhe bota apo mjediset e kufrit që janë bërë më keq se vetë shejtani, edhe pse nganjëherë e fusin njeriun në tufanin e frikërave dhe shqetësimeve të pavend, myslimani, i cili duhet të jetë njeriu i përpjekjes, nuk ka frikë ndaj askujt përveç Allahut Teala dhe vazhdon të punojë pa u demoralizuar në rrugën e drejtë të Islamit. Mirë, por si duhet të jetë frika ndaj Allahut të Lartësuar e pastruar nga frikërat e tjera? Në ajetin e 102-të të sures Al Imran të Librit tonë të Shenjtë, thuhet:

"O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!"

Domethënë se kuptimi i frikës të cilën e do Zoti (xh. sh.), është: "T'i zbatojmë me të gjithë qenien tonë urdhrat e Allahut Teala dhe të përpiqemi të largohemi nga çdo gjë që e ka ndaluar Ai." Abdullah ibn Mes'udi, radijallahu anh, i cili ishte prej dijetarëve më të mëdhenj të Islamit që e pati edukuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpjegon kështu këtë ajet:

"Ky ajet do të thotë që të mos e kundërshtojmë, t'i bindemi, të mos shfaqim mosmirënjohje, por ta falënderojmë, të mos e harrojmë asnjëherë dhe gjithmonë ta kujtojmë Atë."

Po ashtu, në ajetin e 2-të të sures Enfal, Zoti (xh.xh.), thotë:

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten."

Ubej ibn Ka'bi, i cili ishte prej sahabëve të njohur, e pyeti kalifin e dytë, Umerin, radijallahu anh, i cili ishte i njohur për drejtësinë e tij, se çfarë është devotshmëria. Umeri, radijallahu anh, u shpreh kështu në përgjigjen e shkurtër që i dha:

"Të ecësh në një arë me ferra dhe të të mos ngulet në asnjë vend ndonjë gjemb." Nisur nga kjo, ne duhet të veprojmë me shumë kujdes, vendosmëri, durim dhe shpresë.

Të gjendurit tonë ndërmjet frikës dhe shpresës në këtë botë të sproves, ka shumë urtësi. Njëri prej dy gurëve të kufirit që ka vendosur Allahu i Lartësuar, i Cili na ka krijuar në këtë botë të shkurtër, për shpëtimin tonë është shpresa për falje, ndërsa tjetri është frikë nga xhehenemi.

Me lejen e Allahut Teala, ne do të bëjmë përgatitje serioze për t'i arritur rrugët që të nxjerrin në paqe pa e shkëputur asnjëherë shpresën nga falja e pafundme e Allahut të Madhëruar.

Gjithmonë do ta mbajmë aktive frikën ndaj Allahut, frikën për humbjen e xhenetit dhe shqetësimin për humbjen e dashurisë së Zotit (xh.xh.). Turpi, namusi, frika për të mos u zhytur në mëkate dhe të vepruarit me zgjuarsí e kujdes kundrejt Zotit, do të jenë simbolet tona. Ndërkohë, që t'i bëjmë këto me dashuri dhe entuziazëm, manitë si shqetësimet e pavenda, besëtytnitë, fati i keq, nënçmimi dhe frika ndaj njerëzve, të cilat na lënë mbrapa në rrugën tonë dhe na bëjnë të humbim kohën e cila është thesari ynë, do t'i shtyjme me dorë dhe do t'i hedhim në koshin e mbeturinave me një trimëri qytetare.

Në të kundërt, siç mund të humbasë devotshmëria, në shumicën e rasteve mund të na prishet edhe gjendja e shëndetit dhe përshtypjet sonë për shkak të sjelljeve shpesh herë të parregullta dhe të pavenda në këtë metodë jete që po përpiqen të na bëjnë ta gëlltisim si një ideal me emrin modernizim. Nisur nga kjo fjali që thamë, vihet re se stresi është shtuar, problemet e stomakut dhe të zorrëve janë shtuar, niveli i sheqerit është ngritur, imuniteti është pakësuar dhe infeksioneve u është hapur rruga me fillimin e krizave.

Nëse e shohim me vëmendje, do të vëmë re se jeta që na ka dhuruar Allahu Teala është një periudhë e një gare të mrekullueshme. Kjo garë e ka të qartë qëllimin, synimin, urtësinë dhe pikën e nisjes. Në fund të kësaj, do të jenë të qartë më të mirët, më të begatët dhe ata që kanë prirë në shërbime të dobishme ndaj njerëzve. Aftësitë e nevojshme dhe të gjithë faktorët për t'ia dalë mbanë në këtë garë, u janë dhënë mjaftueshëm të gjithë robërve nga ana e Krijuesit. Andaj, urtësia e vërtetë është që t'i përdorim ato siç duhet dhe të arrijmë suksesin. Pas këtij sukcesi, me mirësinë dhe bujarinë e pafundme të Zotit (xh.sh.), do të vijnë mirësitë e xhenetit. Kjo përpjekje e madhe nuk u ngjan garave të kësaj bote provizore, sepse, edhe pse ligji, bilbili i arbitrit apo gjëra të tjera të ngjashme me këto, na shpien të mbajmë anën e dikujt apo te disa gabime të tjera, Zoti (xh.sh.), i Cili është i plotfuqishëm, nuk nxiton për të ndëshkuar. Edhe në kohët më të pashpresa kur të gjitha dyert janë të mbyllura, dera e Atij që të shpie te pendimi dhe kërkimi i faljes është e hapur. Të mos harrojmë se Zoti (xh.sh.), ka dhënë edhe disa fatkeqësi dhe vështirësi, caktimi i të cilave bëhet vetëm nga Ai, për ta matur besnikërinë e robit. Madje, ne e dimë se edhe pejgamberët, të cilën janë të dërguarit e veçantë të Zotit, shpesh herë kanë kaluar nga këto sprova të tilla. Andaj, në ajetin e 31-të të sures Muhammed, Allahu i Madhëruar thotë:

"Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë, e derisa të provojmë ato që thuhen për veprat tuaja."

Nisur nga kjo që thamë më lart, ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm kundrejt kurtheve dhe frikësimeve të shejtanit duke e vendosur në qendër frikën ndaj Allahut, në mënyrë që të jemi të sigurt nga frika dhe shqetësimet e kësaj bote. Në krye të këtyre vijnë: vesveset, nxitimi, zbukurimi i mëkateve, frikësimi me varfëri, inkurajimi për të bërë vepra të shëmtuara, zhytja në iluzione dhe çdo lloj gjëje tjetër e ngjashme me këto. Edhe pse shejtani, njerëzit e djallëzuar që janë ushtarët e tij dhe nefsi na shtyjnë vazhdimisht drejt humnerës, ne duhet të shpëtojmë nga të gjitha shqetësimet, frikërat dhe iluzionet duke u strehuar te Allahu Teala dhe duke i kryer me përpikëri të gjitha detyrat për të cilat jemi urdhëruar. Në ajetin e 22-të të sures Ibrahim thuhet:

"Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: "Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova. Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi. Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me Allahun (në adhurim)." Vërtet, keqbërësit do të kenë një dënim të dhembshëm."

A mund ta shkruajnë mësuesit në dëftesën tonë "ka-loi" pa na futur në provimet e dijës, moralit dhe sinqeritetit në shkollat e kësaj bote?

Shejtani, i cili e ngatërron iluzionin me të vërtetën, përpriqet pa reshtur për të na mashtruar dhe për të na vjedhur besimin. Siç na jep dembelizëm në adhurime, përpriqet të na bëjë ta harrojmë përkujtimin e Allahut duke na thënë:

"Mos hyr shumë thellë! Allahu është falës." Në këtë mënyrë, fshihet pas perdes së mosmbajtjes së anës së dikujt. Ai na inkurajon me fjalë magjepsëse për të bërë çdo lloj gabimi dhe i shkatërron rregullat e vlerave. Gjithashtu, vazhdimisht përpriqet që të na zhysë në punë të pavlera. Ai na tërheq drejt alkoolit dhe drogës, duke na thënë: "Nuk ka gjë për një herë." Por të mos harrojmë se, siç është mirazhi thjeshtë një iluzion, edhe kurthet e djallit ashtu janë. Këtë mirazh tmerrues do ta shohim se nuk është gjë tjetër përveçse një iluzion nëse do të jemi të sinqertë në çdo punë që bëjmë, nëse do t'i falim me xhemat namazet sipas mundësisë, nëse do ta shtojmë bindjen ndaj urdhrave të Allahut, nëse nuk do ta fillojmë punën pa thënë eudhu besmelenë, nëse do ta lexojmë shpesh ajetu'l-kursijin duke qenë me abdest nëse është e mundur, nëse do të largohemi nga haramet dhe nëse do t'i mbrojmë organet dhe gjuhën tonë.

Allahu i Lartësuar na e mundësoftë që të bëhemi prej robërve të Tij të veçantë dhe të arrijmë nderin për t'u bërë umet i përshtatshëm ndaj të Dashurit të Tij, Muhamedit (a.s.):



Videokracia

Edison Çeraç

Ka kohë që tashmë bashkëjetojmë – ku me hir e ku me pahir – me putrën e rëndë të pushtetit të videos. Për ta thënë me një fjalë, të videokracisë¹. Jetëgjatësia e këtij pushteti varet nga shikimet tona; kurse shikimet tona janë magjepsur pas tij, pra kanë rënë pre, të lidhura pa afat.

Vite më parë, mbase rreth dy dekada, videot më të shikuara ishin ato me përmbajtje erotike dhe pornografike. Ndërsa sot sikur po tërheqin gjithnjë e më shumë videot e të ashtuquajturave grupe terroriste, ose të paktën këto po konkurrojnë me një performancë në rritje të gjitha llojet e videove.

Ajo që të lë shpesh pa fjalë është shpejtësia e përhapjes së këtyre videove në të ashtuquajturën kohë reale e metareale po të doni. Si ka mundësi që grupet terroriste, në pamje të parë ca shpura të kërkeshura kaçakësh, zhulsa stoikë, por të kapardisur me lavdi *full HD*, i përhapin videot e tyre kaq rrufeshëm në çdo cep të planetit, e ndërkohë nuk zotërojnë asnjë media audiovizive? Si është e mundur që çdo TV i njohur e i panjohur u jep një hapësirë të dedikuar e gjithaq ceremoniale këtyre videove? E nga ana tjetër, të gjitha këto media natyrisht që janë kundër dhunës, kundër terrorizmit! Patjetër.

Ndonjë mund të thotë se ata vetëm sa i hedhin *online*, një hapësirë në të cilën ka qasje çdokush, e më pas media thjesht na informon në mënyrë “profesionale”. Domethënë, media merr *copy-paste* atë që hidhet *online* dhe shënjon me gisht se ja çfarë po ndodh? Kështu, ajo që na qenka duke ndodhur, e tanishmja, reduktohet me një ledhatim magjik në një imazh të vetëm.

Pyetja mbetet përsëri po ajo: pse çdo media ka hapësirën e dedikuar për riprodhimin e terrorit? Po si ka mundësi që, fjala vjen, media nuk na informon për dhjetëra artistë të talentuar, që edhe ata i hedhin videot e tyre *online*? Po për ata dhjetëra mjekë, që edhe këta hedhin video *online* me këshilla shumë të nevojshme për shëndetin? Po për... E kujt i intereson arti dhe shëndeti? Njerëzve u intereson vetëm ajo që po ndodh tani, në kohë reale. Televizioni ka zëvendësuar të tashmen, duke eklipsuar njëkohësisht të shkuarën – kujtesën.

Me siguri që këto pyetje nuk do trajtohen njëherë për

1. *Cratos* vjen nga greqishtja klasike, dhe një prej kuptimeve kryesore është “pushtet”.

njëherë, sepse përbëjnë shtigje drejt konspiracionit², dhe ky i fundit është thjesht banal për dishepujt e *status quo*-së. Apo jo? Mënyra më mjeshtërore dhe më e sigurt për të varrosur një krim kundër njeriut a njerëzimit është sajdisja e gjindjes me konspiracione.

Televizioni e ka treguar që në krye të herës se në shumë raste nuk ka rëndësi se çfarë po transmeton, por si po e transmeton një gjë dhe si po e përsërit atë – derisa të ngulitet mesazhi, dhe të bëhet realitet që përjetohet nga njerëzit – që përjetohet dhe jetohet më shumë se realiteti familjar dhe shoqëror i tyre.

E ç’ndryshim ka midis videove të terroristëve (vetë regjisorë, vetë aktorë) dhe atyre qindra e mijëra skenave nëpër filma, ku vriten e masakrohen fëmijë, të rinj e të reja, burra e gra, pleq e plaka, fajtorë e të pafajshëm olimpikë?

Kujdes! Vetëm një përgjigje nuk pranohet: të parat janë reale, kurse të dytat jo.

Do të ishte njëmend naive dhe e frikshme njëherësh, nëse dikush do bënte pikërisht këtë dallim.

Le ta shtojmë edhe ndryshe çështjen, për të hyrë kështu nga një derë tjetër e saj: cilat lexime ndikojnë më shumë te njerëzit, leximet historike apo ato letrare? Librat e historisë na paraqiten si riprodhues të asaj që ka ndodhur, ndërsa ata letrarë të asaj që është imagjinuar. Cili libër historik ka ndikuar më shumë se *Odiseja*, se *Don Kishoti*, apo se *Lufta dhe paqja*, apo se *Fausti*, apo se *Katedralja e Parisit*, apo se...

Trillimi ka forcën të të shkëpusë nga përjetimi i jetës që të rrethon, nga rrethanat e përditshme me të cilat ke të bësh. Në këtë mënyrë, qenia pëson njëfarë zhvendosjeje nga realiteti drejt kopjes së tij, apo drejt hartës së tij.³

Së këndejmi, është kuptimplote ankesa e disa njerëzve⁴ kur kanë të bëjnë me subjekte të rënë pre në altarin e videokracisë: “Nuk është/janë në këtë botë!” Ose: “Është n’botë tjetër ai/ajo!”

2. Mbase konspiracioni më i madh është fakti që konspiracionet janë kaq të shumta, kaq të përhapura.

3. Në këtë pikë mund të konsultohen autorë si Baudrillard-i, Borges-i, McLuhan, Agamben-i, Bauman-i etj.

4. Zakonisht në moshë të madhe. E kush tjetër veç tyre?

Drita... përtej derës

E sheh atë dritën atje? E sheh vijën e drejtë të rrezes? E sheh?..

Ajo është drita e besimit, ajo është drita e rrugës sime, është drita që ndriçon shpirtin tim në këtë botë të errët mbushur plot egoizëm e egërsi. Drita e besimit m'i largon të gjitha trishtimet dhe është shndërruar në qëllim jete, duke më ndihmuar që sa herë rruga errësohet nga gjërat e kësaj bote, unë të shoh, t'i shoh mirësitë e Krijuesit dhe atëherë çdo e keqe brenda meje largohet, merr arratinë duke u zbehur tërësisht nga drita. Është kjo dritë frymë për hapat e rinj, plot shpresë drejt dyerve të reja.

...Ndonjëherë dera mbyllet, por drita duket prapë diku, dera mbyllet për rrugetimin e gabuar, mbyllet për të ndjekur të shkruarit e penës pesëdhjetë mijë vjet para se të lindja.

Sa i Mëshirshëm është Allahu!!

Sa dyer të gabuara do hapte njeriu! Çdo derë e mbyllur, çdo derë e hapur ka një arsye e një qëllim hyjnor, mjafton që ta kuptoj, ta pranoj dhe të jem e kënaqur me përcaktimin tim, sepse vetëm kështu do mundem të jetoj, vetëm kështu do mundem të jem e lumtur. Asnjë derë, asnjë mur, asnjë errësi nuk më pengon të shoh dritën e besimit brenda shpirtit, sepse besimi lind dhe jeton aty dhe asnjë mjedis i jashtëm, asnjë arsye jashtë shpirtit nuk mund ta zbehë atë...

Është kjo rreze jete, që më ndihmon të shoh përtej dyerve, përtej mureve, përtej errësirave. Nëse kjo dritë do mungonte?... Më trishton vetëm si mendim dhe as që mundem të mendoj pa dritën e besimit, nuk mundem, sepse mendja të fut në labirintet e saj duke të bërë një mendimtar të humbur, duke të lënë të jetosh mes dyersh të mbyllura, pa ajër, pa dritë, sepse pa udhëzimin hyjnor as mendja nuk ka asnjë kuptim.

Shtigjet e jetës, rrugëtimet e saj nuk janë aspak të lehta, janë gjithmonë të shoqëruara me mjegull, është vetëm besimi që davarit këtë mjegull, është besimi që mbush shpirtin, është besimi që ndihmon për të kuptuar mbylljen e derës dhe shpresën për hapjen e një dere tjetër, asaj dere ku ndodhet drita, mirësia, bekimi dhe mëshira e Krijuesit.

Por unë mundem sepse besoj!! Brenda shpirtit, mes hapësirave nën dritën e Krijuesit kërkoj të mirën, ruaj besimin dhe besimi më ruan mua, marr frymë dhe... shoh dritën përtej dyerve... jetoj!



Ajnur Tutkun

FRIKËRAT E NJERIUT MODERN

Krijesa, e cila quhet njeri, është e krijuar me një shumëllojshmëri ndjenjash. Ajo gëzohet, mërzhitet, emocionohet, frikësohet, shqetësohet, merakoset, zemërohet, çuditet, nxehet, dashuron, urren... Ndërsa engjëjt nuk posedojnë asnjërën prej këtyre ndjenjave. Ndërkohë që ata janë të nënshtruar përgjithmonë ndaj urdhrave të Krijuesit (xh.sh.), njerëzit bien në gabime duke u influencuar më shumë jo nga mendimet, por nga ndjenjat e tyre. Një njeri që i beson ekzistencës dhe njësimi të Allahut me mendjen e tij, mund të gabojë për shkak të ulje-ngjitjeve të bazuara te ndjenjat, të cilat nuk i kontrollojnë dot. Pastaj, përsëri kërkon mbrojtje, falje dhe ndihmë nga Krijuesi për shkak të gabimeve. Dhe pikërisht në këtë moment perceptohet epërsia që njeriu ka ndaj engjëjve. Njeriu mbi tokë është mëkëmbësi i Krijuesit dhe shfaqja e nëntëdhjetë e nëntë emrave të bukur të Tij.

Njeriun post-modern, janë ndjenjat e forta dhe frikërat e fshehta që e zhysin në fund të dheut. Frikërat, shqetësimet dhe brengosjet, për të cilat shpeshherë nuk di gjë, ia vështirësojnë jetën atij.

Përse të ketë frikë një njeri, i cili qëndron në shtëpinë që e ka ndërtuar me duart e veta në një vend të bukur të natyrës dhe në fshatin që ka lindur e është rritur, i cili ha prej atyre frutave që ka mbjellë dhe kultivuar në bahçen e tij, i cili ngrohet me drutë që i ka mbledhur nga mali e zabeli duke i ndezur ata dhe bën çaj bliri për ta pirë në oxhakun e tij kur ndjehet i sëmurë? Ndërkohë që çdo ditë shkon në vreshtin dhe bahçen e tij, varrezat që i shikon, bëhen shkak që ai të jetojë në paqe me vdekjen. Ai e di se, siç kanë vdekur të tjerët para tij, edhe ai do të vdesë kur t'i vijë exheli / koha e vdekjes. Kur goditet nga ndonjë sëmundje e pashërueshme, në vend që të lodhet duke vrapuar doktor pas doktori, u kërkon hallallëk njerëzve përreth dhe prehet duke e dorëzuar shpirtin e tij te Zoti (xh.sh.), në një qetësi të

plotë. Një njeri që e kalon jetën me prehe shpirtërore dhe adhurime përgjatë natës, është njeri i qetë.

Ndërkohë që njerëzit, të cilët jetojnë në qytete apo në vende ku ka hyrë televizori dhe interneti, përpiqen më shumë për t'u bërë të lumtur me shpresën për të poseduar sa më shumë gjëra materiale e shpirtërore, nuk arrijnë ta kuptojnë aq qartë se çdo ditë janë më pak të lumtur. Në këtë mënyrë, njeriu ia bën jetën vetes të pajetueshme me shqetësime, frikëra dhe dëshpërime. Për shembull, një njeri që e siguron shëndetin, shtëpinë, makinën dhe gjërat e tjera të ndryshme, vjen ballë për ballë me një frikë tjetër ndërkohë që mendon se ka shpëtuar nga njëra frikë. Tashmë është i detyruar të punojë e të fitojë më shumë, ose ta mbajë stabil fitimin e tij.

Njeriu modern ka nevojë të ndryshme, ngaqë niset prej atyre që i sheh në televizor apo te fqinji. Ai gjithmonë rend për të marrë dhe për të harxhuar. Frika e lodhjes nëse i lan me dorë rrobat dhe enët, frika e mospëlqimit dhe e mosmarrjes në konsideratë nga të tjerët nëse nuk vishet shik kur të dalë jashtë, frika e mosfitimit të riskut, e mosmarrjes në konsideratë, e mosvlerësimit apo e nënçmimit nëse nuk ka ndonjë profesion apo titull, qoftë për burrat apo qoftë për gratë, e detyron njeriun të lakmojë, të shpenzojë dhe të dërmohet. Njeriu mund ta kuptojë shumë vonë se është bërë rob i nevojave që i prodhon në mendjen e tij.

Njeriu post-modern ka edhe frikërat artificiale. Ndërkohë që i ndan me të tjerët në mediat sociale ato që ha, që pi, vendet në të cilat shëtit e argëtohet, ideologjitë dhe mendimet e tij, në fakt njeriu mund të mos jetë edhe aq i pafajshëm. Shpresa nëse do të marrë apo jo komente dhe klikime pëlqimi për ato që ka shpërndarë në rrjetet sociale, e bren shumë njeriun nga brenda. Pëlqimet, komentet dhe fakti se nga kush i merr ato te shpërndarjet që njeriu bën në rrjetet so-

cialë, gjithmonë shprehin diçka për atë. Fantazitë që kjo egoja i prodhon duke e bërë njeriun të mendojë se është i pavlefshëm kur të mos marrë pëlqime dhe vlerësime të atilla, janë frikëra të pabaza. Ndërkohë njeriu mund ta gjejë vlerën e vërtetë të tij duke qëndruar gjithmonë pranë dhe afër Zotit (xh.xh.). Ndërsa gjëja që e gjen te njerëzit e tjerë është si një helm me dozë të vogël që ia ushqen dhe ia rrit egon e tij dalëngadalë.

Njeriu ka edhe frikëra të tjera të mëdha në lidhje me shqetësimin për të ardhmen: Ai ka frikë të dashurojë, ngaqë mendon se mund të humbasë. Ka frikë nga lartësitë, ngaqë mendon se mund të bjerë. Ka frikë të ketë fëmijë duke menduar se nuk mund ta edukojë. Ka frikë të flasë për veten dhe të shprehet, ngaqë mendon se mund të keqkuptohet. Ka frikë t'i ndajë ndjenjat dhe të qajë duke menduar se mund ta humbasë influencën dhe karizmën. Ka frikë për të formuar miqësi të reja, ngaqë mendon se nuk mund t'i mbajë marrëdhëniet. Por ja që njeriu, krahas të gjitha frikërave dhe shqetësimeve të tij, është një krijesë që ndryshon, zhvillohet dhe piqet. Nëse ai ulet dhe stepet në vendin ku gjendet, bie në kurthin e frikërave të tij.

Njeriu i shkretë modern që nuk e ka shijuar asnjëherë kënaqësinë e të dhënit dhe të të ndarit me të tjerët, frikësohet në mos do t'i mbarohet pasuria dhe të bjerë në gjendje nevojtarë kur të japë. Ai shpesh herë nuk mund të mendojë se llogaria e Krijuesit nuk është si llogaritë e kësaj bote. Ja që tre minus një bëjnë dy dhe dy shumëzim për dy bëjnë katër, janë llogaritë të njerëzve.

Njeriu modern, i cili ka frikë të sëmuret, e indeksin qëllimin e krijimit të tij te të ngrënët e të pirët duke bërë dieta të ndryshme, në mënyrë që të ushqehet sa më shëndetshëm. Gjërat që mendon dhe që flet kanë të bëjnë vetëm me këtë temë sikur të mos ketë asnjë qëllim tjetër. Por ja që, në jetën e kësaj bote ku çdo gjë ekziston me të kundërtën e saj, nuk ka gjë më normale se sa të sëmuresh. Të qenët vetvetja dhe dëlirësia që ka njeriu kur është i sëmurë, i jep atij një prehje, qetësi shpirtërore dhe një gjendje të atillë për ta falënderuar Zotin, saqë këto nuk gjenden në asnjë libër dhe ligjëratë. Domethënë se edhe sëmundjet nuk janë gjëra të këqija për të cilat duhet të kemi frikë përgjatë gjithë jetës, por ata janë shanse që vijnë dhe i bëjnë rregullime precize zemrës.

Për sa i përket vdekjes... Njeriu modern i ka bërë varrezat larg syve, në mënyrë që të mos përballet me këtë të vërtetë shumë të ftohtë, të dhimbshme dhe të papërballueshme për të. Por sa më shumë që të ikë prej saj, frika që ka brenda i rritet aq shumë saqë ia bën helm jetën dhe ia zhdur plotësisht kënaqësinë e saj. Nëse njeriu do të vdesë si çdo gjallesë tjetër e

gjallë, atëherë ai nuk ka çfarë të bëjë tjetër përveçse të jetë në paqe me vdekjen dhe të jetë i përgatitur për të. Më shumë se sa të jetuarit e shkurtër apo të gjatë, e rëndësishme është që të jetojmë në përputhshmëri të plotë me qëllimin e krijimit tonë. Përveç të tjerash, vdekja nuk është një fund, por është fillimi i një jete për të cilën mallëngjehemi.

Njeriu ka frikë edhe nga dëshpërimi. Sikur kjo botë të ishte vendi në të cilin gjithmonë përjetohen vetëm gjëra të bukura. Nëse mërzitet, nëse mendja i ngatërrrohet, nëse i thyhet zemra, nëse zemërohet dhe nëse brengoset, njeriu kaplohet nga trishtimi në mos i vazhdon përjetësisht kjo gjendje. Ose mendon: "Çfarë kam bërë që ta meritoj këtë?" Ai nuk mund të mendojë se gjendja shpirtërore përgjatë këtyre vështirësive mund ta afrojë te Krijuesi i tij. Për këtë arsye, e harron se sa afër Zotit mund të jenë zemrat e brengosura.

Ana më e rrezikshme e frikërave që përjeton njeriu modern është e vërteta se këto frikëra i reflekton edhe te fëmijët e tij dhe i rrit ata nën presionin e atyre. Prindërit, të cilët e shohin veten si përgjegjës për t'i ushqyer fëmijët në mënyrë sa më të shëndetshme, për t'u shërbyer sa më mirë, që të mos sëmuren, që të jetojnë sa më gjatë, që të studiojnë dhe të bëhen njerëz të ditur, që të mos përçmohen ndërmjet njerëzve të tjerë, që të pëlqehen dhe të vlerësohen nga ata që i rrethojnë dhe që gjithmonë të jenë të lumtur, në të vërtetë, bëjnë gabimin më të madh. Krijesa, e cila quhet njeri, gjendet mbi tokë si mëkëmbësi i shfaqjeve të nëntëdhjetë e nëntë emrave të bukur të Allahut dhe që mund të përjetojë çdo gjendje që ekziston me të kundërtën e saj. Për këtë arsye, fëmijët nuk duhet të rriten me frikëra të tilla, por duhet të edukohen me aftësi dhe trimëri për t'u përballur me çdo lloj frike dhe vështirësie.

Njeriu modern, i cili ia vështirëson jetën vetes me frikëra dhe shqetësime të ndryshme, do të jetë i sigurt dhe i mbrojtur vetëm e vetëm kur t'i forcojë lidhjet me Krijuesin e tij, sepse Islam do të thotë paqe dhe siguri. Nëse çdo gjë që i ndodh njeriut realizohet me lejen e Atij dhe, nëse çdo gjë që përjetohet është shfaqje e emrave të bukur të Atij, atëherë duhet të besojmë se përballja me frikërat dhe dorëzimi ndaj Atij, i jep një prehje të thellë shpirtit të njeriut. Ndodhitë dhe ngjarjet që e pikëllojnë, e mërzisnin, e shkatërrojnë, e zhgënjëjnë, e frikësojnë dhe ia prishin moralin njeriut, gjithmonë ndodhin me dijeninë e Atij. Gjërat me të cilat njeriu ka frikë të përballet janë mashtrimet e egos. Shpresa për t'u bërë i pagabueshëm, i përsosur dhe i fuqishëm është pëshpëritje e egos. Të ballafaqohesh me frikërat, të mos kesh frikë asgjë tjetër përveç Atij dhe të frikësohesh mos ndoshta nuk je një rob që i zbaton me përpikëri urdhrat e Atij, me të vërtetë, e bën njeriun të ndjehet i lirë.

Problemet bashkëshortore dhe zgjidhja e tyre

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se problemet familjare dhe bashkëshortore, nuk lindin menjëherë. Një fjalë e urtë thotë: "Ç'të mbjellësh, do të korrësh."

Prandaj, secili prej nesh kontribuon në një mënyrë apo në një tjetër në problemet e shumta me të cilat ndeshemi. Diçka të tillë, na e kujton dhe përmend edhe Zoti në Kuran me fjalët:

Thuaj (o Muhamed): "Kjo u erdhi prej vetes suaj." (Ali Imran, 165) Nëse do të studiojmë familjet e profetëve, që nga Ademi (a.s.), deri tek profeti Muhamed (a.s.), do të gjejmë se të gjithë kanë pasur probleme brenda familjeve të tyre. Ademi (a.s.), u sprovua me një problem shumë të madh familjar. Njëri nga djemtë e tij, vrau të vëllain. A e imagjinoni dot që një krim me përmasa të tilla, ku vëllai vret vëllain, të ndodhë në familjen e një profeti? A e imagjinoni dot që kjo ngjarje makabër të ndodhë në familjen e Ademit (a.s.), babait të njerëzimit?

Probleme familjare ka pasur edhe profeti Nuh (a.s.). Gruaja e tij nuk ishte myslimane, nuk i përkiste fesë së Nuhut (a.s.). Madje, akoma më keq, ajo tallej me Nuhun (a.s.). Po ashtu, njëri nga fëmijët e Nuhut (a.s.), nuk ishte besimtar. Fëmijët e tjerë kishin ndjekur fenë e Nuhut (a.s.) dhe hipën bashkë me të në anijen e shpëtimit. Por njëri prej tyre refuzoi dhe u mbyt.

Profeti Lut (a.s.), u përball me probleme familjare me të shoqen e tij.

Në historinë e Jakubit (a.s.), kemi smirën dhe urrejtjen që lindi tek fëmijët e tij për Jusufin (a.s.). Kjo smirë dhe urrejtje i bëri që ta hidhnin vëllain e tyre në një pus të thellë në mes të shkretëtirës.

Me gjithë këto probleme dhe halle të gjithë profetët jetuan të lumtur. Pra, lumturia konsiston në të kuptuarit e drejtë të problemit dhe trajtimit të duhur të tij. Problemi nuk qëndron në ekzistencën e mosmarrëveshjeve brenda familjes, por në faktin si reagohet

dhe trajtohen ato.

Një besimtar i mirë është një bashkëshort dhe familjar i mirë. Një besimtar i mirë është një prind dhe baba i mirë. Një besimtar i mirë është një gjysh dhe një vjehërr i mirë. Një besimtare e mirë është një bashkëshorte, nënë dhe edukuese e mirë. Një besimtare e mirë është një gjyshe dhe një vjehërr e mirë.

Suksesi i njeriut në familjen e tij është një tregues i imanit (besimit) të tij.

1. Mungesa e Besimit. Një prej shkaqeve kryesore të problemeve familjare dhe divorceve është largimi i njerëzve nga rruga e Zotit (xh.sh.).

"Kushdo që ia kthen shpinën udhëzimit të Zotit, do të ketë një jetë të vështirë në këtë botë..." (Ta Ha, 124) Allahu (xh.sh.), thotë:

"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira që ka bërë." (Nahl, 97)

Ajeti i mësipërm nuk flet për xhenetin, por për jetën e kësaj bote. Në interpretimin e "jetës së bukur" që përmendet në ajetin e mësipërm, shohim se nuk thuhet se kjo jetë nuk do të ketë vështirësi. Jo, ajo ka problemet dhe vështirësitë e veta, por në qoftë se njeriu vepron vepra të mira duke qenë besimtar, atëherë ai do të kalojë një jetë të bukur dhe të qetë në këtë botë.

Feja dhe besimi ndikojnë shumë në largimin e problemeve, halleve, brengave dhe shqetësimeve në familje. Ne jemi mësuar që gjithmonë problemin ta gjejmë tek të tjerët. Por secili nga ne duhet që problemin, fajin dhe gabimin ta kërkojë tek vetja e tij.

2. Gjynahet janë shkaktarë të brengave, pikëllimeve dhe problemeve shpirtërore.

Dijetarët Islamë kanë thënë: "Ai person që i ka në rregull punët me Zotin (xh.sh.), Ai do t'ia rregullojë punët me krijesat e tij."

Shtimi i istigfarit. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Unë me të vërtetë gjatë ditës, kërkoj falje dhe pendohem tek Allahu më shumë se shtatëdhjetë herë." (Buhariu) Në një transmetim tjetër thuhet njëqind herë në ditë. (Muslimi) Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Kush kërkon falje nga Allahu, Allahu do t'i mundësojë lehtësim për çdo brengë, do t'i mundësojë zgjidhje për çdo vështirësi dhe do ta furnizojë nga ku ai nuk e pret." (Hakimi)

3. Ndiemojeni njëri-tjetrin në punë të mira. Allahu (xh.sh.), thotë:

"Ndiemojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në shmangien nga të këqijat, por jo për gjynahe dhe armiqësi!" (Maide, 2)

Bashkëshortët duhet ta urdhërojnë njëri-tjetrin për vepra të mira dhe ta nxisin njëri-tjetrin në punë të tilla. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Allahu e mëshiroftë burrin, i cili ngrihet natën për të falur namaz dhe e çon nga gjumi gruan e tij për të falur namaz e, nëse nuk çohet ia fërkon fytyrën asaj me ujë. Dhe Allahu e mëshiroftë gruan, e cila ngrihet natën për të falur namaz dhe e çon nga gjumi burrin e saj për të falur namaz e, nëse nuk çohet t'ia fërkon fytyrën atij me ujë." (Ebu Davudi, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi)

Profeti (a.s.), ka thënë: "Kush ngrihet natën dhe e zgjon edhe gruan e tij dhe i falin dy rekate bashkë, regjistrohen tek Allahu prej besimtarëve që e përmendin shumë Allahun." (Ebu Davudi, Hakimi)

Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Gruas nuk lejohet të agjërojë nafle në prezencën e burrit të saj, pa lejen e tij!" (Buhariu)

Dijetarët islamë kanë thënë: "Në këtë hadith ka dy urtësi:

a. Gruja duhet të jetë në dispozicion të bashkëshortit të saj.

b. Kjo është një nxitje indirekte për bashkëshortin që edhe ai të agjërojë.

4. Duhet të mësohemi që, nëse gabojmë ndaj njëri-tjetrit, t'i themi më fal palës së lënduar.

5. Mos ia kujtoni njëri-tjetrit të kaluarat. Nëse ka një problem midis jush, merruni me problemin në fjalë dhe mos u merrni me problemet e kaluara, sepse ato probleme i ka mbyllur vetë koha.

6. Shoqëria e keqe. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: "Njeriu është në fenë e shokut të vet, prandaj le të ketë kujdes secili prej jush se me kë shoqërohet" (Ebu Davudi, Tirmidhiu) Hadithi në fjalë tregon qartë se shoqëria ka ndikim të dukshëm tek individ.

Aliu (r.a.), ka thënë: "Mos u shoqëro me njerëzit e këqij, sepse ata t'i zbukurojnë punën e mbrapshta dhe dëshirojnë që edhe ti të bëhesh si ata".


7. Arti i heshtjes. Heshtni dhe dëgjojeni njëri-tjetrin derisa të mbarojnë ankesat. Të pranosh ankesat nëse janë të drejta dhe të thuash Allahu më faltë se ke të drejtë.

8. Bashkëshortët do të jenë së bashku në xhenet inshallah. Për këtë arsye ata duhet t'ia falin gabimet njëri-tjetrit dhe t'ia bëjnë hallall. Ndoshta burri do të jetë në xhenetin firdeus, ndërsa gruaja një gradë më poshtë se ai dhe do të shkojë në xhenetin firdeus vetëm për hir të tij. E njëjta gjë vlen edhe në rastin e gruas.

9. Ekzistenca e një reference për të dy bashkëshortët në konflikt. Në mosmarrëveshjet tona, secila palë ka si referencë mendjen e tij. A është e mundur të arrijmë një rezultat pozitiv, duke e ditur se mendjet tona janë të ndryshme nga njëra-tjetra? Si mund të arrijmë në një rezultat, duke ditur se kulturat ku janë rritur bashkëshortët janë të ndryshme nga njëra-tjetra?

Gjatë hutbes së lamtumirës, Profeti (a.s.), u tha myslimanëve: "U kam lënë dy gjëra. Për sa kohë që do t'u përmbaheni, nuk do të humbisni kurrë. Ato dy gjëra janë Libri i Zotit, Kurani, dhe Suneti (tradita ime)."

Prandaj, nëse kemi Kuranin dhe traditën profetike si referencë, e kemi reduktuar në masë të madhe rrethin e konfliktit dhe mosmarrëveshjeve. Në momentin që biem dakord që problemin ta zgjidhim sipas Kuranit dhe Sunetit, ky problem do të zgjidhet shumë shpejt dhe të dy palët do të mbesin të kënaqura.



SHEGA, FRUTI MAGJIK

Shega së bashku me ullirin, rrushin, fikun dhe hurmat janë ndër pemët më të kultivuara në historinë e njerëzimit. Botanistët mendojnë se pema e shegës u kultivua për herë të parë në Turqi dhe pjesët veriore të Iranit. Por ajo rritet Armeni, Aserbejxhan, Taxhikistan, Turkmenistan, Afganistan, Pakistan, gjithashtu rritet shumë në vendet mesdhetare Spanjë, Palestinë, Egjipt, Marok; Tunizi etj. Shega është një pemë e vogël gjetherënëse, frytet e së cilës kanë një lëng të ëmbël dhe me aromë të veçantë. Lloji më i mirë i shegës është ajo më e lëngshme dhe me ngjyrë të kuqe të forte dhe me lëkurë të hollë. Rritet deri në 5 Metra lartësi dhe gjerësi deri në 3 Metra, jeton me qindra vite. Shega përmendet tre herë në Kur'an. Profeti (a.s) ka propozuar ngrënien e Shegëve për ta pastruar trupin nga xhelozia dhe inati. Në një hadith Profeti (a.s) ka thënë: Nuk ka asnjë lloj shege e në të, të mos ketë fara nga shegat e Xhenetit". Në një hadith tjetër thuhet: "Asnjë shegë nuk piqet, e të mos ujitet madje me një pikë uji nga Xheneti". Në një tjetër thuhet: "Çdokush që ha shegë, zemra e tij do të dridhet dhe shejtani do të ikë prej tij". Kurse në një tjetër hadith Pejgamberi (a.s) thotë: "Kushdo që ha shegë, në zemrën e tij shkëlqen drita e Allahut".



VLERAT KURATIVE TË SHEGËS

Specialistët theksojnë se, lëngu i shegës rrit prodhimin e rruazave të kuqe të gjakut, lehtëson nga temperatura dhe zvogëlon ngarkesën kardiale që vëzhgohet kur dikush është i sëmurë me grip.

Ajo është ideale të përdoret kur fëmijët e vegjël shfaqin kollë dhe temperaturë. Për më tepër, përmban një sasi të madhe fitoestrogjenesh (estrogjene bimore) dhe flavonoide, që kanë ndikim mbrojtës në lëkurë, flokë dhe thonj.

Studime të mëparshme kanë treguar se shega është e përshtatshme edhe për të parandaluar infarkt dhe sëmundje të tjera në zemër, pasi është i pasur me antioksidues të shumtë.

Hulumtimet e fundit mbështesin se, lëngu i saj mund të mbrojë nga infeksionet bakteriale, tumoret e lëkurës, bënë parandalimin dhe ngadalësimin e përhapjes së kancerit në mushkri, kancerit në prostatë, kancerit në gji, diabeti, osteoporoza, etj.

Shkencëtarë amerikanë mbështesin se, konsumimi i përditshëm i shegës nga një mama e ardhshme, mund të pengojë një dëmtim të mundshëm në trurin e embrionit. Përmban lëndë anti-



oksiduese që kontrollojnë tensionin arterial dhe ulin nivelet e kolesterolit.

Shega e pjekur është e nxehtë dhe e lagësht, i ndihmon fytit, mushkërive dhe bronkeve, vepron si lehtësues dhe qetësues i kollës dhe është i mirë për vrerin.

Si laksativ i lehtë, pengon kalbëzimin në lukth dhe është më e fuqishmja në mesin e kategorive të ngjashme të ushqimit si burim me vlera të shumta të substancave për tërë trupin. Shega tretet në lukth dhe thithet shpejt për shkak të temperamentit të saj të jashtë zakonshëm dhe të lehtë, e nxeh lukthin ngadalë, i nxjerr jashtë gazrat e lukthit dhe e rrit sasinë e spermës, megjithatë shega nuk duhet të hahet kur njeriu ka temperaturë.

Lëngu i shegës shuan etjen, rrit oreksin dhe i jep freski mendimit të njeriut për shkak të efektit pozitiv në sistemin nervor.

Gjithashtu përdoret me sukses për heqjen e njollave dhe rrudhave të fytirës.

Lëngu i shegës ka tre herë nivelin më të lartë të antioksidantëve se të rrushit të zi, çajit jeshil dhe se vena e kuqe. Përmban një sasi të lartë të përbërësve bioaktivë, flavonoide; anthocyane, thartirën phenol; polyphenole; të cilat kanë shumë rëndësi në rregullimin, ripërtirjen dhe zhvillimin e qelizave. Është edhe shumë e pasur me kalium, potas, hekur dhe Vitaminat A, C dhe E.

Në mjekësinë popullore përdoren frutat dhe lëvohzat e tyre, lulet, farat, rrënjët dhe lëvorja e degëve dhe e rrënjëve, e cila ka shije të athet dhe ere. Lëngu i shegës përmban mesatarisht 12 për qind sheqer, acide organike, pektinë, vitaminë C, etj. Vetëm 30 minuta pas marrjes së lëngut të shegës aktiviteti ynë rritet me 32 për qind. Lëngu i shegës shuan etjen, nxit oreksin dhe përmirëson tretjen e ushqimeve. Ai përdoret me sukses në sëmundjet e stomakut dhe të zorrëve, është freskues dhe mënjanon helmet e organizmit. Lëngu i shegës jep rezultate në luftimin e parazitëve që zhvillohen në zorrë. Lulet e shegës përmbajnë taninë dhe kanë veti rrudhëse e tonike; ato rekomandohen në dhimbjet e barkut, në hemorragji, në hemorroidet, si dhe për gargara të gojës, kundër ënjtjes së bajameve dhe acarimeve të mishrave të dhëmbëve. Merren 20-30 gramë lule shege në një litër ujë dhe vihen të zihen për gjysmë ore. Nga ky çaj merren 2-3 gota çaji në ditë. Edhe lëvohza e frutave të shegës ka veti regjëse. Lëvohza e thatë, para se të përdoret, duhet të vihet në ujë për disa orë që të zbutet. Çaji i lëvohzgave të shegës përdoret kundër diarreve, si dhe për luftimin e krimbave parazitare të zorrëve. Lëvohza e frutave të shegës lufton me sukses amebat, të cilat e dobësojnë shumë organizmin, e veçanërisht te fëmijët. Për këtë merren lëvohzat e një kokrrë shege, vendosen në një enë prej balte dhe zihen në gjysmë litri ujë derisa të mbetet gjysma e sasisë së ujit.

RREZIKU QË VJEN NGA MIKROVALA

Pothuajse në të gjitha shtëpitë gjendet një furë me mikrovalë. Ato përdoren gjërësisht në kuzhinë për të ngrohur ushqimin. Por sipas studimeve të fundit, mikrovala sjell dëme serioze në shëndet. Mikrovala shkatërron vitaminën B12 e cila është shumë e rëndësishme për organizmin e njeriut. Ajo gjithashtu krijon qeliza kancerogjene për shkak të rrezatimit që lëshon kurse ushqimet që ringrohen në mikrovalë i humbasin të gjitha vlerat ushqyese. Sipas një studimi të bërë në Zvicër studiuesit konstatuan se njerëzit që hanin qumësht ose perime të ngrohura në mikrovalë iu ndryshonte përbërja e gjakut. Ata kishin

më pak qeliza të kuqe dhe qelizat e bardha të gjakut ju ishin rritur.





NË MBROJTJE TË BLETËS

Rënia misterioze e numrit të bletëve i ka detyruar bletarët dhe shkencëtarët të hidhet në veprim. Një bletërritës i cili ka mbajtur bletë që në vitet 1960 në vitin 2013 themeloi Programin për Mbrojtjen e Bletëve. Kjo organizatë jo-fitimprurëse po punon për një bletë më rezistente dhe po u mëson bletarëve si të mbrojnë shoqëritë e bletëve.

Në një ditë të nxehtë vere, bletët janë në aktivitet të plotë. Bletët punëtore gumëzhijnë duke kryer një funksion jetik për prodhimin ushqimor.

“Të gjitha pemët që shikojmë lindin nga një farë e vetme. Farat prodhohen nga lulet, pasi plotohen nga bletët. Nëse s’kemi bletë, nuk do të kemi pemë, nuk do të kemi lule, nuk do të kemi fruta e perime ose 1/3 e ushqimeve që i nevojiten njeriut,” thotë një bletarë, anëtar i organizatës.

Por më shumë se 1/3 e bletëve po zhduken. Sipas ekspertëve shkaktarë janë ndryshimet klimatike, parazitët, pesticidet dhe metodat bujqësore. Por organizatë për mbrojtjen e bletëve është e vendosur të shpëtojë bletët.

“Ne jemi shpëtimi, jo kompanitë e pesticideve apo profesorët. Po bëhen shumë studime të rëndësishme, por mbrojtja e bletës është në dorën e bletarëve”.

Në rrëzë të Maleve Blue Ridge, organiza-

ta jo-fitimprurëse që drejton Billy Davis financon një program ku bletarët vijnë nga i gjithë shteti i Virxhinias për të mësuar dhe punuar vullnetarisht.

“Synimi përfundimtar është të kemi bletë që do të arrijnë të kujdesen për veten,” thonë bletarët.

Një nga kushtet kritike për mbijetesë është e ashtu-quajtura “sjellje higjenike”, aftësia e bletës për të zbuluar dhe eliminuar faktorët që infektajnë kosheren. Bletarët e analizojnë këtë aftësi duke përdorur nitrogjen të lëngshëm.

“Ngrijmë 100 fole në zgjojet e bletëve. Pas 24 orësh shohim se cilat nga këto fole janë rihapur nga bletët punëtore. Mbretëreshat që kanë një rezultat 95-100% në rihapjen e zgjojeve janë në gjendje të shkëlqyer,” thotë një bletar specialist.

Këto mbretëresha janë më rezistentet dhe përdoren për riprodhim dhe për furnizimin e bletarëve të tjerë me bletë të reja.

“Regjistrojmë çdo ndryshim në zgjoje. Këto të dhëna janë mbledhur prej një kohe të gjatë dhe na ndihmojnë të analizojmë gjenetikën dhe progresin e zgjojeve,” thotë bletar tjetër. Përgatitja e bletarëve të rinj është vetëm fillimi. Më pas vjen procesi i gjatë i zbatimit të përvojës që kanë marrë dhe shkëmbimit të kësaj përvaje me bletarë të tjerë në zonat e tyre.

JO DOMOSDOSHMERISHT NJË TRU MË I MADH TË BËN MË INTELIGJENT

Intelekti i njeriut është më pak i lidhur me madhësinë e trurit me mënyrën me të cilën ky i fundit është i strukturuar, konkludon një studim ndërko-mbëtar shkencor, i koordinuar nga Universiteti i Vjenës.

“Sipas konkluzioneve të këtij studimi shkencëtarët deri më tani kanë mbivlerësuar lidhjen e supozuar midis madhësisë së trurit dhe performancës intelektuale të qenies humane”, shpjegoi sot Jacob Pietschnig, shkencëtar në Universitetin e Vjenës.

“Shumë më e rëndësishme në lidhje me nivelin e inteligjencës shfaqet nga ana tjetër (pjesa e jashtme e kores së trurit, e trurit të mesëm dhe e trurit të vogël) si dhe lidhja e mirë e lëndës së bardhë dhe e materies gri shumë më e rëndësishme sesa vetë madhësia e masës cerebrale”, vijon ai.

Pietschnig dhe ekipi i tij i punës kanë sintetizuar 88 studime për këtë temë duke ek-zaminuar më shumë se 8000



raste për publikimin e rezultateve të tyre vetëm javën e fundit në revistën “Neuroscience & Biobehavioral Reviews”.

ZBULOHEK “KALENDARI KIMIK” I TRUPIT

Shkencëtarët kanë zbuluar mënyrën sesi trupi mund të kuptojë ndërrimin e sezoneve nëpërmjet “një kalendar kimik”, raporton BBC. Kjo skuadër shkencëtarësh, raporton Biologjia Aktuale, zbuloi një grup me mijëra qeliza që mund të jetojnë si në gjendje ‘vere’ ashtu dhe në gjendje ‘dimri’.

Ky grupim qelizor përdor zgjatjen e ditës për ‘të kaluar’ nëpër to gjendjen, në varësi të kohës që duhet për t’u bërë natë. Ora vjetore kontrollon kur kafshët duhet të riprodhohen apo duhet të bien në gjumë letargjik duke ndikuar drejtpërdrejt në sistemin imunitar. Skuadra e Universitetit të Manchesterit dhe Edinburgut i bazuan rezultatet e studimit të tyre në analizmin e trurit të deleve në kohë të ndryshme përgjatë një viti.

Shkencëtarët zbuluan një grup prej 17,000 ‘qelizash kalendarike’ në gjendrën e hipofizës, e cila ndodhet në bazën e trurit dhe lëshon hormone që kontrollojnë proceset në trup. Ata thonë se qelizat kanë një ‘sistem dyjor’ (binar) si një kompjuter që mund të ekzistojnë në një nga dy gjendjet- duke bërë të mundur të prodhojnë kimikate “dimërore” ose “verore”. Proporcioni i qelizave kalendarike ndryshon përgjatë viteve për të treguar kalimin e kohës.

Profesori Andrew Loundon nga Universiteti i Manchesterit thotë: – “Duket sikur për një periudhë të shkurtër të vitit, në mes të dimrit dhe në mes të verës, të gjitha qelizat janë në një gjendje të vetme ‘kalendarike’. Megjithatë ndodh që ato mund të jenë një pjesë në një gjendje e një pjesë tjetër në një gjendje ndryshe, por është ende e paqartë sesi trupi kupton në këto raste nëse është dimër apo verë. Ora vjetore njihet ndryshe dhe si ritmi ndërvjetor dhe është i ngjashëm me ritmin ditor apo cirkadian që na mban zgjuar në momentet e dhura të ditës. Këto sisteme kontrollohen nga drita, dhe janë të domosdoshme për të përcaktuar migrimin e kafshëve, gjumin letargjik dhe çiftëzimet sezonale duke shpjeguar përse disa kafshë si qengjat lindin në pranverë.

Duke qenë se kohëzgjatja e ditë-natës është një faktor i rëndësishëm i funksionimit të trupit, duke na përcaktuar sasinë e duhur të gjumit, bëhet i mundur edhe kuptimi sesi funksionon melatonina, hormoni i gjumit (prodhohet në sasi të madhe gjatë dimrit kur ditët janë më të errëta). Hapi i rradhës është të kuptojnë sesi qelizat regjistrojnë kalimin e kohës.